



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

## RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në:**

**“Teknologji Informacioni”**

**Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës**

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:**


**Prof. Dr. Elson AGASTRA**

**Dr. Evis TRANDAFILI**

**Dhjetor / 2023**

**TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**  
**Bachelor në “Teknologji Informativë”**

1	IAL aplikues:	Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Teknologjisë së Informativës
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në: “Teknologji Informativë”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr. 350, datë 12.05.2010
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	Vendim Senati Nr. 74, datë 14.06.2018 Miratuar me Shkresë të MASR Nr. 7242/1 Prot., datë 31.08.2018
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër QSHA Nr. 338, datë 22.10.2020
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite / 6 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	180 kredite ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve	Niveli 6 (gjashtë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit	31 PAE / 2 PAK (V.A. 2022-2023)
18	Numri i studentëve:	2020-2021 20 studentë; 2021-2022 75 studentë; 2022-2023 72 studentë.
19	Komente / të tjera:	-



## **PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës (UAMD) është një Institucion publik i arsimit të lartë, i themeluar në vitin 2006 me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 801, datë 20.12.2005 “Për hapjen e Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës”.

UAMD është akredituar në nivel institucional, për herë të parë me vendimin Nr. 10, datë 07.04.2017 dhe riakredituar me vendimin Nr. 18, datë 24.03.2022 për “Akreditimin periodik të institucionit të arsimit të lartë Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës”, me kohëzgjatje 4 vite akademike, afati i vlefshmërisë deri me 23.03.2026.

Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës përbëhet nga 5 njësi kryesore, fakultete:

- Fakulteti i Biznesit;
- Fakulteti i Edukimit;
- Fakulteti i Shkencave Politike – Juridike;
- Fakulteti i Studimeve Profesionale;
- Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit;

Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit, njësi kryesore ku ky program studimi ofrohet, është i përbërë nga tre njësi bazë, përkatësisht:

- Departamenti i Shkencave Kompjuterike;
- Departamenti i Teknologjisë së Informacionit;
- Departamenti i Matematikës;

Programi i studimit Bachelor në “Teknologji Informacioni” përfshihet në ciklin e parë të studimeve universitare të ofruara prej Departamentit të Teknologjisë së Informacionit, Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit, Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës. është hapur që në vitin 2010 me hapjen e njësisë kryesore dhe riorganizuar bazuar në vendimin nr. 74, datë 14.06.2018 të Senatit Akademik. Vlerësimi i jashtëm për qëllim të akreditimit po realizohet për herë të parë bazuar në kërkesën e Rektorit të Universitetit Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës për “Përcillen formularët e “Aplikimit për Akreditimin e Programeve të studimit”, në Universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës, drejtuar ASCAL-it, më datë 21.01.2022, Nr. 121 Prot. Ky program studimi ofrohet me kohë të plotë, me kohëzgjatje 3 vite akademike ku në përfundim të tij përfitohet Diplomë Universitare Bachelor në “Teknologji Informacioni”. Programi i studimit Bachelor në “Teknologji Informacioni” është i hartuar dhe zbatohet nga Departamenti i Teknologjisë së Informacionit, duke harmonizuar të gjithë komponentët e tij në lidhje me legjislacionin në fuqi dhe me qëllimet dhe misionin e Institucionit dhe Departamentit. Qëllimi i këtij programi studimi është: Të formojë specialistë me konceptet bazë teorike dhe praktike në fushën e informatikës, Teknologjisë së Informacionit, shkencave kompjuterike, në përputhje me nevojat zhvillimit të vendi.



## PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Mbështetur në VKM nr.109/2017, ASCAL ka përcaktuar kohën dhe grupet e vlerësimit të jashtëm për vlerësimin e programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Teknologji Informacioni”.

Bazuar në Urdhër nr. Nr.44, Datë 14.04.2023, “Për përcaktimin e ekspertëve që do të marrin pjesë në vlerësimin e jashtëm, akreditimin e programeve të studimit, aplikuar nga Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës, grupi i vlerësimit përbëhet nga:

- Prof. Dr. Elson Agastra
- Dr. Evis Trandafili.

Gjatë gjithë procedurës GVJ është asistuar nga Koordinatorja Teknike e ASCAL, Znj. Majlinda Demirneli. Burimi parësor i informacionit për grupin e punës ishte Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, i hartuar në Mars 2023 nga vetë institucioni. Raporti siguron një pamje të detajuar të sistemeve dhe mekanizmave që ka ngritur Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës (UAMD) për të përmbushur objektivat e veta si dhe për të arritur efektivitetin e procedurave të tij për menaxhimin e cilësisë dhe standardeve. Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës, po ashtu, vuri në dispozicion të GVJ një numër dokumentesh shtesë në plotësim e përditësim të elementëve të paraqitur të RVB, dokumentacioni i paraqitur edhe në sistemin AMS të ASCAL. Për realizimin e këtij vlerësimi, GVJ u mbështet kryesisht tek kërkesat e parashkruara nga Ligji Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, VKM Nr. 531, datë 11.9.2018 “Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”, VKM Nr.41 datë 24.01.2018 “Për elementet e programit të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimit të Lartë”, në Udhëzimin Nr. 31 datë 29.12.2017 “Për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe procedurave për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e programeve të studimit nga Institucionet e Arsimit të Lartë”. Gjatë vizitës së kryer në institucion, në datat 18 dhe 19 Maj 2023, u zhvilluan një sërë takimesh mes grupit të vlerësimit të jashtëm dhe përfaqësuesve të Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës, Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit, Departamenti i Teknologjisë së Informacionit. Këto takime u shoqëruan me diskutime intensive dhe në përfundim të tyre GVJ hartoi raportin e mëposhtëm, i cili paraqet mendimet e ekspertëve të jashtëm mbi këtë program studimi. GVJ u ndal në detaje të funksionimit të Sekretarisë Mësimore si dhe në detaje të administrimit e procesit mësimor. GVJ vizitoi me përparësi lehtësitë për studentët si sallat e internetit dhe të kompjuterëve, bibliotekën, mjediset e studimeve, laboratorët etj. U zhvilluan bashkëbisedime me një grup studentësh duke u njohur me mendimin e tyre për një sërë çështjesh në lidhje me mësimdhënien dhe aspektet e tjera të jetës studentore. Informacioni dhe të dhënat që përmban ky raport bazohen në burimet e sipërpërmendura dokumentare, në takimet e zhvilluara, si dhe në materialet e ndryshme që iu vunë në dispozicion GVJ-së sipas kërkesave. Në fund të raportit ekspertët kanë hartuar disa rekomandime, me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të programit.

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 16.10.2023, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 15/159 Prot, datë 16.10.2023. Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës nuk ka dërguar komente, sugjerime në lidhje mbi Draft Raportin, sipas Manualit 2017, si dhe përcaktimit në agjendën e detajuar të vlerësimit. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

## Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Teknologji Informacioni”

### I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

<b>Standardi I.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi i studimit Bachelor në “Teknologji Informacioni” jo vetëm që nuk bie ndesh me interesat kombëtare, por kontribuon direkt në përgatitjen e specialistëve të cilët me kompetencat e tyre, do të punojnë për zhvillimin dhe modernizimin e vendit.  Evid. 2. Statuti UAMD 1. Mendimi i Dekanes TI
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Misioni dhe objektivat e këtij programi studimi janë të tilla që mundësojnë hedhjen e bazave shkencore dhe përgatitjen teoriko-praktike të nevojshme për formimin e studentëve. Në bazë të programit mësimor të hartuar nga institucioni vërehet mbulimi i njohurive bazë si ato të përgjithshme ashtu dhe ato teknike dhe përmbillen me njohuri specifike në fushën e teknologjisë së informacionit. Programi i studimit Bachelor në “Teknologji Informacioni” është plotësisht në përputhje me qëllimet dhe misionin e Universitetit Aleksandër Moisiu” Durrës.  Evid. 3. Rregullore UAMD Evid. 4. Rregullore FTI Evid. 9. Plani i zhvillimit strategjik të UAMD 2020-2025
<b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimit akademike të tij.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se programi studimit Bachelor në “Teknologji Informacioni” është hartuar në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe me politikat e zhvillimit të Institucionit, në lidhje me përgatitjen e profesionistëve në fushën e Teknologjisë së Informacionit.  Evid. 2. Statuti UAMD Evid. 3. Rregullore UAMD Evid. 4. Rregullore FTI Evid. 9. Plani i zhvillimit strategjik të UAMD 2020-2025 Evid. 10. Misioni dhe studimi i tregut të punës për programin e studimit



**Kriteri 4.** Institucioni demonstroi se ka përvijën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.

Referuar Dosjes së Vetëvlerësimit, GVJ konstaton që UAMD ka burimet, kapacitetet dhe përvijën e duhur për të ofruar programin e studimit Bachelor në "Teknologji Informacioni".

**Strukturat përgjegjëse:** Programi i studimit ofrohet nga Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit, i cili ka në përbërje tre njësi bazë:

- Departamenti i Shkencave Kompjuterike;
- Departamenti i Teknologjisë së Informacionit;
- Departamenti i Matematikës;

Burimet njerëzore: Staf i akademik bazuar në CV-të rezultoi me përvijë dhe i përshtatshëm në disiplinat specifike të Teknologjisë së Informacionit

Nga të dhënat që jepën në DVV, rezultoi numri i duhur i anëtarëve të stafit akademik me përvijë dhe të përshtatshme në disiplinat specifike të këtij programi studimi.

Personeli Akademik Efektiv (PAE) dhe ai me kontratë (PAK) i angazhuar në këtë program studimi, në vitin akademik 2022-2023 kanë kualifikimet si më poshtë:

Kualifikimi	PAE	PAK
Prof. Dr.	0	0
Prof. Asoc.	4	0
Dr./PhD	15	0
Dr. në proces	10	0
Msc.	2	0
<b>Total</b>	<b>31</b>	<b>0</b>

Në Departamentin e Teknologjisë së Informacionit, i cili është përgjegjës për programin e studimit, (14 staf akademik efektiv dhe 10 staf akademik me kontratë), të cilët zotërojnë kualifikimin si më poshtë:

Kualifikimi	PAE	PAK
Prof. Dr.	0	0
Prof. Asoc.	1	0
Dr./PhD	6	0
Dr. në proces	6	0
Msc	1	10
<b>Total</b>	<b>14</b>	<b>10</b>

	<p>Stafi akademik ka kualifikimin e duhur për formimin e njësisë bazë si dhe angazhimi i tyre akademik është në përputhje me fushën e tyre të ekspertizës.</p> <p>Evid. 19. Analizë e Departamentit të Teknologjisë së Informacionit</p> <p>Evid. 20. Raporti vjetor për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë</p> <p>Evid. 16. CV e stafit Akademik</p>								
<p><b>Kriteri 5.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>GVJ konstatoi që fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit Bachelor në "Teknologji Informacioni" (shih RVB) është në përputhje me fushën kërkimore-shkencore dhe akademike të Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit, si dhe atë të njësisë bazë, të Departamenti i Teknologjisë së Informacionit.</p> <p>Evid. 4. Rregullore FTI</p> <p>Evid. 10. Misioni dhe studimi i tregut të punës për programin e studimit</p>								
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Programi i studimit, Bachelor në "Teknologji Informacioni" ofrohet në Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës, në përputhje të plotë me misionin, qëllimin dhe aktivitetin e tij.</i></p> <p><i>Programi i studimit bazohet ofrohet nga njësi bazë dhe kryesore që kanë të njëjtën fushë akademike me atë të këtij programi studimi.</i></p>								
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

### Standardi I.2

**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit,</p>	<p>GVJ lidhur me vlerësimin e këtij kriteri mori në shqyrtim Raportin e Vlerësimit të Brendshëm të programit, statutin dhe rregulloren e UAMD, si dhe aktet rregullatore specifike, po</p>

<p>siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>ashtu dhe përgjigjet e grupeve gjatë takimeve të organizuara në institucion dhe konstaton se UAMD siguron më së miri marrëdhëniet brenda institucionit, kjo sipas detyrave të përcaktuara qartë si ndërmjet strukturave përbërëse të UAMD ashtu dhe roleve të përcaktuara sipas strukturës.</p> <p>Ndarja e detyrave mes njësive e personelit përcaktohet nga institucioni në rregulloren e tij. Nga vlerësimi rezulton se Departamenti i Teknologjisë së Informacionit, menaxhon dhe drejton me efektivitet programin e ciklit të parë Bachelor në “Teknologji Informacioni” i cili ka një kohëzgjatje 3-vjeçare dhe në total përmban 180 kredite.</p> <p>Vërehet një bashkëpunim i ngushtë me të gjitha strukturat e institucionit (Njësia e Brendshme të Sigurimit të Cilësisë, Sekretaria mësimore, Arkiva dhe protokollit, Zyra e burimeve njerëzore, Zyra e zhvillimit të kurrikulave, Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës, Zyra e projekteve dhe marrëdhënieve me jashtë etj.) si dhe departamentet e tjera në Fakulteti Teknologjisë së Informacionit dhe në tërësi në UAMD. Kjo duket edhe në mësimdhënie, ku disa prej lëndëve të këtij programi studimi mbulohej nga staf akademik i njësive të tjera bazë të këtij fakulteti dhe në përgjithësi të këtij universiteti, sipas fushës së tyre të ekspertizës.</p> <p>Evid. 11. Rregullore Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Juridike DBNjJ Evid. 25. Personeli akademik i angazhuar në DTI</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>GVJ bazuar në informacionin e Dosjes së Vetëvlerësimit, si dhe në takimin me përfaqësuesin e zyrës së marrëdhënieve me jashtë dhe të projekteve, vlerëson se UAMD ka nënshkruar një numër të konsiderueshëm marrëveshjesh bashkëpunimi si me institucione të tjera të arsimit të lartë ashtu edhe me subjekte ekonomike private dhe institucione të tjera shtetërore.</p> <p>Nga takimi me studentët, me personelin akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme, me zyrën përgjegjëse për marrëdhëniet më jashtë, u konstatua se institucioni ka bashkëpunime me IAL-të vendase dhe të huaja dhe me kompani biznesi. Gjithashtu vihet re edhe rritja e kërkesës dhe angazhimit në aktivitete ndërkombëtare si Erasmus+.</p> <p>Evid. 26. Liste MoU Evid. 9. Plani i zhvillimit strategjik të UAMD 2020-2025</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme</p>	<p>Programi i studimit bachelor në “Teknologji Informacioni”, i ofruar nga UAMD, nuk parashikon në planin mësimor lëndën “Praktikë profesionale”. Institucioni ka një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi, me kompani private në fushën e teknologjisë së</p>



<p>me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>informacionit, por ato nuk përdoren zyrtarisht për zhvillimin e praktikave, pasi ato nuk janë të parashikuara në planin mësimor.</p> <p><i>Rekomandohet që institucioni të shtojë në planin mësimor lëndën e "Praktikës profesionale" dhe marrëveshjet e bashkëpunimit të shfrytëzohen në kuadër të kryerjes së praktikave profesionale, të institucionalizuar dhe ti shërbejnë studentëve të këtij programi studimi me qëllim afrimin e tyre në tregun e punës</i></p> <p>Evid. 26. Liste MoU Evid. 27. Memorandum UAMD - Crystal System Evid. 28. Trajtime FTI - Crstal System</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Në fund të vitit akademik, njësia bazë, realizon analizën e punës mësimore dhe shkencore ku përveç aspekteve të tjera të punës që kanë të bëjnë me mbarëvajtjen e këtij programi studimi, shqyrton dhe analizon marrëveshjet e bashkëpunimit. Në këto analiza evidentohen efektet pozitive dhe përfitimet e këtyre marrëveshjeve në tërësi në funksion të realizimit të qëllimeve të këtij programi studimi, por edhe të evidentimit të mangësive të tyre.</p> <p>Evid. 19. Analizë e Departamentit të Teknologjisë së Informacionit</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>UAMD nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me institucione partnere si dhe aktor të tregut të punës dhe i analizon ato në mënyrë periodike.</i></p> <p><i>Sugjerohet institucioni që të shtojë në planin mësimor, lëndën e "Praktikës Profesionale".</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>
--	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	--

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

**Standardi II.1****Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	<p>Programi i studimit Bachelor në “Teknologji Informacioni” është organizuar në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS) si dhe sistemin amerikan UsCr.</p> <p>Ai ofrohet në 3 vite akademike, 6 semestra, dhe me kohë të plotë. Programi i studimit Bachelor në “Teknologji Informacioni” përmban 180 ECTS. Një semestër përmban 30 ECTS. Bazuar në planin mësimor, lëndët janë ndarë në pesë kategori (A, B, C, D, E) konform VKM 41, datë 24.01.2018 i ndryshuar.</p> <p><i>Megjithatë, institucioni ka parashikuar në planin mësimor si dhe në syllabuset e lëndëve numrin total të krediteve ECTS por jo ndarjen e tyre në aktivitete formuese si Leksione, Ushtrime/Seminare, Laboratorë, detyra/Projekte kursi, praktika, etj.</i></p> <p>Në planin mësimor është parashikuar vetëm një aktivitet didaktik formues, më konkretisht vetëm Leksione. Nuk ka të parashikuara aktivitete didaktike si Seminare, Laborator apo detyra/projekte kursi, praktika etj..</p> <p>Gjatë vizitës në institucioni, dhe në veçanti takimi me organet drejtuese dhe stafin akademik, u shpjegua se në hartimin e planit mësimor, është ndjekur metodologji në formatin anglo-amerikan, duke i përfshirë të gjitha aktivitetet didaktike (Leksione, seminare, ushtrime, laborator, detyra/projekte kursi etj.) në një të vetëm, të quajtura “Orë të integruara”. Por ky zbatim, i paraqitur në planin mësimor nuk gjen mbështetje në aktet e brendshme rregullatore. Në veçanti, në statutin e UAMD, neni 72, pika 4 shpjegon se lëndët zhvillohen si:</p> <p>- Në UAMD çdo lëndë mësimore zhvillohet:</p> <ol style="list-style-type: none"><li>Në orë mësimi leksionesh;</li><li>Në orë mësimi seminaresh;</li><li>Në orë mësimi të integruara të leksioneve me seminare;</li><li>Në formën e moduleve dy-tre javore;</li><li>Me trajnim profesional të zhvilluar në institucione dhe kompani partnere të UAMD.</li></ol>

Në rregulloren e FTI-së, neni 43, pika 3 dhe 4, shpjegon se lëndët mësimore zhvillohen në aktivitete si:

- Në FTI çdo lëndë mësimore organizohet si ndërthurje e elementëve si më poshtë:

- a) leksione;
- b) seminare;
- c) orë të integruara të leksioneve me seminarët;
- ç) ushtrime;
- d) laborator;
- dh) projekte/detyra kursi individuale dhe/ose në grup;
- e) provime të ndërmjetme dhe provime përfundimtare;
- ë) në formën e praktikës profesionale të zhvilluar në laboratore të FTI-së, dhe/ose në institucione dhe kompani me të cilat FTI/UAMD ka marrëveshje bashkëpunimi;
- f) konsultime individuale ose në grupe me pak studentë;
- g) apo çdo formë tjetër të miratuar nga FTI.

- Ndarja e orëve mësimore sipas elementëve të mësipërme të studimit për çdo kurs, përcaktohet në kurrikulën e programit të studimit të miratuar nga departamenti përkatës, në bazë të krediteve që i janë caktuar disiplinës.

Pra bazuar në aktet e brendshme rregullatore, vetëm leksionet dhe seminarët mund të jenë të integruara, ndërsa aktivitetet e tjera didaktike janë të pa varura dhe nëse gjykohen se janë pjesë e formimit të lëndëve, duhet të paraqiten në planin mësimor dhe syllabuset përkatësisht.

Aktivitetet e mundshme didaktike, që parashikon rregullorja e FTI-së dhe ajo e UAMD, por edhe VKM 41 datë 24.01.2018 “për Elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” i ndryshuar, paraqiten si zëra edhe në dokumentacione të tjera sikurse është plani mësimor, analiza vjetore e departamentit, por plotësimi i tyre është në të gjitha rastet si “0”. Këtu përmendim planin mësimor, analizën vjetore të departamentit, ku paraqiten si zë, ndarja e aktiviteteve didaktike formuese si Leksione, seminare, ushtrime, laborator, detyra/projekte kursi etj., por plotësohen të dhëna sasiore vetëm për “Leksione”.

Kjo ndarje nuk paraqitet as në planin mësimor dhe as në syllabuset e lëndëve duke mos qenë kështu në përputhje të plotë me aktet e brendshme rregullatore dhe as me VKM 41, datë 24.01.2018 “për Elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” i ndryshuar.



Kjo ndarje, edhe pse formale, sipas parashikimit të VKM 41, është e nevojshme për të vlerësuar më pas, mjaftueshmërinë e seancave laboratorike për përçimin e dijeve për lëndët që e kanë të nevojshme këtë aktivitet. Mungesa e saktësisimit të krediteve dhe orëve laboratorike për secilën lëndë, nuk mundëson vlerësimin e mjaftueshmërisë së ambienteve laboratorike për të gjitha lëndët, programet e studimit dhe numrin total të studentëve.

Gjithashtu, mos specifikimi i numrit të krediteve ECTS të secilës lëndë në aktivitetet e saj didaktike formuese, në syllabus, potencialisht është një mangësi në aftësinë e transferimit të studimeve nga UAMD drej institucioneve të tjera brenda dhe jashtë vendit.

Mos ndarja në aktivitete formuese të lëndëve, nuk mundëson vlerësimin e përmbushjes së kriterëve ligjore të përcaktuar nga ligji 80/2015 për arsimin e lartë dhe aktet nënligjore për sa i përket kualifikimit të stafit akademik që angazhohet në aktivitetet mësimdhënëse.

Kujtojmë se për zhvillimin e leksioneve në auditor, personeli akademik duhet të jetë i kategorisë “lektor”, pra të ketë së paku gradën shkencore “Doktor”, ndërsa në zhvillimin e aktiviteteve didaktike si seminare, laborator etj, personeli akademik që angazhohet duhet të ketë së paku formimin e një cikli më të lartë se ai programit të studimit ku angazhohet. Në rastin e këtij programi studimit, duhet të jetë së paku me kualifikimin “Master i Shkencave”.

*Rekomandojmë institucionin të plotësojë syllabuset dhe planin mësimor në përputhje me VKM nr.41 e ndryshuar duke saktësuar kreditet dhe orët mësimore për secilin aktivitet didaktik (Leksione, seminare, ushtrime, laborator, detyra/projekte kursi, praktika etj.) Në përputhje edhe me rregulloret e brendshme institucionale.*

Evid. 18. Plani mësimor TI

Evid. 15. Syllabuset e Lëndëve

Evid. 14. Modeli i Dilomes TI, Urdheri i aprovimit dhe suplementi i diplomës

Evid. 19. Analize e Departamentit të Teknologjisë së Informacionit

Dok. Shtesë - Relacion mbi riorganizimin nën 20 % Bach Teknologji Informacioni

Dok. Shtesë - Vendim Senati Akademik riorganizimi i programit Teknologji Informacioni

<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Teknologji Informacioni” synon:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- T’i pajisë studentët me njohuri të thelluar profesional dhe praktike, bazuar në metodat, teknikat dhe instrumentet inovativ;</li> <li>- Të zhvillojë aftësitë teknologjike, nëpërmjet praktikës mësimore në laborator për lëndët me karakter profesional;</li> <li>- Të aftësojë studentët në diagnostifikimin, zberthimin, konfigurimin dhe dizenjimin e rrjetit dhe sistemit kompjuterike;</li> <li>- Të formojë specialistë në sigurinë kibernetike;</li> <li>- Të formojë specialistë në administrimin dhe konfigurimin e serverave;</li> <li>- Të aftësojë studentët në sistemin operativ Linux;</li> <li>- Të formojë projektues dhe zbatues të projekteve TI;</li> <li>- Të formojë specialistë në virtualizimin dhe ngritjen e makinave virtuale në Cloud;</li> <li>- Të aftësojë studentët në sistemet e telekomunikacionit dhe në sistemet e informacionit;</li> <li>- Të aftësojë studentët në programim C++, Java apo programim në web;</li> <li>- Të formojë specialistë për krijimin dhe administrimin e bazës së të dhënave;</li> </ul> <p>Evid. 5. Rregullore e programit të studimit (Bachelor në TI)</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Bazuar në planin mësimor por edhe në plan programet e lëndëve, vërehet se secila lëndë ka të përcaktuar objektivat formuese, ngarkesën e parashikuar për studentët në total kreditesh dhe orësh në auditor, por pa i ndarë ato në aktivitete didaktike formuese si Leksione, seminare, ushtrime, laborator, detyra/projekte kursi, praktika etj.</p> <p>Gjithashtu, në plan-programet e lëndëve nuk paraqitet ngarkesa në kreditet për aktivitetet formuese të lëndëve, por vetëm orët që ato parashikojnë në auditor. Por pa i ndarë ato në aktivitete didaktike formuese, duke mos paraqitur kështu, as aktivitetet laboratorike, të cilat realisht kryhen për këtë program studimi nga institucioni. Gjatë vizitës në institucion, dhe në veçanti në takimin me stafin akademik i cili u pyet rreth këtij argumenti, u sqarua se pavarësisht se në plan-programet e lëndëve, nuk është parashikuar në zë të veçantë aktiviteti laboratorik, zhvillimi i tyre është i integruar ku për lëndë karakterizuese zhvillohet në laboratorët e informatikës. Kjo bën të mundur që ushtrimet e parashikuara për lëndën, përveç trajtimit teorik të</p>


mirëfilltë, zhvillohen si zgjidhje kompjuterike nga studentët gjatë këtyre seancave ushtrimore. Edhe pse disa prej lëndëve të këtij programi studimi, fizikisht zhvillohen në ambiente laboratorike të UAMD, ku pjesa teorike gërshetohet me praktikimin në kompjuter të lëndëve, nuk është e mundur të vlerësohet mjaftushmëria e tyre për të arritur objektivat formuese të programit të studimit në tërësi.

Në syllabuse, jo të gjitha kanë të përcaktuar titullarin, pasi në disa prej tyre jepet vetëm pedagogu i lëndës, kualifikimi i të cilit, nuk e lejon që të jetë gjithashtu titullar lënde sipas akteve ligjore në fuqi.

*Rekomandojmë që institucioni të përcaktojë titullarët e lëndëve me kualifikimet konform ligjit 80/2015 për arsimin e lartë dhe ti paraqes në syllabuset e lëndëve.*

Në syllabusin e secilës lëndë, paraqitet edhe kriteret e vlerësimit të shprehura me shkronja sipas sistemit amerikan, me nota sipas sistemit të vlerësimit Shqiptar, me pikë dhe me përqindje. Sipas tabelës në vijim:

Përshkrimi	Nota	Pikët	Përqindjet
<b>FX ~ Ngel</b> (Kërkohe më shumë punë për të arritur rezultatin e dëshiruar)	4	0-504	0-50 %
<b>E ~ Mjaftueshëm</b> (Performanca u përmbahet kritereve minimale)	5	505-575	51-57 %
<b>D ~ I kënaqshëm</b> (I drejtë por me mangësi të dukshme)	6	575-664	58-66 %
<b>C ~ Mesatar</b> (Në përgjithësi performancë e mirë me një numër gabimesh të dukshme)	7	665-754	67-75 %
<b>C+ ~ Mirë</b> (Mbi standartin mesatar por me disa gabime)	8	755-844	76-84 %



<b>B ~ Shumë mirë</b> (Në përgjithësi performancë e lartë me një numër gabimesh të dukshme)	9	845-934	85-93 %
<b>A ~ Shkëlqyeshëm</b> (Performancë e shkëlqyeshme me gabime të vogla)	10	935-1000	94-100 %

Kjo tabelë, e paraqitur në syllabuse, është e paraqitur në të njëjtë formë edhe në rregulloren e programit të studimit, më konkretisht në *nenin 17*. Po kjo përmbajtje tabelle dhe mënyre vlerësimi është paraqitur edhe në Tabelat përmbledhëse të Raportit të Vlerësimit të Brendshëm të hartuar nga njësia bazë për këtë program studimi.

Megjithatë, kjo tabelë vlerësimi, e paraqitur në rregulloren e programit të studimit dhe në syllabuse, bie në kundërshtim me atë të paraqitur në rregulloren e FTI në *nenin 52* të saj dhe në suplementin e diplomës në pikën 4.4.

Për referencë, në vijim paraqesim më poshtë tabelën e vlerësimit që gjendet në rregulloren e FTI dhe në suplementin e diplomës:

Nota		Pikët	Përqindjet
Sistemi Shqiptar	Sistemi Amerikan		
4	F	0-504	0-50 %
5	D	505-574	51-57 %
6	C	575-664	58-66 %
7	C+	665-754	67-75 %
8	B	755-844	76-84 %
9	B+	845-934	85-93 %
10	A	935-1000	94-100 %

Ku shohim se midis këtyre dy tabelave ka mospërputhje. Vlerësimi "B+" nuk ekziston në tabelën e parë por ekziston në

	<p>të dytën, anasjelltas, vlerësimi “E” ekziston në tabelën e parë dhe jo në të dytën. Gjithashtu, edhe shkallët e vlerësimit në pikë dhe përqindje, nuk përkojnë me të njëjtat vlerësime me shkronja midis këtyre dy tabelave.</p> <p>Ky informacion, për studentët e diplomuar, të cilët janë të pajisur me suplementin e diplomës, mund të mos jetë burim ngatërrese në rast transferimi studimesh, për studentët që nuk janë diplomuar, por duan të realizojnë transferimin e studimeve nga UAMD drejt një institucioni tjetër të arsimit të lartë që përdor sistemin amerikan të vlerësimit, është burim ngatërrese dhe pasaktësi në vlerësim.</p> <p><i>Rekomandojmë institucionin të plotësojë syllabuset dhe planin mësimor në përputhje me VKM 41 e ndryshuar duke saktësuar kreditet dhe orët mësimore për secilin aktivitet didaktik (Leksione, seminare, ushtrime, laborator, detyra/projekte kursi, praktika etj.).</i></p> <p><i>Rekomandojmë hartimin e syllabuseve dhe rregulloreve të brendshme në harmoni të plotë mes tyre, duke evituar përsëritje informacioni, sikurse është tabela e vlerësimit. Duke qenë se konvertimi i pikëve të vlerësimit në notë është i njëjti, në syllabuse apo rregulloren e prograzmit të studimit nuk është e nevojshme të paraqite, është mjaftueshëm të citohet si referencë rregullorja e FTI.</i></p> <p>Evid. 15. Syllabuset e Lëndëve Evid. 18. Plani mësimor TI Evid. 21. Kodifikimi i Programeve të Studimit UAMD</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Plani mësimor parashikon në total 29 lëndë mësimore si dhe tezën e diplomës/Provim formimi, për një total prej 30 lëndë/module didaktike të ndara në veprimtari formuese në kategoritë A-E sipas VKM 41, datë 24.01.2018 e ndryshuar.</p> <p><i>Ky program studimi nuk ka të parashikuar lëndën e “Praktikës Profesionale”.</i></p> <p>Punimi i diplomës/provim formimi është parashikuar si detyrime përmbyllëse me 6 kredite ECTS në kategorinë “E”. Duke përbërë 3.33 % të peshës totale të programit.</p> <p>Megjithatë, referuar VKM 41, datë 24.01.2018 i ndryshuar, por edhe programeve të tjera të ngjashme të ofruara nga institucione të tjera të arsimit të lartë, sugjerohet të shtohet edhe lënda e “Praktikës Profesionale” e cila të zhvillohet pranë kompanive apo institucioneve publike me të cilat UAMD ka marrëveshje bashkëpunimi.</p>





	<p><i>Ne si <u>GVJ sugjerojmë</u> institucionin, që të shtojë në planin mësimor lëndën e praktikës profesionale duke e shoqëruar edhe me syllabusin përkatës, ku të përshkruhen së paku detyrimet e studentit për zhvillimin dhe vlerësimin e këtij aktiviteti formues.</i></p> <p>Evid. 18. Plani mësimor TI</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Nuk aplikohet</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Referuar dokumentacionit shoqërues të këtij raporti, të vëna në dispozicion nga UAMD, dhe duke i krahasuar ato me programe të ngjashme studimit të ofruara nga institucione të tjera të arsimit të lartë në vend, ku më poshtë përmendim disa prej tyre si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– Universiteti i Tiranës <ul style="list-style-type: none"> <li>○ Bachelor në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”</li> </ul> </li> <li>– Universiteti “Fam S. Noli”, Korçë <ul style="list-style-type: none"> <li>○ Bachelor në “Teknologji Informacioni”</li> </ul> </li> <li>– Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë <ul style="list-style-type: none"> <li>○ Bachelor në “Teknologji Informacioni”</li> </ul> </li> <li>– Universiteti “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan <ul style="list-style-type: none"> <li>○ Bachelor ne Teknologjite e Informacionit</li> </ul> </li> <li>– Universiteti European i Tiranës <ul style="list-style-type: none"> <li>○ Bachelor në “Teknologji Informacioni”</li> </ul> </li> </ul> <p>Vihet re se plani mësimor në emërtime lëndësh, por edhe në shpërndarje, është i ngjashëm me programet e ofruara nga IAL të tjera brenda vendit dhe në përputhje me objektivat e formimit të këtij programi studimi. Por ndryshe nga IAL-të e tjera, në UAMD, programi i studimit nuk ka të parashikuar lëndën e “Praktikës profesionale” sikurse u vu në dukje edhe në kriteret</p>

më sipër. Gjithashtu, vihet re se numri i orëve totale në auditor për aktivitetet formuese, në UAMD është më i ulët se në institucionet e tjera të arsimit të lartë për të njëjtin program studimit.

IAL	Orë në auditor	Orë studim individual	Totali	Raport për qindje
Universiteti i Tiranës	1945	2555	4500	43% / 57 %
Universiteti i Elbasanit	2165	2335	4500	48 % / 52 %
Universiteti i Vlorës	1770	2730	4500	39 % / 61 %
Universiteti i Korçës	2143	2357	4500	48% / 52 %
Universiteti European i Tiranës	1832	2668	4500	41 % / 59 %
<b>Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës</b>	<b>1350</b>	<b>3150</b>	<b>4500</b>	<b>30 % / 70 %</b>

Të dhënat për planet mësimore të institucioneve të përmendur në tabelën më sipër i referohen raporteve për program studimi që janë të publikuar në faqen zyrtare të ASCAL, informacione për planet mësimore të publikuara në faqet ueb online të vet IAL-vë.

Nga ku shohim se numri i orëve në auditor për këtë program studimi së 30% të orëve totale.

Kjo ngarkesë është në përputhje me VKM 41 datë 24.01.2018 e ndryshuar, e cila kufizon numrin e orëve në auditor jo më shumë se 50%, por nuk vendos limit të poshtëm.

Megjithatë, bazuar në argumentat e trajtuara në secilën lëndë, rëndësinë dhe nevojën e trajtimit të tyre në auditor, gjykojmë se numri i orëve në auditor është i ulët për një program të till studimi duhet të jetë së paku 40% në auditor.

*Sugjerojmë institucionin të rrisë numrin e orëve mësimore në auditor si dhe të ndajë aktivitetet formuese në kredite dhe orë përkatëse në auditor, duke i specifikuar ato në planin mësimor dhe në syllabuse.*

Evid. 15. Syllabuset e Lëndëve

Evid. 18. Plani mësimor TI

	<p>Evid. 21. Kodifikimi i Programeve të Studimit UAMD  <a href="https://sites.google.com/a/fshn.edu.al/depinfo/studime-te-nivelit-te-pare/teknologji-informacion">https://sites.google.com/a/fshn.edu.al/depinfo/studime-te-nivelit-te-pare/teknologji-informacion</a>  <a href="https://www.asc.al/media/documents/rvj/PS_973_1139.pdf">https://www.asc.al/media/documents/rvj/PS_973_1139.pdf</a>  <a href="https://www.asc.al/media/documents/rvj/PS_1737_982.pdf">https://www.asc.al/media/documents/rvj/PS_1737_982.pdf</a>  <a href="https://univlora.edu.al/wp-content/uploads/2020/03/Bachelor-n%C3%AB-TEKNOLOGJI-INFORMACIONI.pdf">https://univlora.edu.al/wp-content/uploads/2020/03/Bachelor-n%C3%AB-TEKNOLOGJI-INFORMACIONI.pdf</a>  <a href="https://uniel.ems.al/school/program/dd0c20d2-944a-4dd0-bb36-a6fd0141e3ec.aspx">https://uniel.ems.al/school/program/dd0c20d2-944a-4dd0-bb36-a6fd0141e3ec.aspx</a></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Për sa i përket kodifikimit të programeve/ klasifikimit, referuar raportit të vlerësimit të brendshëm, dokumentacionit shoqëruar si dhe VKM nr. 310, datë 11.05.2022 për “Specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, kodifikimi i këtij programi studimi është përcaktuar nga UAMD me kodin: <b>S63BA0610</b> dhe përcjellë në ministrinë përgjegjëse për arsimin më datë 08.02.2023 dhe rikonfirmuar me dokumentacion mbështetës më datë 31.05.2023 me shkresë zyrtare Nr. 918/1 Prot. i UAMD.</p> <p>Evid. 21. Kodifikimi i Programeve të Studimit UAMD          Procedura e dërguar në MAS për kodimin e programeve të studimit të UAMD</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>Nuk aplikohet</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>1- <i>Lëndët dhe formimi në tërësi i programi të studimit, është në përputhje me objektivat formuese të studentëve për këtë cikël studimi dhe i ngjashëm me ato të ofruara nga IAL të tjera.</i></p> <p>2- <i>Në planin mësimor nuk janë të saktësuar kreditet dhe orët në auditor për aktivitetet didaktike (Leksione, seminare, ushtrime, laborator, detyra/projekte kursi, praktika etj.) që parashikon çdo lëndë sipas VKM 41 e ndryshuar duke saktësuar kreditet dhe orët mësimore për secilin aktivitet didaktik. Institucioni duhet të plotësojë planin mësimor dhe syllabuset duke saktësuar aktivitetet didaktike për secilën lëndë si dhe titullarin e lëndës.</i></p>



	<p>3- Dokumentacione zyrtare si syllabuset, rregullorja e programit të studimit, rregullorja e UAMD dhe suplementi i diplomës, kanë të dhëna që janë kontradiktore mes tyre për sa i përket mënyrës së vlerësimit. <u>Rekomandojmë</u> hartimin e syllabuseve dhe rregulloreve të brendshme në harmoni të plotë mes tyre, duke evituar përsëritje informacioni, sikurse është tabela e vlerësimit.</p> <p>4- Të përcaktohen lektorët e lëndëve me kualifikimet sipas legjislacionin në fuqi dhe të afishohen në syllabuset përkatëse.</p> <p>5- Ky program studimi nuk parashikon lëndën e “Praktikës profesionale” që gjykojmë se është e nevojshme për një program të tillë studimit. <u>Sugjerojmë</u> institucionin, që të shtojë në planin mësimor lëndën e praktikës profesionale duke e shoqëruar edhe me syllabusin përkatës, ku të përshkruhen së paku detyrimet e studentit për zhvillimin dhe vlerësimin e këtij aktiviteti formues.</p> <p>6- Numri i orëve mësimore në auditor është i ulët referuar programeve të ngjashme studimi, si dhe nevojave për përçimin e dijeve tek studentët, ku zënë 30% të orëve totale. <u>Sugjerojmë</u> institucionin të rrisë numrin e orëve mësimore në auditor së paku me 10% më shumë, si dhe të ndajë aktivitetet formuese në kredite dhe orë përkatëse në auditor, duke i specifikuar ato në planin mësimor dhe në syllabuse.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		<b>X</b>		

## Standardi II.2

**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cillësisë për këto njësi.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike,	Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës, ka zhvilluar procesin e vlerësimit institucional në kuadër të akreditimit periodik. Ky vlerësim është finalizuar nga Bordi i Akreditimit në ASCAL me Vendim BA Nr.18, datë 24.03.2022 që akrediton në formë institucionale me vlefshmëri 4 vite, për periudhën nga 24/03/2022 deri në 23/03/2026.

stafet akademike  
vlerësimin dhe  
akreditimin.

Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit, si njësi kryesore përgjegjëse për këtë program studimi, ka në përbërje 3 njësi bazë:

1. Departamenti i Matematikës;
2. Departamenti i Shkencave Kompjuterike;
3. Departamenti i Teknologjisë së Informacionit;

Duke përbushur kështu edhe kriteret ligjore për qëndrueshmërinë e njësisë kryesore.

Njësia kryesore, Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit është krijuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 685, datë 25.08.2010 për "Riorganizimin e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, si njësi kryesore brenda strukturës së Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës.

Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit ka në përbërjen e tij, 44 personel akademik efektiv(PAE) i ndarë në tre njësi bazë, si:

Njësia bazë	Nr. PAE	Tituj/Grada
Departamenti i Matematikës	15	0 – Prof. Dr. 4 – Prof. Asoc. 8 – Dr. 2 – Dr. në Proc. 1 - Msc
Departamenti i Shkencave Kompjuterike	15	0 – Prof. Dr. 0 – Prof. Asoc. 4 – Dr. 9 – Dr. në Proc. 2 - Msc
Departamenti i Teknologjisë së Informacionit	14	0 – Prof. Dr. 1 – Prof. Asoc. 6 – Dr. 6 – Dr. në Proc. 1 - Msc
<b>Total</b>	<b>44</b>	<b>44</b>

Secila njësi bazë, pëfshirë edhe Departamentin e Teknologjisë së Informacionit, përbush kriteret minimale të parashikuar në

	<p>ligjin 80/2015 për numrin dhe kualifikimin minimal të stafit efektiv për krijimin dhe ekzistencën e njësive bazë.</p> <p>Evid. 2. Statuti UAMD Evid. 3. Rregullore UAMD Evid. 4. Rregullore FTI Evid. 44. Struktura Organizative e UAMD</p>			
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit angazhohet në ndihmë të procesit akademik, në total 10 personel ndihmës akademik të ndarë në njësitë bazë si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– 2 personel në Departamentin e Matematikës</li> <li>– 4 personel në Departamentin e Shkencave Kompjuterike</li> <li>– 4 personel në Departamentin e Teknologjisë së Informacionit</li> </ul> <p>Duke përmbushur kështu edhe detyrimet ligjore në angazhimin e stafit ndihmës akademik.</p> <p>Evid. 16. CV e stafit Akademik Evid. 17. CV e stafit ndihmës akademik Evid. 25. Personeli akademik i angazhuar në DTI</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Bazuar në RVB, Departamenti i Teknologjisë së Informacionit, në përputhje me objektivat e tij për realizimin me sukses të programit të studimit Bachelor në "Teknologji Informacioni" ka të përcaktuar objektivat e Koordinatorit të Programit të studimit. Roli i tij është i përcaktuar në rregulloren e njësisë bazë. Koordinatori për programin e studimit Bachelor në "Teknologji Informacioni" është caktuar konform Rregullores së Programit të studimit.</p> <p>Evid. 5. Rregullore e programit të studimit (Bachelor në TI) Evid. 6. Rregullore për Funksonimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë Evid. 30. Urdhër Koordinatorët dhe NJSBC</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Njësia kryesore, Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit në Universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës në tërësi, dhe Departamenti i Teknologjisë së Informacionit në veçanti, përmbushin kriteret organizative në përputhje me ligjin 80/2015 për arsimin e lartë.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X




**Standardi II.3****Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se njësia bazë përgjegjëse për programin e ciklit të parë, Bachelor në Teknologji Informacioni, Departamenti i Teknologjisë së Informacionit, disponon dhe ka vënë në dispozicion të gjitha informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit si rregulloren dhe programin mësimor. Të dhëna që janë edhe në nivel të njësisë kryesore.</p> <p>Megjithatë, sikurse u theksua në standardin II.1, kriteri 3, disa prej informacioneve nuk janë të azhornuara dhe të njëjta mes dokumentacioneve zyrtare të këtij programi studimi. Përmendim këtu tabelën e vlerësimit.</p> <p>Evid. 5. Rregullore e programit të studimit (Bachelor në TI) Evid. 13. Riorganizimi i programit të studimit Bachelor në TI (2018) Evid. 14. Modeli i Diplomës TI, Urdhër i aprovimit dhe suplementi i diplomës Evid. 15. Syllabuset e Lëndëve Evid. 18. Plani mësimor TI Evid. 35. Vendim Senati për Kriteret e Pranimi të Studentëve Evid. 36. Vendim Senati për Kuotat Dok. Shtesë - Vendim i Dekanit FTI riorganizimi nën 20% Teknologji Informacioni Dok. Shtesë - Vendim Senati Akademik riorganizimi i programit Teknologji Informacioni Dok. Shtesë - Relacion mbi riorganizimin nën 20 % Bach Teknologji Informacioni</p>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	<p>Programi i studimit Bachelor në Teknologji Informacioni është i strukturuar në 3 vite akademike të organizuara në 6 semestra.</p> <p>Zhvillohen gjithsej 40 lëndë të ndara sipas 3 viteve:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- 10 lëndë në vitin e parë;</li><li>- 10 lëndë në vitin e dytë;</li><li>- 9 lëndë në vitin e tretë;</li></ul> <p>Në vitin e tretë është parashikuar edhe punimi i diplomës ose provimi i formimit me 6 kredite ECTS. Bazuar në legjislacionin kombëtar në fuqi (VKM 41/2018 i ndryshuar) lëndët janë ndarë</p>

	<p>në pesë kategori (A, B, C, D, E) dhe në përqindje në përputhje me aktet rregullatore në fuqi.</p> <p>Programi i studimit Bachelor në Teknologji Informacioni është organizuar në lëndë e module të vlerësuara në kredite.</p> <p>Megjithatë, institucioni ka parashikuar në planin mësimor si dhe në syllabuset e lëndëve numrin total të krediteve ECTS por jo ndarjen e tyre në aktivitete formuese si Leksione, Ushtrime/Seminare, Laboratorë, detyra/Projekte kursi, praktika, etj.</p> <p><i>Në planin mësimor është parashikuar vetëm një aktivitet didaktik formues, më konkretisht vetëm Leksione. Nuk ka të parashikuara aktivitete didaktike si Seminare, Laborator apo detyra/projekte kursi, praktika etj.</i></p> <p>Gjatë vizitës në institucion, dhe në veçanti në takimin me stafin akademik i cili u pyet rreth këtij argumenti, u sqarua se pavarësisht se në plan-programet e lëndëve, nuk është parashikuar në zë të veçantë aktiviteti laboratorik, zhvillimi i tyre është i integruar ku për lëndë karakterizuese zhvillohet në laboratorët e informatikës. Kjo bën të mundur që ushtrimet e parashikuara për lëndën, përveç trajtimit teorik të mirëfilltë, zhvillohen si zgjidhje kompjuterike nga studentët gjatë këtyre seancave ushtrimore.</p> <p>Gjatë takimit me organet drejtuese, u shpjegua se në hartimin e planit mësimor, është ndjekur metodologji në formatin anglo-amerikan, duke i përfshirë të gjitha aktivitetet didaktike (Leksione, seminare, ushtrime, laborator, detyra/projekte kursi etj.) në një të vetëm, të quajtura “Orë të integruara”. Por ky format nuk është në përputhje të plotë me organizimin e vetë institucionit në rregulloret e tij, sikurse është përmendur më sipër në Standardin II.1, kriteri 1 dhe 3. Për cdo lëndë, në planin mësimor është parashikuar ngarkesa mësimore në auditor si ngarkesë totale dhe ajo jashtë tij.</p> <p>Megjithatë, ngarkesa në auditor, rezulton më e ulët se ajo për programe të ngjashme studimi të pofruara nga institucione të tjera të arsimit të lartë, sikurse është paraqitur në Standardin II.1, kriteri 6 më sipër.</p> <p>Evid. 15. Syllabuset e Lëndëve Evid. 18. Plani mësimor TI</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët</p>	<p>Institucioni, dhe në veçanti, Njësia Bazë Departamenti i Teknologjisë së Informacionit, propozon vit për vit kriteret specifike të pranimit bazuar në cilësinë dhe programet e maturantëve dhe nevojat e tregut për profilin Bachelor në</p>



<p>që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Teknologji Informacioni. Në rregulloren e njësisë kryesore dhe në atë të programit të studimit janë të përcaktuara qartë kriteret dhe procedurat lidhur me transferimet, njohjen e krediteve dhe ekuivalentimin e tyre. Kriteret specifike dhe mënyrat e vlerësimit dhe njohjen e krediteve propozohen nga njësia bazë dhe janë pjesë e procedurës së ekuivalentimit të njohurive të mëparshme të studentit nga komisionet <i>ad-hoc</i> që ngrihet kur ka kërkesa për transferime.</p> <p>Evid. 3. Rregullore UAMD Evid. 4. Rregullore FTI Evid. 5. Rregullore e programit të studimit (Bachelor në TI)</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikant, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Për programin e studimit Bachelor në Teknologji Informacioni, janë paraqitur programet e lëndëve të cilat janë të klasifikuara në kategori A, B, C, D dhe E. Programi i lëndës jep informacion mbi pedagogun që do të zhvillojnë modulit/lëndën dhe semestrin kur zhvillohet, tipologjinë e modulit/lëndës kohëzgjatjen e modulit; kreditet ECTS; objektivat e modulit/lëndës; elementët e mësimdhënies; detyrimet e studentit; format e kontrollit të dijeve dhe vlerësimin e tyre, si dhe literaturën.</p> <p>Syllabuset, për secilën lëndë, ofrojnë informacionet e nevojshme lidhur me ngarkesën totale për studentin, por pa e ndarë atë në ngarkesë në auditor dhe jashtë tij. Paraqitet gjithashtu përshkrimi i lëndës, objektivat e lëndës, temat për secilën javë, literaturë kryesore dhe mbështetëse, rezultatet e të nxënies të lëndës, kontributi i lëndës në kompetencat e programit të studimit dhe metodat e vlerësimit të njohurive. Megjithatë, institucioni në programet e lëndëve nuk ka caktuar qartë ndarjen në kredite të aktiviteteve didaktike formuese, por vetëm ngarkesën që ato paraqesin për studentin në total, pra 1 ECTS = 25 orë studimore.</p> <p>Nga analiza e detajuar e syllabuseve të lëndëve të këtij programi studim, vihet re se në disa prej tyre është paraqitur pedagogu i lëndës dhe jo titullari i saj, lektor që në disa lëndë ka kualifikimin “Master i Shkencave”. Kultojmë se për zhvillimin e leksioneve në auditor, personeli akademik duhet të jetë i kategoris “lektor”, pra të ketë së paku gradën shkencore “Doktor”, ndërsa në zhvillimin e aktiviteteve didaktike si seminare, laborator etj., personeli akademik që angazhohet duhet të ketë së paku formimin e një cikli më të lartë se ai programit të studimit ku angazhohet. Në rastin e këtij programi studimit, duhet të jetë së paku me kualifikimin “Master i</p>



	<p>Shkencave”. Për më shumë, shih Standardin II.1, kriteri 1, më sipër.</p> <p>Evid. 15. Syllabuset e Lëndëve Evid. 18. Plani mësimor TI</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur dhe në gjetjet gjatë vizitës në institucion, vërejmë se njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhohet në përditësimin e vazhduar të programit të studimit që ofron. Në veçanti, në fund të vitit akademik, pedagogët e përfshirë në programin e studimit që po analizojmë, hartojnë një relacion përshkruar për të gjitha aspektet e mësimdhënies duke vënë në dukje problematika të hasura dhe sugjeruar zgjidhje për të ardhmen. Gjithashtu, institucioni përdor edhe raportet e vlerësimit të hartuara nga NJSBC-ja për përditësimin e programit të studimit.</p> <p><i>Megjithatë, sikurse vihet re edhe nga pyetësorë e përdorur për të mbledhur informacione rreth programit të studimit dhe nevojave të tregut, edhe pse ka lindur nevoja për më shumë praktikë, ajo nuk është pasqyruar në përditësimet e planeve mësimore.</i></p> <p>Dok. Shtesë - Vendim i Dekanit FTI riorganizimi nën 20% Teknologji Informacioni Dok. Shtesë - Vendim Senati Akademik riorganizimi i programit Teknologji Informacioni Dok. Shtesë - Relacion mbi riorganizimin nën 20 % Bach Teknologji Informacioni</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Programi i studimit dhe dokumentacioni përbërës si plani mësimor, syllabuset e lëndëve, rregullorja e programit të studimit dhe ajo e praktikës mësimore, janë të detajuara por në disa elementë, si në tabelën e vlerësimit apo edhe në ndarjen në orë në auditor në aktivitete formuese, nuk janë në përputhje mes tyre, apo me aktet ligjore në fuqi.</i></p> <p><i>Institucioni të hartojë syllabuset e lëndëve duke paraqitur edhe titullarin me kualifikimin në përputhje me ligjin 80/2015 për arsimin e lartë. Syllabuset duhet të paraqesin informacion rreth mënyrës së vlerësimit në notë dhe me shkronja sipas sistemit Amerikan, në përputhje me aktet e tjera rregullatore të institucionit, sikurse është rregullorja e njësisë kryesore dhe suplementi i diplomës</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	



#### Standardi II.4

**Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Emërtimi, përmbajtja dhe shpërndarja e lëndëve sigurojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të nevojshme për punësimin e studentëve. Lëndët që përdorin kanë të nevojshme aftësimin laboratorik dhe zhvillohen në ambiente laboratorike ndihmojnë aftësimin e studentëve në fushën e teknologjisë së informacionit duke i formuar si kandidatë shumë të mirë për në tregun e punës. Mungesa e praktikave profesionale që të mund të realizohen pranë institucioneve publike apo private shihet nga GVJ si një mangësi për të rritur punësimin e studentëve dhe në përvetësimin e njohurive sipas nevojave të tregut të punës. Megjithatë, personeli akademik është i përkushtuar ndaj dhënies së njohurive praktike studentëve dhe kjo vërehet edhe në takimin me studentët, ku prej tyre u konfirmua impenjimi i stafit akademik në orë praktike si në laborator ashtu edhe në punime individuale të studentëve. Institucioni ka në funksion një sërë marrëveshjes institucionale, por kapacitetet e tyre nuk janë shfrytëzuar plotësisht në funksion të programit të studimit, aq më tepër që plani mësimor nuk parashiko një lëndë praktike.</p> <p>Evid. 5. Rregullore e programit të studimit (Bachelor në TI) Evid. 15. Syllabuset e Lëndëve Evid. 18. Plani mësimor TI</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.</p>	<p>GVJ konstaton se lëndët e programit të studimit, shpërndarja e tyre në vite dhe semestra, si dhe vlerësimi në kredite mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit si dhe të rezultateve të pritshme të të nxënit dhe të aftësimit profesional. Në përgjithësi, për çdo lëndë, institucioni ofron për studentët më shumë se një orar frekuentimi me të njëtin pedagog apo me pedagog të tjerë që zhvillojnë të njëjtën lëndë në të njëjtin semestër. Kjo u jep studentëve më shumë mundësi dhe lirshmëri për të caktuar orarin më të përshtatshëm për frekuentim në cdo semestër, apo edhe të frekuentojnë lëndën në një orar tjetër, kur për arsye objektive nuk kanë mundur ta frekuentojnë në orarin e caktuar.</p> <p>Në caktimin e orareve, në fillim të çdo semestri, institucioni cakton një apo më shumë orare për zhvillimin e lëndëve, dhe studentët zgjedhin, duke u regjistruar, se në cilin orar do të frekuentojnë atë lëndë. Kur numri i studentëve që e kanë</p>

	<p>kërkuar atë orar, është jo i ulët, atëherë ai orar zyrtarizohet, në të kundërt, studentët sugjerohet të zgjedhin nga oraret e tjera të disponueshëm.</p> <p>Nga GVJ, kjo vlerësohet si një nismë shumë pozitive e institucionit, i cili vendos kështu një urë komunikimi dhe lirshmërie mes studentit dhe institucionit.</p> <p>Evid. 15. Syllabuset e Lëndëve Evid. 18. Plani mësimor TI ANEKS Tabela permbledhese FTI Teknologji Informacioni</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Në planin mësimor nuk janë të ndara qartazi orët teorike nga ato praktike/laboratorike. Institucioni e paraqet planin mësimor si orët të integruara në auditor, në të cilat janë të përfshira të gjitha aktivitetet didaktike të nevojshme për lëndën, përfshirë këtu leksionet teorike, seminare/ushtrime, aktivitete laboratorike, detyra/projekte kursi.</p> <p>Megjithatë, numri i ulët në tërësi i orëve të integruara në auditor, shihet nga GVJ, si një nevojë për përmirësim në përçimin e njohurive apo në thellimin e tyre tek studentët. Kjo nevojë lidhet edhe me specifikat e fushës së studimit, ku për përvetësimin e disa prej argumentave, apo edhe në përçimin e plotë të argumentave që ofrohen në këtë lloj programi studimi, janë të nevojshme më shumë orë në auditor.</p> <p>Kjo duket edhe më e nevojshme nëse i referohemi cilësisë së studentëve të pranuar në këtë program studimi, ku nota mesatare në hyrje për tre vitet akademik është rreth 7.6.</p> <p><i>Sugjerojmë institucionin të shohë mundësinë e rritjes së orëve në auditor për këtë program studimi sikurse është paraqitur edhe në Standardin II.1.</i></p> <p><i>Institucioni të rishohë planin mësimor dhe syllabuset e lëndëve duke shprehur qartazi së paku ngarkesën në kredite ECTS dhe orë në auditor për aktivitetet laboratorike, si një prej aktiviteteve më të rëndësishme në formimin e studentëve në fushën e këtij programi studimi.</i></p> <p>Evid. 15. Syllabuset e Lëndëve Evid. 18. Plani mësimor TI</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të</p>	<p>Mungesa e një ndarje të qartë të aktiviteteve didaktike, potencialisht mund të jetë një vështirësi në transferimin e studimeve nga UAMD drejt institucioneve të tjera të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit. Kjo pasi mungesa e këtij informacioni në planin mësimor dhe në syllabuse, mund të pengojë apo vështirësojë proceset e ekuivalentimeve në</p>



<p>studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>institucionet e arsimit të lartë të cilët përdorin ndarjen në kredite ECTS për të gjitha aktivitetet didaktike.</p> <p><i>Sugjerohet institucionin të rishohë planin mësimor dhe syllabuset e lëndëve duke përcaktuar qartazi kreditet ECTS dhe orët në auditor për secilin aktivitet didaktik.</i></p> <p><i>Nëse institucioni gjykon se formati i studimit për këtë program, duhet të jetë ai i formatit Amerkian, të paraqesi në syllabus, përqindjen e orëve që aktivitetet formuese kanë në secilën lëndë për të mundësuar kështu uniformim të plotë me sistemin ECTS Evropian.</i></p> <p>Evid. 15. Syllabuset e Lëndëve Evid. 18. Plani mësimor TI</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në institucion, si dhe nga diskutimet me stafin akademik dhe drejtuesin e Departamentit të Teknologjisë së Informacionit, GVJ evidentoi praktikën e punës së institucionit, ku në fillim të çdo viti akademik bëhet rishikimi i përmbajtjes së syllabuseve dhe programit të studimit, diskutohen nevojat për ndryshimet dhe përmirësimet e nevojshme brenda normës së lejuar në një vit akademik.</p> <p>Kërkesa për ndryshimet në kurrikulën e programit të studimit parashtrohet nga titullari i lëndës në bashkëpunim me drejtuesin e njësisë bazë, dhe pasi miratohet në departament ndjek procedurat institucionale të miratimit në senatin akademik dhe më pas në ministrinë përgjegjëse për arsimin.</p> <p>Programi i studimit, objekt i këtij vlerësimi të jashtëm, është në nivel Bachelor, dhe gati 20% të planit mësimor përbëhet nga lëndë të kategorisë A (Lëndë Bazë) të cilat përfshijnë lëndë të grupimeve matematikë, fizikë e të tjera të ngjashme. Për një pjesë prej tyre, ndryshimet në plane-programet janë shumë të vogla në vite për vetë natyrën e tyre si njohuri bazë. Për këto lëndë vërehet se literatura e detyruar jo gjithnjë është e viteve të fundit. Megjithatë, edhe gjatë vizitës në institucion dhe në takimin me stafin akademik, vihet re se edhe në këto lëndë, pedagogët përgjegjës azhurnojnë literaturën plotësuese me pjesë apo publikime të reja për të mundësuar përvetësimin e njohurive. Për natyrën e këtyre lëndëve, azhurnimi i literaturës është më i ngadaltë se për lëndë të kategorive të tjera.</p> <p>Evid. 15. Syllabuset e Lëndëve Evid. 18. Plani mësimor TI Dok. Shtesë - Vendim i Dekanit FTI riorganizimi nën 20% Teknologji Informacioni</p>

	<p>Dok. Shtesë - Vendim Senati Akademik riorganizimi i programit Teknologji Informacioni</p> <p>Dok. Shtesë - Relacion mbi riorganizimin nen 20 % Bach Teknologji Informacioni</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit Bachelor në Teknologji Informacioni garanton përfitim e njohurive, aftësive themelore (aftësive teknike dhe aftësive të tjera), si dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.</p> <p>Evid. 5. Rregullore e programit të studimit (Bachelor në TI)</p> <p>Evid. 15. Syllabuset e Lëndëve</p> <p>Evid. 18. Plani mësimor TI</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit promovon mundësi të mëtejshme të studimit dhe / ose punësimin e studentëve në përputhje me pritjet dhe kërkesat e tregut të punës. Kjo tregohet nga një shkallë e lartë e punësimit të të diplomuarve të studentëve në fushat e teknologjisë së informacionit në kompani si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj. Edhe nga studimi që ka bërë institucioni, rezulton një pritshmëria e lartë e punësimit të studentëve të këtij programi studimi.</p> <p>Evid. 5. Rregullore e programit të studimit (Bachelor në TI)</p> <p>Evid. 15. Syllabuset e Lëndëve</p> <p>Evid. 18. Plani mësimor TI</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Vlerësohet shumë pozitivisht nga GVJ, ofrimi i më shumë se një një orar frekuentimi për lëndët me të njëtin pedagog apo me pedagog të tjerë që zhvillojnë të njëjtën lëndë në të njëjtin semestër. Kjo u jep studentëve më shumë mundësi dhe lirshmëri për të caktuar orarin më të përshtatshëm për frekuentim në cdo semestër, apo edhe të frekuentojnë lëndënë në një orar tjetër, kur për arsye objektive nuk kanë mundur ta frekuentojn në orarin e caktuar.</i></p> <p><i>Megjithatë, ka një numrë të ulët në tërësi të orëve në auditor për të përçuar mjaftueshëm njohuri dhe në cilësi tek studentët e këtij programi studimi. Institucioni të shohë mundësinë e rritjes së numrit të orëve në auditor.</i></p> <p><i>Ndarja e aktiviteteve formuese nuk është e plotë dhe në përputhje me sistemin ECTS ku nuk janë të përcaktuara kreditet dhe orët në auditor për aktivitetet formuese.</i></p> <p><i><u>Sugjerojmë</u> institucionin të rishohë planin mësimor dhe syllabuset e lëndëve duke përcaktuar qartazi kreditet ECTS dhe orët në auditor për secilin aktivitet didaktik, sidomos për pjesën laboratorike.</i></p>

	<i>Nëse institucioni gjykon se formati i studimit për këtë program, duhet të jetë ai i formatit Amerkian, të paraqesi në syllabus, përqindjen e orëve që aktivitetet formuese kanë në secilën lënë për të mundësuar kështu uniformim të plotë me sistemin ECTS Evropian.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

### Standardi II.5

**Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	<p>Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit ka një marrëdhënie të konsoliduar bashkëpunimi me aktor të tregut të punës, madje me mbështetjen e tyre ka ngritur edhe laboratorë. Ndërt to përmendim laboratorët e ngritur me mbështetjen e Crystal System që prej vitit 2017. Edhe në analizën vjetore, institucioni vlerëson edhe nevojat e tregut të punës, të evidentuara nga pyetësorët, takimet e drejtëpërdrejta por edhe nga bashkëpunimet institucionale si me partnerët e biznesit ashtu edhe me ata akademik.</p> <p>Evid. 18. Plani mësimor TI Evid. 19. Analizë e Departamentit të Teknologjisë së Informacionit Evid. 20. Raporti vjetor për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë Evid. 27. Memorandum UAMD - Crystal System.PDF Evid. 28. Trajnime FTI - Crstal System Evid. 29. Laborator FTI Evid. 42. Pyetësor Student UAMD Evid. 43. Analiza e pyetësorëve (Student, Staf Akademik, Staf administrativ)</p>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe	Në UAMD, studentët janë të përfaqësuar në organet kolegjiale konform statutit dhe rregullores së UAMD. Për tej përfaqësimit në këto organe, institucioni përfshin opinionet e studentëve në diskutimet e brendshme të njësive bazë për përmirësimin e vazhduar të programve që ofrohen. Institucioni përdor me efikasitet edhe metodat e komunikimit “sociale” midis studentëve dhe institucionit, përfshirë këtu komunikimet

reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	<p>online në rrjete sociale të sekretarisë mësimore, të Zv. Dekanit apo edhe drejtueseve të njëjësive bazë.</p> <p>Evid. 20. Raporti vjetor për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë</p> <p>Evid. 42. Pyetësor Student UAMD</p> <p>Evid. 43. Analiza e pyetësorëve (Student, Staf Akademik, Staf administrativ)</p> <p>Dok. Shtesë - Evid. të komunikimit online (facebook etj.) të studentëve me institucionin FTI</p>			
<b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionalë (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	<p>Njësia bazë, përgjegjëse për këtë program studimi, realizon në mënyrë të përvitshme një analizë në tërësi të aktivitetit të saj, përfshirë edhe atë të nevojave për përmirësim të vazhduar të ofertës së saj didaktike.</p> <p>Evid. 19. Analizë e Departamentit të Teknologjisë së Informacionit</p> <p>Evid. 20. Raporti vjetor për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë</p> <p>Evid. 42. Pyetësor Student UAMD</p> <p>Evid. 43. Analiza e pyetësorëve (Student, Staf Akademik, Staf administrativ)</p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit në tërësi, dhe Departamenti i Teknologjisë së Informacionit në veçanti, analizojnë dhe marrin opinionet e bashkëpunorëve si nga tregu i punës ashtu edhe nga ai akademik i institucioneve partnere.</i></p> <p><i>Bashkëpunimi me industrinë është i frytshëm dhe ka rezultuar në ngritjen e laboratorëve të teknologjisë së informacionit dhe në trajnimin e stafit akademik dhe të studentëve të këtij programi studimi.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>  <b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>  <b>X</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
--	-----------------------	------------------------------	---	------------------------------





### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<b>Standardi III.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe nga të dhënat e mbledhura gjatë vizitës në institucione vërehet se transmetimi i dijeve në auditor realizohet në ato që i quajnë “Orë të integruara mësimore” ku gërshetohen pjesa e leksioneve teorike, e ushtrimeve/seminareve dhe e laboratorëve, duke mos i ndarë ato mes tyre si përqindje.</p> <p>Takimi me organet drejtuese dhe stafin akademik të angazhuar në këtë program studimi deklaruan se UAMD ndjek modelin amerikan për zhvillimin e orëve të pa ndara në elementët e mësipërm. Është stafi akademik i cili në varësi të specifikave të lëndëve, nevojave të studentëve, balancon aktivitetin didaktik mes formave të ndryshme të mësimdhënies.</p> <p>Evid. 18. Plani mësimor TI Evid. 20. Raporti vjetor për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë Evid. 42. Pyetësor Student UAMD Evid. 43. Analiza e pyetësorëve (Student, Staf Akademik, Staf administrativ)</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Në takimin me studentët e këtij programi studimi, por edhe me stafin akademik të angazhuar në këtë program, vërehet një bashkëpunim i ngushtë mes stafit akademik dhe studentëve. Edhe nga ana institucionale, ofrohet mundësia që studentët të zgjedhin për të njëjtën lëndë, një nga disa orare/ditë të javës kur ajo zhvillohet nga i njëjti pedagog apo nga pedagog të tjerë që zhvillojnë të njëjtën lëndë. Kjo mënyrë, i lejon institucionit të përgjigjet nevojave të studentëve për organizimin e orarit mësimor. Edhe stafi akademik, për mënyrën e organizimit të procesit mësimor në orë të integruara, mundëson përshtatjen dinamike të procesit didaktik në bazë të nevojave të studentëve dhe njohurive të tyre paraprake.</p> <p>Evid. 19. Analizë e Departamentit të Teknologjisë së Informacionit Evid. 20. Raporti vjetor për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë Evid. 42. Pyetësor Student UAMD</p>

	Evid. 43. Analiza e pyetësorëve (Student, Staf Akademik, Staf administrativ)
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxëniet.</p>	<p>Institucioni në tërësi mbështet dhe angazhohet në avancimin akademik të personelit akademik. Një formë e mbështetjes është pjesëmarrja në aktivitete ndërkombëtare si Erasmus+ për shkëmbim stafi dhe studentësh. Formë tjetër mbështetje është me anë të marrëveshjeve të bashkëpunimit me biznese në fushën e teknologjisë së informacionit dhe trajnimeve të realizuara prej tyre si rasti i kompanisë “Crystal Systems”.</p> <p>Institucioni ka edhe një qendër për Edukimin në Vazhdim e cila ofron shërbimet e saj për grupet e interesit, kryesisht në sistemin parauniversitar apo atë fillor. Megjithatë vërehet se personeli akademik i kësaj njësie kryesore, nuk është i angazhuar në këtë qendër.</p> <p>Gjykojmë se fusha e ekspertizës e personelit akademik të njësisë kryesore, Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit, është në përputhje me objektivat e Qendrës për Edukim në Vazhdim, dhe mund të jap një kontribut në rritjen e kapaciteteve të kësaj qendre. Kjo gjithashtu shërben edhe për rritjen dhe diversifikimin e mundësive të të ardhurave për njësinë bazë dhe atë kryesore, që nuk garantohen më vetëm nga buxheti i shtetit dhe tarifat e studentëve, por edhe nga aktivitete të tjera për të tretët.</p> <p>Evid. 28. Trajnime FTI - Crstal System Evid. 41. Rregullore Qendra për Edukim në Vazhdim</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë</p> <p>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e</p>	<p>Në përgjithësi personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është i kualifikuar në fushën e lëndëve ku angazhohen.</p> <p>Bazuar në DVV dhe në informacionin e siguruar gjate vizitës në institucion, GVJ konstaton se personeli akademik i programit të studimit vlerëson dhe përmirëson format dhe metodat e mësimdhënies në mënyre të vazhdueshme, në të cilën mbështet nga infrastruktura e vene në dispozicion, trajnimet dhe pjesëmarrjet në projekte e shkëmbimit të eksperiencës me institucione akademike në vend dhe jashtë.</p> <p>Gjatë takimit me studentët dhe stafin akademik, GVJ konstaton se personeli akademik përdor metoda interaktive duke i bërë tërheqëse orët e mësimet. Këto metoda përfshijnë simulime, video, detyrë kursi, diskutime, prezantime etj. Përdorimi i infrastrukturës laboratorike në mësimdhënie të venë në dispozicion nga njësia kryesore, si dhe aktivitetet praktike/laboratorike e kane rritur efektivitetin e metodave dhe interaktivitetin në mësimdhënie.</p>

<p>marrëdhëniet e respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Evid. 15. Syllabuset e Lëndëve Evid. 16. CV e stafit Akademik Evid. 17. CV e stafit ndihmës akademik</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.</p>	<p>GVJ konstaton se një nga objektivat strategjik të Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës, është “Cilësia dhe performanca Akademike”. Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet se strukturat përgjegjëse kanë zhvilluar mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p> <p>Bazuar në DVV dhe informacioni përgjatë vizitës në Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit konstatohet se njësia përgjegjëse për monitorimin në mënyrë periodike të aftësive të mësimdhënies se personelit akademik dhe ndihmës akademik është njësia bazë. Drejtuesi i njësisë bazë analizon në fund të çdo semestri performancën e çdo anëtari të departamentit dhe me pas kontakton çdo anëtar për të shprehur gjetjet dhe mundësitë për përmirësim të mëtejshëm. Nga ana tjetër UAMD ka zhvilluar të gjitha mekanizmat për monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë, kështu janë rregulluar me rregulloret përkatëse zyrat për monitorimin e brendshëm të cilësisë dhe raportimi përkatës pranë njësive kryesore dhe bazë.</p> <p>UAMD përfshin studentët në vlerësimin periodik të formave dhe metodave të mësimdhënies duke ju dhënë mundësi atyre të plotësojnë pyetësorë periodikë për vlerësimin e të gjithë aspekteve akademike dhe administrative të jetës studentore.</p> <p>Evid. 19. Analizë e Departamentit të Teknologjisë së Informacionit Evid. 20. Raporti vjetor për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë Evid. 42. Pyetësor Student UAMD Evid. 43. Analiza e pyetësorëve (Student, Staf Akademik, Staf administrativ)</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së</p>	<p>Në bazë të dokumenteve të vëna në dispozicion nga institucioni konstatohet se rezultatet e vlerësimit të cilësisë përpunohen dhe përmbledhen në një raport periodik. Këto rezultate raportohen me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. NJBSC përgatit raportin e vlerësimeve periodike dhe i vë në dispozicion të strukturave drejtuese, pedagogëve dhe palëve të tjera të interesuar. Rezultatet e vlerësimit shërbejnë për përmirësimin e mësimdhënies në auditor të personelit akademik, nëpërmjet trajnimeve të vazhdueshme ku promovohen shembuj të praktikave të mira. UAMD është angazhuar në disa projekte ndërkombëtare dhe</p>

<p>mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>ka nënshkruar disa marrëveshje bashkëpunimi me universitete ndërkombëtare me të cilat inkurajon dhe stimulon stafin të marre pjese në programe shkëmbimi siç janë Erasmus+, KA1 dhe KA2, ku një nga përfitimet kryesore është përmirësimi i aftësive të personelit akademik në mësimdhënie.</p> <p>Evid. 6. Rregullore për Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë Evid. 20. Raporti vjetor për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë Evid. 30. Urdhër Koordinatorët dhe NJSBC</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>UAMD ka të ngritur mekanizma për monitorimin e brendshëm të cilësisë, mekanizma të cilët përfshijnë edhe studentët si një hallkë e rëndësishme e procesit të monitorimit dhe përmirësimit të cilësisë.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

**Standardi III.2**

**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>GVJ konstaton se kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale janë të përcaktuara në rregulloren e UAMD, në veçanti neni 68, Kotrolli i Dijeve, Neni 69, Zhvillimi i Provimeve, Neni 70, Rregullat e provimit dhe neni 71, Ankimimi i provimeve.</p> <p>Mënyrat e testimit e vlerësimit të njohurive janë pjesë edhe e syllabuseve të cilat së bashku me rregulloren u bëhen të njohura studentëve javën e parë të çdo semestri akademik.</p> <p>Studenti ka të drejtë të marrë pjesë në provim për vlerësimin e njohurive nëse ka frekuentuar jo më pak se 75% të orëve në auditor të lëndës. Nota përfundimtare është rezultat i kombinimit në masën 400 pikë provimi i parë i ndërmjetëm i lëndës, 500 pikë provimi përfundimtar dhe 100 pikë përfshijnë vlerësimin e pjesëmarrjes, detyrave të kursit.</p>

	<p>Megjithatë, në tabelën e vlerësimit me notë kundrejt pikëve të fituara nga studenti gjatë testimit të njohurive, ka mospërputhje mes rregulloreve të UAMD, syllabuseve dhe suplementit të diplomës. Sikurse e kemi përmendur në standardin II.1, kriteri 3 më sipër.</p> <p><i>Sugjerime institucionin të rishikojë rregulloret e brendshme, syllabuset e lëndëve, duke evituar duplikimin e informacioneve, që në rast ndryshimesh, paraqesin një probabilitet shumë të lartë të mbeten të pa azhornuara dhe me informacion kontratidktor si në këtë rast.</i></p> <p><i>Sugjerime, që ato informacione që janë statike, si tabela e konvertimit, të përmendete vetëm në një rregullore institucionale, dhe të referohet në atë rregullore në të gjithë dokumentat e tjerë që e kanë të nevojshëm këtë informacion.</i></p> <p>Evid. 3. Rregullore UAMD  Evid. 4. Rregullore FTI  Evid. 5. Rregullore e programit të studimit (Bachelor në TI)  Evid. 15. Syllabuset e Lëndëve</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Nga takimi me studentët dhe me stafin akademik, GVJ konstaton se në Departamenti i Teknologjisë së Informacionit, për programet që mbulon, informon studentët mbi metodologjinë e testimit dhe vlerësimit të njohurive dhe dijeve.</p> <p>Format e kontrollit të dijeve janë të ndryshme, bazuar në specifikat e secilës lëndë. Forma të cilat janë të përcaktuara në plan-programin e lëndës dhe u bëhen të ditur studentëve në javën e parë të procesit mësimor. Studentët informohen rregullisht edhe mbi planet mësimore dhe kurrikulën e programit të studimit, këtu një rol të rëndësishëm luan edhe koordinatori i programit të studimit, si dhe informacione që studentët marrin edhe nga rrjetet sociale që menaxhohen në mënyrë zyrtare nga institucioni.</p> <p>Informacion të hollësishëm studentët përveç informimit nga pedagogu i lëndës gjejnë edhe në syllabuset e lëndëve, ku në varësi të natyrës së lëndës, nga çdo pedagog, në përputhje me rëndësinë që ka aspekti aplikativ përcaktohet pesha e secilit element në vlerësimin përfundimtar të cilat i bëhen të ditura studentit. I gjithë informacioni mbi përmbajtjen e programit të studimit gjendet lehtësisht në ambientet e njësisë bazë, sikurse edhe në faqen zyrtare UAMD dhe në faqet e UAMD në rrjetet sociale.</p> <p>Evid. 15. Syllabuset e Lëndëve  Evid. 19. Analizë e Departamentit të Teknologjisë së Informacionit</p>

	Dok. Shtesë - Evid. të komunikimit online (facebook etj.) të studentëve me institucionin FTI
<b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	GVJ konstaton se testimi e vlerësimi i njohurive realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme. Format kryesore të kontrollit për vlerësimin e nivelit të dijeve gjatë zhvillimit të kursit teorik dhe praktik të një lënde janë: Provimi i ndërmjetëm [0-400 pikë, Niveli i pjesëmarrjes në seminare, detyra kursi [0-100 pikë, Provimit përfundimtar [0-500 pikë. Në takimin me studentët na konfirmuan që përfshirja e këtyre formave të vlerësimit u jep mundësinë të gjithë studentëve të shprehin format e veçanta të aftësive dhe talenteve të tyre, dhe të mbrojnë kompetencat e fituara gjatë procesit mësimor.  Evid. 15. Syllabuset e Lëndëve Evid. 20. Raporti vjetor për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë
<b>Kriteri 4.</b> Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Bazuar në dokumentacionin në dispozicion si dhe në takimet me studentët e këtij programi studimi, vihet re se format dhe metodat e mësimdhënies vlerësohen në mënyrë periodike nga studentët nëpërmjet pyetësorëve. Vlerësime që më pas bëhen pjesë e analizës në njësinë bazë dhe nëse gjykohen, përdoren për përmirësimin në vazhdim të shërbimeve të ofruara nga njësia bazë dhe ajo kryesore për studentët.  Evid. 19. Analizë e Departamentit të Teknologjisë së Informacionit Evid. 20. Raporti vjetor për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë Evid. 42. Pyetësor Student UAMD Evid. 43. Analiza e pyetësorëve (Student, Staf Akademik, Staf administrativ)
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë te studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin	Përdorimi nga institucioni i "orëve të integruara" ku pedagogu i lëndës gërsheton anën teorike të lëndës me zbatime praktike në ambient laboratorik, në veçanti për lëndë karakterizuese të këtij programi studimi, mundësojnë përshtatjen e formave të transmetimit të njohurive tek studentët. Gjithashtu studentët motivohen për projekte praktike individuale apo punime në grup, punime të cilat prezantohen përpara pedoagut të lëndës dhe studentëve të tjerë që frekuentojnë atë lëndë. Kjo mundëson zhvillimin e autonomisë së studentit i cili jo vetëm përvetëson njohuritë, por mëson edhe ti përçojë ato.  Nga këto aktivitete, sidomos në programet e studimit të ciklit të dytë, master, kanë rezultuar edhe në hartimin e prezantimeve dhe projekteve në konferenca studentore të realizuara brenda institucionit.

dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Evid. 26. Liste MoU Evid. 27. Memorandum UAMD - Crystal System Evid. 28. Trajnime FTI - Crstal System Dok. Shtesë - Informacione rreth trajnimeve të stafit, (edhe nga projektet)			
<b>Konkluzione</b>	<i>UAMD ka të hartuar qartë dhe në detaje në rregulloret institucionale të gjitha procedurat për vlerësimin e dijeve, shpalljen e rezultateve si dhe shqyrtimin e ankimimeve apo nevojave për qartësime të studentëve.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi III.3

**Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	<p>Mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale janë të përcaktuara në rregulloren e UAMD, në veçanti neni 68, Kontrolli i Dijeve, Neni 69, Zhvillimi i Provimeve, Neni 70, Rregullat e provimit dhe neni 71, Ankimimi i provimeve.</p> <p>GVJ konstaton se testimi e vlerësimi i njohurive realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme. Format kryesore të kontrollit për vlerësimin e nivelit të dijeve gjatë zhvillimit të kursit teorik dhe praktik të një lënde janë: Provimi i ndërmjetëm [0-400 pikë, Niveli i pjesëmarrjes në seminare, detyra kursi [0-100 pikë, Provimit përfundimtar [0-500 pikë. Në takimin me studentët na konfirmuan që përfshirja e këtyre formave të vlerësimit u jep mundësinë të gjithë studentëve të shprehin format e veçanta të aftësive dhe talenteve të tyre, dhe të mbrojnë kompetencat e fituara gjatë procesit mësimor.</p> <p>Evid. 3. Rregullore UAMD Evid. 4. Rregullore FTI Evid. 5. Rregullore e programit të studimit (Bachelor në TI) Evid. 15. Syllabuset e Lëndëve</p>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të	<p>Aktualisht testimi dhe vlerësimi i njohurive në Universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës, realizohet duke kombinuar metodat tradicionale (provimet me shkrim dhe ato me gojë) si</p>

<p>ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>dhe format elektronike si hartimi, postimi dhe prezantimi i detyrave/projekteve të kursit.</p> <p>Evid. 15. Syllabuset e Lëndëve</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Në takimin me studentët e këtij programi studimi, studentët konfirmuan se mënyra e vlerësimit të njohurive u bëhet e ditur nga pedagogu i lëndës që javën e parë të leksioneve. Mënyra dhe forma të vlerësimit të cilat janë të paraqitura edhe në syllabusin përkatës të lëndës si dhe në rregulloret institucionale.</p> <p>Evid. 3. Rregullore UAMD Evid. 4. Rregullore FTI Evid. 5. Rregullore e programit të studimit (Bachelor në TI) Evid. 15. Syllabuset e Lëndëve</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënimit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Vlerësimi i njohurive bëhet sipas rregulloreve në fuqi të institucionit. GVJ nga dokumentacioni dhe takimi me studentët konstaton se në kontrollin e dijeve vlerësohen njohuritë dhe puna individuale e studentit. Nëpërmjet komunikimit të drejtpërdrejtë, stafi akademik gjatë orëve të seminareve u ofron studentëve komente /feedback për performancën e tyre lidhur me përvetësimin e njohurive gjatë seminareve/testimeve të ndërmjetme, nivelit të përgatitjes/prezantimeve të detyrave të kursit/projekteve, duke iu dhënë këshilla/orientime për përmirësimin e performancës në të ardhmen. Edhe në korrigjimin e provimeve, ato shoqërohen me komente në lidhje me gjetjet e pedagogut dhe motivin e vlerësimit.</p> <p>Evid. 42. Pyetësor Student UAMD Evid. 43. Analiza e pyetësorëve (Student, Staf Akademik, Staf administrativ)</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Departamenti dhe personeli akademik bazohen në rregulloren e provimit dhe të etikës lidhur me mënyrën e mbikëqyrjes, dhe të masave ndëshkuese në rast plagjiaturë gjatë procesit të provimit. Për sa i përket detyrave të kursit dhe kryesisht të punimeve të diplomave, personeli akademik dhe drejtuesit e departamentit dhe Fakultetit, orientojnë/miratojnë tematika kryesisht aplikative ose gjysmë aplikative, ku të dhënat që përdoren (kryesisht të punimet e diplomave) të jenë autentike. Për këto të fundit, përgjegjësinë kryesore për vlerësimin dhe shmangien e plagjiaturës e ka pedagogu udhëheqës. Çdo anëtar i stafit akademik dhe jo akademik sipas detyrave të ngarkuara është përgjegjës për garantimin e një niveli të lartë të ndershmërisë në çdo kohë dhe rrethanë, referuar dhe Kodit të Etikës.</p> <p>Evid. 3. Rregullore UAMD Evid. 4. Rregullore FTI</p>



	<p>Evid. 5. Rregullore e programit të studimit (Bachelor në TI) Evid. 15. Syllabuset e Lëndëve</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>GVJ, gjatë vizitës në Sekretarinë mësimore konstaton që vlerësimi kryhet me sistem prej 1000 pikësh i përkthyer në bazë notash nga 1 në 10. Nota më e ulët kaluese është nota 5. Rezultatet e provimit ju bëhen të njohura studentëve pedagogu i lëndës në orën dhe sallën e dakordësua paraprakisht me studentët. Gjatë vitit pedagogët janë të lirë të alternojnë metodat kontrolluese dhe vlerësuese të cilat përfshijnë kontroll të vazhdueshëm nëpërmjet provimeve, teste me pyetje alternative, quiz-e, prezantime në grup ose individuale, etj.</p> <p>Evid. 3. Rregullore UAMD Evid. 4. Rregullore FTI Evid. 5. Rregullore e programit të studimit (Bachelor në TI)</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Referuar takimit me studentet, GVJ konstaton se ata njohin të drejtën e tyre për ankimim sikurse është e saktësuar edhe në rregulloren e UAMD. Mbas shpalljes së rezultateve paraprake nga pedagogu, studenti ka të drejtën e kontestimit të mundshëm brenda afateve të përcaktuara në rregullore. Mbas kontestimit të notës nga studenti, kërkesa e tij për rivlerësim shqyrtohet nga komisioni i provimeve dhe pedagogu i lëndës të cilët më pas vendosin për notën përfundimtare.</p> <p>Mbas kësaj faze, sërish studentit ka të drejtën e kontestimit të notës duke paraqitur kërkesë pranë Dekanit të Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit. Kërkesë që shqyrtohet dhe nëse pranohet, analizohet nga një komision ad-hoc i ngritur me pedagog të lidhur me disiplinën që po vlerësohet.</p> <p>Gjatë takimit në institucion, dhe në veçanti me studentët e këtij programi studimi, u vu re se studentët në përgjithësi merrnin përgjigje apo qartësoshin rreth çdo paqartësie të mundshme direkt me pedagogët e lëndës pa patur nevojë të përshkallëzojnë kërkesat e tyre. Studentët vunë në dukje disponibilitetin e pedagogëve për sqarime dhe këshillime të studentëve.</p> <p>Evid. 3. Rregullore UAMD Evid. 4. Rregullore FTI Evid. 5. Rregullore e programit të studimit (Bachelor në TI)</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e</p>	<p>Të drejtat e studentit janë të përcaktuara në rregulloret institucionale të cilat kanë të përcaktuara të gjitha hallkat dhe mënyrat se si dhe kur studentit të kryej një ankesë, si shqyrtohet ajo dhe mënyra e informimit. Megjithatë, gjatë vizitës në institucion nuk u vu re një praktikë konkrete pasi studentët nuk kishin patur ankesa/kërkesa që të kërkonin përshkallëzime përtej njësisë bazë.</p>

përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Evid. 3. Rregullore UAMD Evid. 4. Rregullore FTI Evid. 5. Rregullore e programit të studimit (Bachelor në TI)			
<b>Konkluzione</b>	<i>UAMD ka të hartuar qartë dhe në detaje në rregulloret institucionale të gjitha procedurat për vlerësimin e dijeve, shpalljen e rezultateve si dhe shqyrtimin e ankimimeve apo nevojave për qartësime të studentëve.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### Standardi III.4

**Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	<p>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit përkatës konstaton se plani mësimor i programit të studimit përfshin lende teorike në fushën teknologjisë së informacionit si dhe përmbillet me punimin e diplomës. <i>Megjithatë, vërehet mungesa e një lënde/moduli “Praktikë Profesionale” e cila do të ndihmonte studentin të vinte në praktikë njohuritë e përftuara në një ambient real në tregun e punës.</i></p> <p>Departamenti ofron shërbime shtesë krahas procesit mësimor, të tilla si konsultime apo leksione të hapura. Stafi akademik motivon dhe përfshin studentët në veprimtari jashtë kurrikulare. Kjo kurrikul parapërgatit studentet për thellimin e studimeve në ciklin master.</p> <p>Nga shqyrtimi i plan-programeve të lëndëve vërehet se nuk janë parashikuar qartë orët laboratorike dhe ato të ushtrimeve, të cilat sipas institucionit janë të përfshira në ngarkesën e orëve totale në auditor në atë që e quajnë “orë të integruara”.</p> <p>Evid. 5. Rregullore e programit të studimit (Bachelor në TI) Evid. 10. Misioni dhe studimi i tregut të punës për programin e studimit</p>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së	<p>Programi i studimit garanton zhvillimin e veçantë në fushën e teknologjisë së informacionit si dhe e aftësive specifike në fushën e burimeve njerëzore, sociale, të komunikimit dhe bashkëveprimit. Për sa më sipër, në planin mësimor të këtij programi studimi, janë të parashikuara zhvillimi i lëndëve</p>

<p>informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.</p>	<p>karakterizuese në teknologjinë e informacionit dhe janë parashikuar gjithashtu edhe lëndë me karakter të përgjithshëm si lëndë për aftësimin në gjuhë të huaj (Anglishte teknike), lëndë për aftësimin logjik (Llogjika Dixhitale), aftësi menaxhuese (Hyrje në ekonomi, Sociologji, Baza e menaxhimit, Komonukimi në Publik) etj.</p> <p>Evid. 5. Rregullore e programit të studimit (Bachelor në TI) Evid. 15. Syllabuset e Lëndëve</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studentit, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>Bazuar në dokumentet e dosjes së vetëvlerësimit dhe në veçanti rregullores së programit të studimit dhe atyre institucionale, konstatohet se në fund të çdo semestri, kompetencat dhe aftësitë e studentëve, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e secilës lëndë, analizohen dhe rishikohen. Kujdes i veçantë u kushtohet lëndëve që janë në vijimësi të lëndëve të tjera në semestrat pasardhës dhe mbahet komunikim midis lektorëve të lëndëve që janë të ndërlidhura.</p> <p>Referuar takimit me stafin akademik, GVJ konstaton se në javet e fundit, pedagoget e lendes informojnë studentet mbi kompetencat e fituara që duhet të demonstrojnë në provim. Studentët orientohen në lidhje me strukturën dhe natyrën e pyetjeve që do të ketë provimi final dhe gjithashtu edhe për peshën që do të ketë në notën finale të modulit provimi final.</p> <p>Evid. 5. Rregullore e programit të studimit (Bachelor në TI) Evid. 15. Syllabuset e Lëndëve</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuarra kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e</p>	<p>Institucioni garanton qasje në laboratorët e teknologjisë së informacionit, për studentët e këtij programi studimi. Edhe pse në plan-programet e lëndëve nuk është e ndarë qartë aktiviteti laboratorik nga ai i leksioneve, seminareve dhe ushtrimeve, gjatë takimit në institucion dhe në veçanti me studentët e këtij programi studimi u konfirmua zhvillimi i lëndëve karakterizuese në ambiente të pajisur me PC, ku krahas analizës teorike, zhvillohen edhe aplikimet praktike në simulime, programim etj.</p> <p>Edhe nga stafi akademik, u vu në dukje, se zhvillimi i seancave laboratorike janë të gërshetuara me ato teorike (Leksione, seminare/ushtime) të cilat studentit motivohet ti zbatojë praktikisht në aktivitet laboratorik. Stafi akademik i njësisë bazë angazhohet në aktivitete shkencore, në konferenca, simpoziume dhe workshope, si dhe mundëson zhvillimin e orëve të hapura nga pedagog të ftuar pranë këtij institucioni</p> <p>Stafi akademik i Departamentit të Teknologjisë së Informacionit organizon diskutime me studentet për temat e diplomës, për mundësitë e punësimit të tyre, u prezanton</p>

mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	<p>pjesëmarrjen e departamentit në konferenca dhe simpoziume, merr pjesë dhe organizon grupe pune studimore me pjesëmarrjen e studentëve.</p> <p>Evid. 42. Pyetësor Student UAMD Evid. 43. Analiza e pyetësorëve (Student, Staf Akademik, Staf administrativ)</p>			
<b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	<p>Përgjatë vitit akademik, njësia bazë dhe ajo kryesore, përgjegjëse për këtë program studimi, organizon në mënyrë periodike leksione të hapura, trajnime, orë informuese etj. për studentët e saj. Këto orë mund të drejtohen nga personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar), përfaqësues biznesesh, ekspertë të ndryshëm etj. Këto aktivitete realizohen jashtë strukturës së programit të studimit dhe në orare që nuk bien ndesh me procesin mësimor.</p> <p>Evid. 32. Workshops</p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>Njësia bazë dhe ajo kryesore përgjegjëse për këtë program studimi, janë të angazhuar në rritjen e cilësisë në tërësi të ofertës akademike duke realizuar në mënyrë të vazhduar takime, seminare, workshop-e, në kuadër të bashkëpunimeve dhe në motivimin e studentëve drejt tregut të punës.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>


### Standardi III.5

**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.</p>	<p>Institucioni parashikon procesin e diplomimit të studentëve në tërësi në aktet e brendshme rregullatore. Rregullorja e njësisë kryesore dhe ajo e njësisë bazë paraqesin qartë procesin e diplomimit të studentëve që studiojnë në këtë program studimi.</p> <p>Procedura më specifike për provimin final dhe mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve gjenden në rregulloren e programit të studimit Bachelor në Teknologji Informacioni.</p> <p>Komisioni dhe kryetari i komisionit për provimin përfundimtar ose mbrojtjen e diplomës caktohen nga Përgjegjësi i njësisë bazë dhe miratohen nga Dekani. Kryetari i komisionit në bashkëpunim me anëtarët plotësojnë një program tematikash për lëndën e provimit të përgjithshëm përfundimtar, si dhe për</p>

	<p>tematikat e zhvillimit të punimeve të diplomave, hartohen nga stafi i brendshëm akademik dhe vihen në dispozicion të studentëve. Pedagogët punojnë me studentët, i orientojnë, i ndihmojnë të punojnë në mënyrë të pavarur dhe ndajnë materialet që mund t'i ndihmojnë ato të kryejnë punën e tyre kryesisht kërkimore.</p> <p>Evid. 4. Rregullore FTI Evid. 5. Rregullore e programit të studimit (Bachelor në TI)</p>
<p><b>Kriteri 2. Strukturat</b> përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Përgjegjës për mbarëvajtjen e të gjithë procesit akademik, përfshirë edhe diplomimin e studentëve, është njësia bazë, Departamenti i Teknologjisë së Informacionit. Kjo njësi harton, në bashkëpunim me të gjithë stafin akademik, një fond pyetjesh orientuese për studentët për përgatitjen e tyre për provimin përfundimtar të diplomimit. Fond pyetjesh që u vihen studentëve në dispozicion në zyrën e informimit pranë njësisë kryesore. Gjithashtu, për studentët që dëshirojnë të diplomohen duke mbrojtur një punim diplome, u caktohet një pedagog si udhëheqës i cili ka rol kyc në vlerësimin cilësor të punimit të studentit dhe në udhëqjen e tij. Pedagogu udhëheqës, përpara se studenti të fitojë të drejtën e mbrojtjes së punimit të diplomës, duhet të hartojë një raport pozitiv për veprimtarinë e punimit të diplomës së studentit.</p> <p>Evid. 4. Rregullore FTI Evid. 5. Rregullore e programit të studimit (Bachelor në TI)</p>
<p><b>Kriteri 3. Komisioni i</b> posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Në rregulloret e institucionit, GVJ konstaton se Teza e Provimit të përgjithshëm përfundimtar është e përbërë nga grupe të ndryshme pyetjesh të përgatitura nga lëndët teknike që studentët kanë ndjekur gjatë studimeve. Përqindja e secilit grup pyetjesh përcaktohet në bazë të ngarkesës së lëndës (krediteve) në kurrikul dhe raportit të tyre me lëndët e tjera.</p> <p>Komisioni i provimit përgatit tezen për provimin e përgjithshëm përfundimtarë bazuar në pyetjet e paraqitura nga secili pedagog i përfshirë në proces, sipas përqindjes së përcaktuar.</p> <p>Evid. 4. Rregullore FTI Evid. 5. Rregullore e programit të studimit (Bachelor në TI)</p>
<p><b>Kriteri 4. Personeli</b> akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston</p>	<p>Bazuar në dosjen e vetëvlerësimit personeli akademik i departamentit dëshmon se udhëzon dhe ndihmon studentët në përgatitjen e tezës së diplomës. Në këtë proces angazhohet jo vetëm udhëheqësi i punimit të temës së diplomës por edhe pedagogë të tjerë, specialistë të fushave përkatëse për të kontribuar më mirë në përgatitjen e një punimi cilësor, në të përfshihet edhe stafi ndihmës akademik.</p>

<p>studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Pedagog udhëheqës i punimit të diplomës së studentit ka rol kyç në vlerësimin cilësor të punimit. Studenti fiton të drejtën e mbrojtjes së punimit përpara komisionit, mbasi është marrë miratimi i udhëheqësit i cili ka roj këshillues/udhëzues për studentin në realizimin e punimit të diplomës.</p> <p>Evid. 4. Rregullore FTI Evid. 5. Rregullore e programit të studimit (Bachelor në TI)</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Bazuar në rregulloren e programit të studimit si dhe në udhëzuesin e punimit të diplomës, për këtë program studimi, punimi i diplomës jo domosdoshmërisht duhet të ketë punim praktik, në rastet kur tema përfshin një fushë të tillë departamenti mbështet realizimin e punimit praktik të temës së diplomës. Mbështetja përfshinë edhe vënien në dispozicion të studentit ambientet laboratorike nëse është e nevojshme.</p> <p>Institucioni vendos në dispozicion të studentëve në tërësi, edhe fondin e bibliotekës fizike, dhe bazuar edhe në programet e ndryshme të studimit që ofrohen, kanë vlerësuar mbajtjen e bibliotekës hapur edhe në fundjavë për ta bërë atë të aksesueshme maksimalisht për studentët.</p> <p>Evid. 33. Urdhër për funksionimin e bibliotekës në fundjavë</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Punimi i diplomës apo provimi përfundimtar, në planin mësimor është i caktuar me 6 kredite ECTS, dhe vlerësohet me notë, njësoj si çdo lëndë tjetër e këtij programi studimi.</p> <p>Evid. 4. Rregullore FTI Evid. 5. Rregullore e programit të studimit (Bachelor në TI)</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e DVV, institucioni ka të miratuar modelin e diplomës me numër unik DR3226200959 nga QSHA (Qendra e Shërbimeve Arsimore).</p> <p>Së bashku me diplomën, studenti pajiset edhe me suplementin e saj. Si procedurë standarde, institucioni harton diplomat për studentët e diplomuar, dy herë në vit, në sezonin e dimrit dhe në atë të vjeshtës. Në sekretarinë mësimore dhe në atë të njësisë kryesore, ruhet i gjithë dokumentacioni për çdo vit akademik, dhe studenti, edhe mbasi është diplomuar, mund të kërkojë dhe të marrë, kopje të dokumentacioneve që kanë qenë në fuqi në periudhën kur ka qenë student pranë këtij institucioni.</p>



	Evid. 14. Modeli i Diplomës TI, Urdhër i aprovimit dhe suplementi i diplomës			
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Bazuar në RVB dhe vizitën në institucion konstojmë së të gjitha dokumentet e studentëve gjatë studimeve të tyre arkivohen sipas akteve ligjore në fuqi. Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore, vihet re një organizimi i arkivës dhe i materialeve për çdo student lehtësisht të aksesueshme nga personeli i sekretarisë në çdo moment. Kjo procedurë lehtëson punën e sekretarisë mësimore për hartimin e vërtetimeve të ndryshme që mund të kërkohen nga studentët apo ish student në çdo kohë.  Evid. 2. Statuti UAMD Evid. 3. Rregullore UAMD			
<b>Konkluzione</b>	<i>UAMD ka të përcaktuar qartë procedurat e mbylljes së studimeve, mbrojtjen e diplomës apo të provimit të formimit.</i>  <i>UAMD pajis studentët me diplomën sipas standardit të miratuar nga ministria përgjegjëse për arsimin, së bashku me suplementin e saj.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

<b>Standardi IV.1</b>	
<b>Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit	GVJ konstaton se personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit Bachelor në Teknologji Informacioni plotëson kërkesat ligjore në fuqi. Për të mbuluar lëndët mësimore të programit Bachelor

të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.

në Teknologji Informacioni është angazhuar staf akademik me përgatitje specifike në atë fushë.

Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit gjatë vitit akademik 2022-2023 ka patur 44 anëtarë të personelit akademik me kohë të plotë me kualifikimet:

- 5 Profesor i Asociuar;
- 18 Doktorë shkencash;
- 21 MSc. (nga të cilët, 17 Dr. në proces).

Stafi akademik i Departamentit të Teknologjisë së Informacionit përbëhet nga 14 anëtarë personel akademik efektiv, me kualifikimet:

- 1 Prof. Asoc;
- 6 Dr.;
- 7 MSc (nga të cilët 6 Dr. në proces).

Programi i studimit Bachelor në Teknologji Informacioni është i mbuluar në masën 65% nga staf akademik me të paktën gradën shkencore Doktor.

Në tre vitet e fundit akademike kemi këtë paraqitje të angazhimit të stafit akademik në këtë program studimi sipas kualifikimeve.

Grada/tituj	2022-2023		2021-2022		2021-2020	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Asoc.	2	-	1	1	1	1
Dr./PhD	19	1	18	-	18	-
MSc (Dr. në proces)	8	-	9	-	9	-
MSc	2	1	2	1	2	1
<b>Total</b>	<b>31</b>	<b>2</b>	<b>30</b>	<b>2</b>	<b>30</b>	<b>2</b>

[Evid. 16. CV e stafit Akademik

Evid. 24. Te dhena tabelore per personelin në FTI

Evid. 4. Rregullore FTI, Neni 82

Evid. 15. Syllabuset e Lendeve,

Evid. 25. Personeli akademik i angazhuar në DTI]

**Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e**

Nga analiza e ngarkesës mësimore rezulton se rreth 94% e ngarkesës mësimore mbulohet nga Personeli Akademik Efektiv(PAE) në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës. Për lëndët karakterizuese të këtij programi studimi, angazhohet



<p>studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>staf akademik me përvojë dhe me kualifikimet e duhura, pjesë e njësive bazë të Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit, ku në vecanti Departamenti i Teknologjisë së Informacionit, përgjegjës për programin e studimit, mbulon 50% të ngarkesës mësimore të programit të studimit Bachelor në Teknologji Informacioni.</p> <p>Ngarkesa e personelit akademik, është përcaktuar në respekt të lirisë akademike dhe në përputhje me ekspertizën përkatëse të stafit akademik. Departamenti i Teknologjisë së Informacionit planifikon çdo vit ngarkesën mësimore për të gjithë anëtarët e personelit akademik, mbështetur në normat e ngarkesës mësimore të përcaktuara në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet cilësore të UAMD. Ngarkesa mësimore e personelit akademik është me përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p> <p>ANEKS Tabela permbledhese FTI Teknologji Informacioni]</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) zhvilloi takim me përfaqësues të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore. Gjatë këtij takimi, GVJ konstatoi se institucioni disponon dokumentacion të plotë për çdo anëtar të personelit akademik efektiv dhe me kontratë, si dhe personelit ndihmës akademik dhe administrativ të angazhuar në këtë program studimi.</p> <p>Cdo anëtar i personelit akademik me kohë të plotë në DTI / FTI ka një kontratë pune me afat të pacaktuar kur është i kategorisë lektor dhe profesor dhe me afat të caktuar për kategorinë asistent lektor sipas përcaktimeve ligjore në fuqi dhe statutit të IAL. Për rinovimin e kontratave me kohë të caktuar, nevojitet rekomandimi i përgjegjës të njësisë bazë (DTI) dhe dekanit të fakultetit (FTI) për performancën e personelit akademik. UAMD mbulon të gjitha detyrimeve financiare si sigurimet shoqërore dhe shëndetësore. Evid. 2. Statuti UAMD]</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe</p>	<p>Rekrutimi i personelit akademik në FTI - UAMD realizohet në përputhje me bazën ligjore në fuqi, me rregulloren dhe statutin e institucionit.</p> <p>Bazuar në Rregullore për Funksionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë, IAL garanton cilësinë e personelit akademik dhe zbaton procedura të ndershme dhe transparente për rekrutimin dhe zhvillimin e personelit akademik. Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Juridike është përgjegjëse për dokumentacionin për konkurset për marrjen dhe pranimin e punonjësve në punë, plotësimin e tyre me librezat e punës si dhe për plotësimin e dosjes personale</p>

<p>përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>me dokumentacionin e nevojshëm për çdo punonjës të institucionit. Punësimi i personelit akademik dhe ndihmës-akademik kryhet me konkurim, përmes thirrjeve të hapura. Shpallja e thirrjeve bëhet nga Drejtoria e Burimeve Njerezore dhe Juridike e UAMD, në APP dhe online përmes [<a href="https://uamd.edu.al/mundes-punesimi/">https://uamd.edu.al/mundes-punesimi/</a>] sipas kriterëve të përcaktuara nga Njësia Bazë.</p> <p>Per vlerësimin e dosjeve të kandidatëve Njësia Kryesore ngrre një komision ad-hoc i cili vlerëson kandidatët në dy faza: përmes vlerësimit të dosjes dhe përmes intervistës. Për pikëzimin e kandidatëve sipas kriterëve të përgjithshme dhe specifike, UAMD përdor formularë aplikimi të unifikuar në nivel institucional ndërsa vlerësimi i kandidateve bëhet sipas <i>Çelësit të vlerësimit të paketës së aplikimit</i>. Institucioni ka paraqitur evidencë në lidhje me procedurën e rekrutimit dhe vlerësimit të stafit akademik. Procedura që ndjek UAMD është transparente dhe garanton përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit.</p> <p>Evid. 2. Statuti UAMD Evid. 3. Rregullore UAMD, Evid. 6. Rregullore për Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë Evid. 11. Rregullore Drejtoria e Burimeve Njerezore dhe Juridike DBNJJ, Skeda e pikezimit të rekrutimit të stafit PAE PAK Drejtoria e Burimeve Njerezore dhe Juridike.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në dosjen e vetëvlerësimit dhe vizitën në institucion, GVJ konstaton se zhvillimi i seancave laboratorike mbështetet nga stafi ndihmës akademik (laborant). FTI-UAMD ka angazhuar një (laborant) përgjegjes për cdo laborator i cili kontribuon në mirëmbajtjen e laboratorëve dhe ndihmon stafin akademik gjatë zhvillimit të orëve laboratorike. FTI-UAMD ka aktualisht të punësuar 5 staf ndihmës akademik. Bazuar në CV e tyre, GVJ gjykon që ata kanë kualifikimin e përshtatshëm për mbështetjen e realizimit të orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve.</p> <p>Evid. 17. CV e stafit ndihmes akademik</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ zhvilloi takim me përfaqësuesen e Drejtorisë së Burimeve Njerezore dhe Juridike. Gjatë këtij takimi dhe në bazë të dokumentacionit që u vu në dispozicion, GVJ konstaton se institucioni disponon dokumentacion të plotë për çdo anëtar të personelit akademik</p>

<p>programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>efektiv dhe me kontratë, si dhe personelit ndihmës mësimor dhe administrativ të angazhuar në këtë program studimi, që përfshin: diplomat, çertifikat e ndryshme, vërtetimet për gradat akademike, CV-të, kontratat e punës, librezë shëndetsore, dëshmia e anglishtes, kërkesa e punësimit etj.</p> <p>Të dhënat e stafit efektiv dhe me atij me kontratë administrohen nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore në nivel institucional dhe nga njësia kryesore dhe njësitet bazë për program studimi. Informacioni administrohet duke respektuar konfidencialitetin e të dhënave personale dhe arkivohen konform akteve rregullatore institucionale.</p> <p>Në përfundim të vitit akademik, nga Njesia Bazë administrohen edhe evidencat e detajuara për plotësimin e orëve mësimore. Konfidencialiteti i të dhënave personale sanksionohet edhe në nenin 7 të Kodit të Etikës së UAMD. GVJ përmes dokumentacionit të paraqitur nga UAMD dhe takimeve të zhvilluara konstaton korrektësi në zbatimin e procedurës së administrimit të të dhënave të personelit akademik dhe ndihmës-akademik të angazhuar në këtë program studimi.</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Model kontrate full time pa afat</li> <li>2. Model kontrate full time me afat</li> <li>3. Model kontrate personel akademik P-T</li> </ol> <p>Skeda e pikezimit te rekrutimit te stafit PAE PAK Drejtoria e Burimeve Njerezore dhe Juridike</p> <p>Evid. 11. Rregullore Drejtoria e Burimeve Njerezore dhe Juridike DBNJJ - Neni 7 Detyrat kryesore</p> <p>Evid. 19. Analizë e Departamentit të Teknologjisë së Informacionit.</p> <p>Evid. 40. Kodi i Etikës UAMD</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari</p>	<p>Bashkëpunimet e UAMD me industrinë, biznesin, dhe institucione të tjera të arsimit të lartë mbështeten në marrëveshje të institucionalizuara.</p> <p>FTI mbështetet në këto marrëveshje bashkëpunimi për të përmbushur objektivat e lëndëve praktike të planit mësimor. Gjatë vizitës në UAMD, GVJ konstatoi investime në laboratorë të arritura falë bashkëpunimeve me biznesin dhe/ose pjesëmarrjes në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare. Kjo infrastrukturë vihet në dispozicion të studentëve për realizimin e temës së diplomës dhe/ose veprimtari të tjera specifike sipas programeve të lëndëve. Këto marrëveshje përdoren edhe për realizim të praktikave individuale të studentëve, por ato janë jashtë planit mësimor, dhe bazohen vetëm në kërkesa individuale të studentëve, pasi kujtojmë se plani mësimor nuk</p>

<p>të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>parashikon lëndën e “Praktikës Profesionale”. Megjithatë IAL ofron trajnime/workshope profesionale që mbështeten nga bizneset partnere.</p> <p>Evid. 26. Liste MoU, Evid. 27. Memorandum UAMD - Crystal System Evid. 28. Trajnime FTI - Crystal System</p>			
<p><b>Kriter 8.</b> Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p><i>Zyrtarisht ky program studimi nuk ka të parashikuar lëndën e “Praktikës Profesionale”, dhe si i tillë nuk është detyrim për studentët.</i></p> <p>Megjithatë, bazuar në iniciativa individuale të studentëve, ata realizojnë praktika apo punësime në kompani të lidhura me fushën e IT edhe gjatë kohës që janë student. Në disa raste praktika profesionale realizohet si aktivitet suplementar i mbështetur në marrëveshjet e bashkëpunimit që UAMD ka me biznesin.</p> <p>Evid. 18. Plani mesimor TI.</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Programi Bachelor në Teknologji Informacioni mbulohet nga staf akademik me përgatitje specifike në atë fushë, 65% e të cilit ka të paktën gradën shkencore Doktor.</i></p> <p><i>IAL dëshmon qëndrueshmëri të personelit akademik efektiv i cili mbulon 94% të ngarkesës mësimore në programin e studimit.</i></p> <p><i>Procedura që ndjek UAMD për rekrutimin e stafit akademik dhe ndihmës akademik është transparente dhe garanton përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit për pozicionin e punës.</i></p> <p><i>GVJ vlerëson pozitivisht investimet në laboratorë të arritura falë bashkëpunimeve me biznesin dhe/ose pjesëmarrjes në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

**Standardi IV.2**

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Procesi mësimor në programin e studimit Bachelor në “Teknologji Informacioni” zhvillohet në Godinën Qëndrore, Curila, Durrës me sipërfaqe 6000 m<sup>2</sup> (salla mësimore, bibliotekë, etj.), të cilën Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit e ndan me Fakultetin e Studimeve Profesionale. Mjediset e brendshme të godinës sigurojnë salla mësimi, laboratorë, bibliotekë, zyra dhe mjedise për studentët. Aktiviteti mësimor për programin e studimit Bachelor “Teknologji Informacioni”, zhvillohet në 6 laboratore dhe 7 salla leksioni dhe lëndësh teorike me kapacitet 420 vende. GVJ gjatë vizitës në institucion vizitoi ambientet ku zhvillon mësimin programi Bachelor “Teknologji Informacioni” dhe konstaton që godina e FTI është funksionale për zhvillimin e aktivitetit mësimor dhe kërkimor shkencor.</p> <p>ANEKS Tabela permbledhese FTI Teknologji Informacioni</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi që ambientet ku zhvillon mësim FTI janë të pajisura me mjete elektronike që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies e mësimnxënies. Konkretisht, FTI zotëron 3 laboratorë programimi, 2 laboratorë të multimedias, 1 laborator kërkimor shkencor dhe një VTech Hub të pajisura me mjetet didaktike të nevojshme për zhvillimin sa më modern të procesit mësimor. Çdo laborator është i pajisur me 20-30 poste pune të pajisura me PC me lidhje interneti. Instalimi, mirëmbajtja dhe azhurnimi i pajisjeve kompjuterike bëhet një laborant i dedikuar për mirëmbajtjen teknike të secilit laborator. Sallat e leksioneve dhe lëndëve teorike janë të pajisura me sistem kondicionimi, LED screen 65” ose projektore HD. Evid. 29. Laborator FTI</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të</p>	<p>FTI vë në dispozicion të programit të studimit Bachelor “Teknologji Informacioni” 6 laboratorë. Laboratorët mbështesin lëndët përkatëse të cilat mbulohen nga stafi akademik i departamenteve në FTI. Secili laborator është i pajisur me 20-30 PC me parametra të përshtatshëm për të instaluar programet e nevojshme që aftësojnë studentët në fushën e programimit. Për plotësimin e objektivave formues të lëndëve të orientuara nga hardware: “Rrjeta Kompjuterike 1 dhe 2” dhe “Siguri Informacioni dhe Rrjeti”, shërben një laborator i dedikuar me 4 routera CISCO, 2 prej të cilëve me opsionin 4G LTE mobile internet, 1 switch CISCO 24 portësh me kapacitet 100Mbps për portë; lëndët “Cloud Computing” dhe “Konfigurim dhe Administrim Serverash” mbështeten nga 3</p>

programit të studimit në tërësi.	servera, njeri prej të cilëve DellEMC të cilët përdoren për virtualizim.			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Në bazë të specifikës së programeve të studimit që ofron FTI-UAMD, të 6 laboratorët që vihen në shërbim të studentëve janë të pajisur me pajisje profesionale të teknologjisë së informacionit dhe mbështesin studentët në aftësimin e tyre praktik.			
<b>Konkluzione</b>	<i>UAMD vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturë të përshtatshme për realizimin e procesit mësimor të programit të studimit dhe për formimin praktik.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi IV.3

**IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	<p>Literatura e bazë e kurseve ofrohet në gjuhën e programit të studimit (shqip). Në rastin kur nuk ka një botim me ISBN në gjuhën shqipe për lëndën atëherë si litaraturë bazë shërben një cikël leksionesh i përkthyer nga titullari dhe lektorët e lëndës dhe i miratuar në department. Literatura bazë është e evidentuar qartë në syllabusin e lëndës dhe i vihet në dispozicion studentëve në format elektronik nga pedagogu i lëndës dhe/ose në format fizik në bibliotekën e UAMD. Literatura ndihmëse është kryesisht në gjuhë të huaj (anglisht). Kjo literaturë është e përshtatshme për të dhënë njohuritë e kërkuara suplementare për këtë program studimi.</p> <p><i>GVJ konstaton që shpesh literatura e rekomanduar nuk është e viteve të fundit dhe <u>sugjeron</u> që t'i kushtohet më shumë kujdes përzgjedhjes së literaturës ndihmëse me autorët më të spikatur të fushave përkatëse dhe kjo literaturë të përfshihet edhe në fondin e bibliotekës.</i></p> <p>Evid. 15. Syllabuset e Lendeve</p>

<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Përditësimi i literaturës bazë dhe ndihmëse për lëndët bëhet çdo fillim simestri sipas përcaktimeve në nenin 45 të rregullores së fakultetit për përditësimin e syllabuseve të lëndëve. Njësia përgjegjëse, ruan përditësimet e literatures që përfshihen në kopjet e syllabuseve për çdo semestër.</p> <p>Evid. 4. Rregullore FTI – Neni 45</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Në mjediset e UAMD (Godina nr.1, Currila) ndodhet Biblioteka, e cila arkivon dhe mirëmban pasurinë akademike, kulturore e shkencore të Institucionit. Ajo është në shërbim të plotë të studentëve, pedagogëve, e studiuesve.</p> <p>Biblioteka ka në fondin e saj rreth 12000 tituj në gjuhën shqipe dhe të huaj, në formatin letër dhe elektronik. Gjithashtu, ofron mundësi kërkimi të informacionit on-line, në sallën e leximit, mundësi shfletimi të literaturës elektronike, pranë kompjuterave të sallës, si edhe lehtësi në kërkimin bibliografik të informacionit.</p> <p>Evid. 34 - Rregullorja e Bibliotekës, Neni 6, Evid. 33. Urdhër për funksionimin e bibliotekës në fundjavë, Raporti për shtimin e fondit të bibliotekës Drejtoria e Administrimit dhe Sherbimeve Akademike</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka universitare ofron literaturë, tekste mësimore dhe plotësuese që mbështesin kurrikulat mësimore. Numri i kopjeve për çdo titull varion nga 2-5 kopje mesatarisht, ndërsa kopjet e librit të huaj variojnë nga 1- 2 kopje. Krahas librit fizik, ekziston edhe libri elektronik, (mbi 10000 tituj). Biblioteka universitare është hibride dhe me fonde të hapura. Aktualisht në UAMD janë funksionale 3 biblioteka. Koleksioni i tyre përfshin burime që pjeserisht plotësojnë nevojat e përdoruesve të saj si nga përmbajtja ashtu dhe nga forma. GVJ konstaton që vitet e fundit biblioteka nuk është pasuruar me fond shtesë të literaturës fizike, por vetëm me fond elektronik (JSTOR, EBSCO, COBISS). Kjo është edhe në përputhje edhe me përdorimin aktual fizik të bibliotekës, përdorim i cili, mbas periudhës së pandemisë, është zvogëluar ndjeshëm, duke preferuar literaturën elektronike kundrejt asaj fizike. Kjo ndjehet veçanërisht për studentët e këtij programi studimi, të cilët përdorin kryesisht literaturën elektronike.</p> <p>Raporti për shtimin e fondit të bibliotekës Drejtoria e Administrimit dhe Sherbimeve Akademike</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në</p>	<p>Studentët dhe stafi i UAMD kanë akses në një sistem menaxhimi të bibliotekës së UAMD. GVJ vlerëson pozitivisht krijimin e një databaze elektronike nga biblioteka e UAMD-së që ndihmon komunitetin e UAMD-së të gjejë libra online, të</p>

<p>bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>shkarkojë falas artikuj shkencorë, libra elektronike, disertacione, etj. Në shërbim të Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit janë edhe biblioteka online U-library dhe JSTOR, ndërsa nëpërmjet një projekti të qeverisë Sllovene, biblioteka e UAMD është pjesë e një biblioteke virtuale COBISS+.</p> <p>ANEKS Tabela përmbledhëse FTI Teknologji Informacioni</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Ambjentet e bibliotekës ofrojnë PC, që kanë të instaluar programe të përshtatshme sipas profilit të studimit duke ju mundësuar studentëve leximin, studimin dhe realizimin e detyrave të kursit.</p> <p>Evid. 34 - Rregullorja e Bibliotekës, Neni 6, pika 6.4</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Biblioteka e UAMD funksionon në orarin 8.00-16.00 nga e hëna në të dielë. Orari i punës në bibliotekë shpallet në mjediset e institucionit dhe në faqen ueb të universitetit.</p> <p>Në përgjigje të nevojave të programeve të studimit, infrastruktura e bibliotekës vendoset në dispozicion të studenteve edhe jashtë orarit zyrtar të punës si dhe në fundjavë.</p> <p>Evid. 34 - Rregullorja e Bibliotekës, Neni 6, pika 6.4 Evid. 33. Urdhër për funksionimin e bibliotekës në fundjavë</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë</p>	<p>Biblioteka në bashkëpunim me fakultetet dorëzon pranë drejtorisë së menaxhimit financiar kërkesat për blerje libri, materiale, pajisje, rafte, skanera, kompjutera, etj.</p> <p>Çdo vit akademik parashikohen fonde për blerjen e literaturës shkencore.</p> <p>Megjithatë, bazuar në RVB dhe vizitën në institucion, GVJ konstaton që pasurimi i bibliotekës nuk është periodik, por varet nga mundësitë buxhetore të UAMD dhe kryhet nëpërmjet: blerjeve, dhurimeve, shkëmbimit të materialeve mes bibliotekave, artikujve shkencorë, tezave dhe dizertacioneve.</p> <p><i>GVJ sugjeron forcimin e rolit të bibliotekës së UAMD dhe pasurimin e saj me më shumë libra fizike të viteve të fundit.</i></p> <p>Evid. 34 - Rregullorja e Bibliotekës Raporti për shtimin e fondit të bibliotekës Drejtoria e Administrimit dhe Sherbimeve Akademike</p>



kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.									
<b>Konkluzione</b>	<p><i>IAL disponon një bibliotekë fizike e cila në rast nevoje funksionon edhe gjatë fundjavës dhe disa biblioteka online.</i></p> <p><i>GVJ konstaton që pasurimi i bibliotekës fizike nuk është periodik dhe vitet e fundit nuk ka patur fond librash shtesë, prandaj sugjeron që duke marrë parasysh dinamikat e tregut në fushën e Teknologjisë së Informacionit, IAL t'i kushtojë vëmendje të vecantë alokimit të zërit të buxhetit që shkon për pasurimin e fondit të bibliotekës.</i></p>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

#### Standardi IV.4

**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Bazuar ne RVB, GVJ konstatoi që Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit në UAMD ka në përdorim programin informatik të menaxhimit të të dhënave Pitagora të zhvilluar dhe administruar nga RASH i cili aksesohet online në <a href="https://uamd.pitagora.rash.al/login">https://uamd.pitagora.rash.al/login</a>.</p> <p>Sistemi Pitagora është në ndihmë të institucionit për administrimin e të gjithë informacionit që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim.</p> <p>Pasi kandidati fiton statusin e studentit, regjistrohet në sekretarinë mësimore të fakultetit duke paraqitur dokumentacionin e nevojshëm si edhe duke respektuar afatet e përcaktuara nga MASR dhe më pas pajiset me një ID me anë të të cilës identifikohet dhe logohet në sistemin Pitagora. Funkcionalitetet kryesore të sistemit të menaxhimit për studentet janë: vlerësimet e vazhduara, mungesat, provimet, diplomimi, transferimet ndërmjet universiteteve, mbartja e krediteve të fituara, etj.</p> <p>Evid. 3 - Rregullore UAMD, Neni 89 <a href="https://rash.al/sq/software/universitare/pitagora/">https://rash.al/sq/software/universitare/pitagora/</a></p>

<p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit Pitagora përdoret nga studentët, pedagogët, financa dhe sekretaria respektivisht sipas roleve që ato kanë në institucion.</p> <p>Çdo përdorues/rol në sistemin Pitagora ka akses të dedikuar për të dhënat që kanë lidhje me aktivitetin e tij në FTI/UAMD:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Studentët kanë akses në kurrikulat e tyre, vlerësimin për kurset e frekuentuara dhe provimet, regjistrimin dhe të dhënat e orarit mësimor etj.</li> <li>- Personeli akademik ka akses te regjistrat e seksioneve që mbulon, procesverbalet e vlerësimit të studentëve, orarin mësimor etj.</li> <li>- Sekretaria mësimore ka akses të dedikuar për orarin mësimor, listat e studentëve të regjistruar në orar, të dhënat e studentëve dhe vlerësimet e tyre, të dhënat për personelin akademik të angazhuar në mësimdhënie etj.</li> <li>- Dega ekonomike ka akses në të dhënat e studentëve përsa i përket tarifave të studimit dhe pagesave të kryera</li> </ul> <p><a href="https://rash.al/sq/software/universitare/pitagora/">https://rash.al/sq/software/universitare/pitagora/</a></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit funksionon në bazë të roleve dhe të drejtave të përdoruesve të cilët pasi logohen me anë të emailit dhe fjalëkalimit kanë akses në të dhënat e tyre sipas rolit që kanë në institucion. Në këtë mënyrë administrohen të dhënat e studentëve dhe i ofrohet atyre një hapësirë vetjake/private për të aksesuar notat, ndërtuar orarin, regjistruar modulet, riprovimet etj. Në këtë mënyrë garantohet privatësia e të dhënave personale dhe liria akademike sipas legjislacionit në fuqi. Të dhënat dhe informacionet janë të kufizuara vetëm brenda aktivitetit që përdoruesit zhvillojnë në UAMD duke ruajtur konfidencialitetin e çdo studenti ose anëtari të personelit të FTI. Të dhënat janë të ruajtura dhe mund të aksesohen për të gjitha vitet që përdoruesi është pjesë e FTI.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p> <p>Studentët aksesojnë avancimin e tyre akademik dhe vlerësimet përkatëse të cilat përditësohen nga stafi akademik dhe aksesohen nga studentët nëpërmjet sistemit.</p> <p>GVJ vlerëson pozitivisht edhe format e tjera të komunikimit interaktiv (rrjete sociale dhe email) që institucioni përdor për t'iu përgjigjuar studentëve dhe për të arritur një komunikim sa</p>

	<p>më të shpejtë me ta. Kjo edhe në kuadër të mënyrave të komunikimit të përdorur nga gjeneratat e reja që janë kontigjent i studentëve në këtë program studimi.</p> <p>Gjithsesi, u vu re, si në hartimin e syllabuseve, komunikimeve mes stafit por edhe me studentët, stafi akademik dhe ai administrativ, përdor adresa të postës elektronike jo zyrtare të institucionit. Kryesisht përdoren adresa në ofruesh shërbimi si google, yahoo, Hotmail etj. Në takimin me stafin akademik dhe studentët, që u pyetën rreth kësaj mënyre komunikimi, mos përdorimi i postës elektronike në domain të institucionit vjen si pasojë e problematikave teknike që janë hasur në vite me këtë shërbim, dhe stafi, për të mos humbur komunikime të rëndësishme, ka përdorur shërbimet publike individuale nga ofrues të tjerë të postave elektronike.</p> <p><i>GVJ sugjeron që institucioni të vendosë në efikasitet postën elektronike zyrtare dhe të rregullojë përdorimin e saj në komunikimet institucionale.</i></p> <p>Evid. të komunikimit online (facebook etj.) të studentëve me institucionin FTI, Raporti për shtimin e fondit të bibliotekës Drejtoria e Administrimit dhe Shërbimeve Akademike</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime sipas roleve të përdoruesve në institucion. Në mënyrë automatike dhe të parametrizuar sistemi i menaxhimit gjeneron raportime në lidhje me kalueshmërinë, notën mesatare, përdorimin e ambienteve didaktike, etj.</p> <p><a href="https://rash.al/sq/software/universitare/pitagora/">https://rash.al/sq/software/universitare/pitagora/</a></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Në faqen zyrtare të UAMD [<a href="https://uamd.edu.al">https://uamd.edu.al</a>] meret informacion në tre gjuhë, shqip, anglisht dhe italisht. Në faqe gjenden informacione të detajuara në lidhje me programet e studimit, personelin akademik dhe aktivitetet e UAMD. Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit ka një sesion të dedikuar në faqen e UAMD nga i cili mund të arrihet në departamentet e këtij fakultetit, programet e studimit që ofron secili departament dhe kurikulat e tyre, personelin akademik, aktivitete akademike dhe shkencore, etj. Përtej faqes web <a href="http://uamd.edu.al">uamd.edu.al</a>, UAMD përdor edhe rrjete sociale si Facebook, Instagram dhe LinkedIn ku publikon njoftime dhe foto të aktiviteteve, mundësi praktikash mësimore, bashkëpunime, mobilitete, etj.</p>

	FTI ka faqen e saj në Facebook ku publikohen informacione dhe aktivitete specifike për programin e studimit.  <a href="https://uamd.edu.al/departamenti-i-teknologjise-se-informacionit/">https://uamd.edu.al/departamenti-i-teknologjise-se-informacionit/</a> <a href="https://www.facebook.com/FTIUAMD">https://www.facebook.com/FTIUAMD</a>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.</i></p> <p><i>Personeli i këtij institucioni nuk përdor me efikasitet adresat e postës elektronike zyrtare në domain të institucionit, por përdor adresa personale të stafit në ofrues shërbimi si google, yahoo, Hotmail etj.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### Standardi IV.5

**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	<p>GVJ vëren që UAMD ka raporte financiare që hartohen në nivel institucional. Në raport janë paraqitur të dhëna të 3 viteve të fundit ku detajohen të ardhurat nga pushteti vendor/qendror, nga fondet publike, shërbimet trajnuese dhe nga aktivitetet tregtare dhe shpenzimet. Duke iu referuar statutit të institucionit, UAMD financohet nga: buxheti i shtetit, pagesat e studentëve, të ardhurat për shërbimet e kryera, të ardhurat nga marrëdhëniet me pale të treta, donacione dhe burime të tjera financimi, veprimtari kërkimore-shkencore, projekte kombëtare ose ndërkombëtare.</p> <p>Evid. 2. Statuti UAMD <a href="https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/03/JANAR-2023-TE-DHENAT-FINANCIARE-TE-ARDHURA-DHE-SHPENZIME-1.pdf">https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/03/JANAR-2023-TE-DHENAT-FINANCIARE-TE-ARDHURA-DHE-SHPENZIME-1.pdf</a> ANEKS Tabela permbledhese FTI Teknologji Informacioni</p>
<b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit	Mbështetja e UAMD për programin Bachelor në <i>“Teknologji Informacioni”</i> është kryesisht për pagat e personelit akademik dhe ndihmës-akademik dhe administrativ.

<p>duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>Bazuar në RVB, mbështetjet alternative financiare të FTI arrihen nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– Bizneseve partnere: investimet në pajisjet laboratorike, pagesat e trajnuesve të huaj (dieta, udhëtim, qëndrim), bursa për studentët si dhe shpenzimet për bibliotekën.</li> <li>– Tarifat e studentëve: programi Bachelor në “Teknologji Informacioni” është programi me numrin më të lartë të studentëve të regjistruar për çdo vit akademik për Departamentin e Teknologjisë së Informacionit.</li> <li>– Projekte kombëtare dhe ndërkombëtare: mbështetje financiare për periudhat e shkëmbimeve të studentëve/stafit dhe trajnimeve në universitete partnere në Europë, pagesat e konsulentëve të huaj dhe sponsorizime në aktivitete të ndryshme të organizuara në funksion të studentëve të FTI.</li> </ul> <p>Bazuar në statut, UAMD harton një plan buxhetor afatmesëm i cili është pjesë e planit strategjik të zhvillimit të institucionit i cili përditësohet çdo vit. Në përfundim të çdo viti akademik, njësitë kryesore të UAMD dërgojnë planin strategjik ku parashikohen shpenzimet e nevojshme dhe të ardhurat. Koordinimi i propozimeve të njësisve kryesore realizohet fillimisht nga Senati Akademik i cili vlerëson mundësitë financiare të UAMD për të realizuar këto kërkesa dhe harton planin strategjik financiar që i paraqitet për miratim bordit të administrimit.</p> <p><i>Në dispozicion të GVJ nuk është vendosur një raport financiar për programin e studimit Bachelor në Teknologji Informacioni.</i></p> <p>Evid. 2. Statuti UAMD – Kreu X</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Në përfundim të çdo viti akademik, njësitë kryesore të UAMD dërgojnë planin strategjik ku parashikohen shpenzimet e nevojshme dhe të ardhurat. Koordinimi i propozimeve të njësisve kryesore realizohet fillimisht nga Senati Akademik i cili vlerëson mundësitë financiare të UAMD për të realizuar këto kërkesa dhe harton planin strategjik financiar që i paraqitet për miratim bordit të administrimit.</p> <p>Buxheti i programit të studimit bachelor në Teknologji Informacioni i ofruar nga një institucion publik i arsimit të lartë i nënshtrohet auditeve të brendshme apo nga KLSH sipas legjisllacionit në fuqi.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse</p>	<p>UAMD ndjek politika për programin e transparencës me qëllim rritjen e transparencës në UAMD. Në faqen web të UAMD ka një sesion të dedikuar për transparencën, por për sa i përket plan-</p>

për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.

buxhetit, realizimit të buxhetit dhe pasqyrave financiare informacioni në lidhje me buxhetin mungon ose është i papërditësuar. Institucioni nuk ka paraqitur evidencë të raportimit të realizimit të buxhetit të UAMD deri në nivel departamenti.

Edhe pse institucioni ka një qëndrueshmëri financiare, vlerësojmë se transparenca e hartimit të buxhetit dhe realizimit të tij, nuk realizohet e plotë për të gjithë stafin akademik.

Gjatë vizitës në institucion, dhe në veçanti në takimin me stafin akademik, u vi re se kishte personel akademik të cilët nuk ishin të informuar rreth mundësive të mbështetjes financiare institucionale për avancimin e tyre akademik, si mbështetje për pjesëmarrje në konferenca apo për botime në revista.

Edhe pse nga organet drejtuese u bë e ditur, se ky informacion është i plotë dhe transparent duke ju vënë në dispozicion të gjithë stafit akademik, gjucojmë se institucioni duhet të përdori forma më të drejtëpërdrejta dhe transparente për informimni e stafit rreth mundësive financiare të mbështetjes së tyre. Si dhe të parashikojë kritere për aksesin në këto fonde në mënyrë transparente për të gjithë stafin e kësaj njësie kryesore.

*Sugjerohet që institucioni të realizojë komunikim periodik mbi parashikimet e miratuara të buxhetit afat shkurtër, kriteret dhe përzgjedhjen e shpërndarjes së fondeve të dedikuara për kërkimin shkencor. Ky komunikim të realizohet me mjete transparente jo vetëm në mbledhje të njësisë bazë por edhe me komunikime me postë elektronike (mailing list) të të gjithë stafit.*

<https://uamd.edu.al/transparenca/>

**Kriteri 5.** Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.

Drejtoria e Administrimi Financiar ndjek zbatimin e të gjitha procedurave financiare të lidhura me planifikimin dhe realizimin e buxhetit në UAMD-së.

Te ardhurat e UAMD-se kanë pësuar rritje të vazhdueshme gjatë viteve të fundit. Në tabelën e mëposhtme paraqitet sasia totale e burimeve të financimit të buxhetit të UAMD në 3 vitet e fundit.

	2020	2021	2022
Të ardhura dhe financime të ndryshme në 3 vitet e fundit ne Lekë	1,082,354,067	1,076,144,918	1,133,710,586

	<p>Në të ardhurat që vetë UAMD gjeneron, rreth 20% burojnë nga tarifa e shkollimit, ndërkohë që vlen të theksohet që programi bachelor në “Teknologji Informacioni” është programi me numrin më të lartë të studentëve në FTI. Dokumentacioni dhe takimet e kryera garantojnë stabilitetin financiar të këtij programi studimi ndonëse në raportet financiare nuk jepet qartë pesha financiare e këtij programi studimi.</p> <p>Evid. 39. Të dhëna për studentët</p> <p>Evid. 44. Struktura Organizative e UAMD</p> <p>ANEKS Tabela permbledhese FTI Teknologji Informacioni</p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>UAMD si institucion publik i arsimit të lartë garanton financim dhe mbështetje financiare nga buxheti i shtetit dhe mbështetje alternative nga burime të tjera. Të ardhurat financiare në tërësi kanë pësuar rritje gjatë viteve të fundit.</i></p> <p><i>Programi bachelor në “Teknologji Informacioni” është programi me numrin më të lartë të studentëve në FTI, fakt ky që tregon qëndrueshmëri të të ardhurave që burojnë nga tarifa e shkollimit.</i></p> <p><i>GJV sugjeron më tepër vëmendje në përfshirjen e të gjithë aktorëve të IAL deri në nivel departamenti në procedurën e parashikimit dhe realizimit të buxhetit si dhe kriterëve për akses në fondet e brendshme të kërkimit shkencor, përfshirë edhe mbështjen për pjesëmarrje në konferenca apo për botime shkencore.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

### Standardi V.1

**Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Nga dokumentacioni që i është vënë në dispozicion GVJ, konstatohet se institucioni ka të përcaktuara procedurat që duhet të ndiqen për pranimin e studentëve në programin Bachelor në Teknologji Informacioni. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve të programit të studimit. Në aktet rregullatore: Statuti i UAMD-së, Rregullorja e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit dhe Rregullorja e programit Bachelor në Teknologji Informacioni përshkruhet procesi i regjistrimit të studentëve, i zhvillimit të procesit mësimor, i transferimit të studimeve, njohjes dhe njehsimit të diplomave, procedura e ankimimit dhe diplomimit të tyre.</p> <p>GVJ gjen hartimin e dokumenteve bazë institucionale në përputhje me Ligjin 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, dhe zbatimit të udhëzimeve e MASR nr.10 datë 15.05.2019, nr.17 datë 30.07.2019.</p> <p>Evid 3. Rregullore UAMD</p> <p>Evid 4. Rregullore FTI</p> <p>Evid 5. Rregullore e programit të studimit (Bachelor në TI)</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton zbatimin e procedurave që garantojnë barazinë në çdo student. Procedura dhe kriteret specifike bëhen publike sipas akteve rregullatore të hartuara nga ministria përgjegjëse për arsimin dhe të miratuara në njësinë bazë, atë kryesore dhe në Senatin Akademik të UAMD.</p> <p>Procedura e përfitimi të bursave në UAMD është e barabartë për të gjithë studentët bazuar në meritën e përfitimit sipas politikave shtetërore për bursat studentore për shtresat në nevojë si dhe për studentët me rezultate të larta akademike. Dokumentet institucionale përcaktojnë qartë të drejtat dhe detyrimet për stafin mësimor dhe studentët duke mos cënuar lirinë përkatëse të tyre.</p> <p>Evid. 2. Statuti UAMD,</p> <p>Evid. 35. Vendim Senati për Kriteret e Pranimi të Studenteve,</p> <p>Evid. 36. Vendim Senati për Kuotat</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u</p>	<p>Departamenti i Teknologjisë së Informacionit propozon për çdo vit akademik kriteret e pranimi të studentëve në programin mësimor, miratimi i të cilës bëhet nga Fakulteti dhe Senati Akademik dhe vijon me MASR.</p>



<p>pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>Kriteret pranuese, kërkesat e veçanta dhe afatet e regjistrimeve publikohen në faqen zyrtare të UAMD, dhe në rrjetet sociale të FTI si edhe në portalin U-Albania.</p> <p>Për çdo vit akademik, për kuotat e programit Bachelor në Teknologji Informacioni parashikohen kuota të veçanta për studentë të huaj, nga trojet, me statusin e jetimit, me aftësi të kufizuara dhe nga komunitetet Romë dhe Egjiptiane. GVJ konstaton se procedurat e hartimit dhe miratimit të kriterëve specifike për pranimin e studentëve në këtë program studimi është e mirëpërcaktuar në aktet rregullatore institucionale të UAMD.</p> <p>Evid. 35. Vendim Senati për Kriteret e Pranimi të Studenteve <a href="https://uamd.edu.al/kriteret-e-pranimi/">https://uamd.edu.al/kriteret-e-pranimi/</a></p> <p>Evid. 36. Vendim Senati për Kuotat</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Kriteret, procedurat e pranimi dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Gjatë takimit me studentët dhe stafin akademik, GVJ konstatoi se FTI ju vë në dispozicion informacion të plotë në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. Ky informacion është qartësisht i shprehur në rregulloret e institucionit. Për sa i përket kriterëve dhe procedurave të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, ato janë të shprehura në rregulloren e IAL dhe rregulloren e njësisë kryesore.</p> <p>Koordinatori i programit bachelor në Teknologji Informacioni dhe drejtuesi i departamentit të Teknologjisë së Informacionit në FTI, organizojnë takime periodike me studentët e programit të studimit për të ndjekur ecurinë e tyre dhe për t'i informuar për kriteret dhe procedurat për përparimin e tyre akademik në UAMD.</p> <p>Kriteret, procedurat e pranimi dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë të qarta dhe të mirëpërcaktuara në rregulloret e institucionit, edhe pse disa prej të dhënave të tyre janë kontradiktore (rregullore e programit të studimit me syllabuset dhe rregulloren e fakultetit dhe atë institucionale sikurse është cituar në standardin II më sipër). Gjithashtu, këto rregullore edhe pse janë në dispozicion të të gjithë të interesuarve brenda institucionit, përfshirë sekretarinë mësimore, dekanatin dhe njësinë bazë, ato nuk janë publike dhe të aksesueshme në faqen zyrtare online të UAMD.</p> <p><i>GVJ sugjeron bërjen publike të rregulloreve institucionale në faqen zyrtare të IAL në mënyrë që të jenë më lehtë të</i></p>

	<p><i>aksesueshme nga të gjithë të interesuarit, dhe jo vetëm studentët e këtij institucioni.</i></p> <p>Evid. 3. Rregullore UAMD – Neni 56, Evid. 4. Rregullore FTI – Neni 38 dhe Neni 39 Evid. 30. Urdhër Koordinatorët dhe NJSBC</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Studentët njihen me procedurat e vlerësimit të dijeve që në javën e parë të mësimit (ditë informuese për studentët e vitit të parë) si dhe informohen nga personeli akademik gjatë orës së parë të çdo lënde. Kandidatët për studentë dhe gjithë të interesuarit kanë disa mundësi alternative dhe komplementare për të marrë informacion rreth programeve të studimit të ofruara dhe mundësive që ofrohen në UAMD. FTI në mënyrë periodike organizon ditë orientuese për maturantët. Këto takime organizohen si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Ditë të hapura informimi ku maturantët mund të vizitojnë ambjentet universitare të FTI,</li> <li>- Takime informuese në gjimnaze për maturantët</li> <li>- Takime informuese të organizuara në rang rajonal dhe kombëtar nga ana e MAS ose Drejtorive Arsimore Rajonale</li> <li>- Takime informuese online me grupe maturanësh në rang gjimnazesh.</li> </ul> <p>GVJ vlerëson impenjim maksimal të Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit dhe stafit akademik të Departamentit të Teknologjisë së Informacionit në informimin e publikut dhe të të interesuarve në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>Për cdo vit akademik, në kuotat e programit Bachelor në Teknologji Informacioni parashikohen edhe kuota të veçanta për aplikantë nga trojet, ata me statusin e jetimit, me aftësi të kufizuara dhe nga komunitetet Rome dhe Egjiptiane. Kriteret përzgjedhëse janë të njëjta si për kandidatët e tjerë por kuotat janë të dedikuara dhe aplikimet bëhen sipas udhëzimeve të ministrisë përgjegjëse për arsimin e lartë. Kriteret pranuese, kërkesat e veçanta dhe afatet e regjistrimeve publikohen në faqen zyrtare të UAMD, në rrjetet sociale të FTI si edhe në portalin U-Albania.</p> <p>Evid. 36. Vendim Senati për Kuotat <a href="https://uamd.edu.al/kriteret-e-pranimit/">https://uamd.edu.al/kriteret-e-pranimit/</a></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik</p>	<p>Për cdo vit akademik, në kuotat e programit Bachelor në Teknologji Informacioni parashikohen edhe kuota të veçanta për aplikantë të huaj. Kriteret përzgjedhëse janë të njëjta si për</p>

kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	<p>kandidatët e tjerë por kuotat janë të dedikuara dhe aplikimet bëhen sipas udhëzimeve të ministrisë përgjegjëse për arsimin e lartë. Kriteret pranuese, kërkesat e veçanta dhe afatet e regjistrimeve publikohen në faqen zyrtare të UAMD, në rrjetet sociale të FTI si edhe në portalin U-Albania.</p> <p>Evid. 36. Vendim Senati për Kuotat  <a href="https://uamd.edu.al/kriteret-e-pranimit/">https://uamd.edu.al/kriteret-e-pranimit/</a></p>			
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	<p>UAMD aplikon politikat shtetërore për bursat studentore për shtresat në nevojë dhe për studentët me rezultate të larta akademike.</p> <p>Sipas të dhënave në RVB, në programet e studimit që ofron FTI janë aktualisht 82 studentë që përfotojnë nga politikat e bursave.</p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>UAMD harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregulloret e brendshme institucionale.</i></p> <p><i>Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit, me të gjitha strukturat e tij, impenjohet maksimalisht në informimin e publikut dhe të të interesuarve në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</i></p> <p><i>GVJ sugjeron ngarkimin e rregulloreve institucionale në faqen zyrtare të IAL në mënyrë që ato të jenë lehtësisht të aksesueshme nga studentët dhe të gjithë aktorët e interesuar.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi V.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të	Gjatë takimit me studentët dhe stafin akademik, GVJ konstatoi se FTI vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit

<p>hollësishtëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. Përgjegjesi i departamentit dhe çdo staf akademik i angazhura në këtë program i informon studentët për kriteret e përparimit akademik për lëndët që ai mbulon. Informacioni i plotë në lidhje me përparimin akademik të studentëve gjendet edhe në rregulloret e institucionit.</p> <p>Evid. 3. Rregullore UAMD, Evid. 4. Rregullore FTI, Evid. 5. Rregullore e programit të studimit (Bachelor në TI)</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesëshme.</p>	<p>UAMD ofron mundësi për njohjen e krediteve dhe transferimin e studimeve për të gjithë ata që gëzojnë statusin e studentit, midis programeve të të njëjtit cikël studimi, brenda tij, apo institucioneve të ndryshme të arsimit të lartë. Transferimet lejohen në të njëjtin cikël studimi e në fusha studimi të njëjta ose të përafërta dhe vetëm në fillim të vitit akademik. Studentët informohen në lidhje me procesin mësimor edhe përmes sekretarisë mësimore duke u njoftuar për lëndët, regjistrimin përkatës, grupet dhe rezultatet e provimeve.</p> <p>GVJ gjeti pasqyrimin e akteve rregullatore për transferimet, njohjen e krediteve dhe ekuivalentimi të lëndëve në kreun III, Neni 56 të rregullores së UAMD-së dhe në rregulloren e FTI-së, Kreu III, Neni 38 dhe 39.</p> <p>Evid. 3. Rregullore UAMD, Evid. 4. Rregullore FTI</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës së kryer, GVJ konstatoi që studentët ishin të mirë informuar në lidhje me mënyrën e vlerësimit të dijeve. Në fillim të çdo lënde apo moduli pedagogu përkatës i prezanton studentëve planin mësimor të lëndës së tij.</p> <p>Gjatë javës së orientimit (në fillim të vitit akademik) studentët informohen me komunikim të drejtpërdrejt në auditor nga drejtuesit e departamenteve dhe koordinoret e programeve të studimit të cilët sqarojnë paqartësitë që studentët mund të kenë dhe mbajnë kontakte të vazhdueshme përgjatë vitit akademik me studentët. Vlerësimi i dijeve është i unifikuar në nivel IAL dhe sanksionohet në rregulloren e UAMD dhe rregulloren e FTI sipas kategorive të mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- provimi i parë i ndërmjetëm, i cili zhvillohet në javën e shtatë dhe/ose të tetë të semestrit, përmban 400 pikë ose 40% të vlerësimit përfundimtar;</li> <li>- provimi përfundimtar, i cili zhvillohet në javën e pesëmbëdhjetë dhe/ose të gjashtëmbëdhjetë të</li> </ul>

	<p>semestrit, përmban 500 pikë ose 50% të vlerësimit përfundimtar;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- detyrat, projektet, esetë, të cilat zhvillohen gjatë gjithë semestrit, përmbajnë 100 pikë ose 10% e vlerësimit përfundimtar;</li> </ul> <p>Evid. 3. Rregullore UAMD, Evid. 4. Rregullore FTI, Evid. 15. Syllabuset e Lendeve</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>GVJ në takimin me studentët konstatoi se ata ishin të informuar mbi procedurat e punimit të temës së diplomës dhe /ose provimit të diplomimit.</p> <p>Pyetjet e provimit të diplomimit hartohen nga lektorët e FTI të cilët janë të angazhuar në mësimdhënie në lëndet e formimit profesional. Data baza e pyetjeve publikohet për studentët në fillim të semestrit të dytë. Studentët të cilët plotësojnë kriteret për të zhvilluar tezë diplome mund të zgjedhin një temë nga lista e temave të miratuara nga departamenti. Procedura e diplomimit është e shprehur qartë në rregulloren e UAMD dhe rregulloren e FTI. Drejtuesi i departamentit, stafi akademik, koordinatorët e programeve të studimit, faqia ueb e FTI dhe rrjetet sociale janë disa nga burimet e informacionit për studentët.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>GVJ nga takimi me studentët evidentoi se ata kishin pasur disa mundësi alternative për të marrë informacion rreth programeve të studimit të ofruara dhe mundësive që ofrohen në UAMD, si psh: ditë të hapura informimi në ambientet e FTI, guida e studentit, web site, rrjete sociale, broshura, takime informuese në gjimnaze, takime rajonale të organizuara nga MAS dhe DAR dhe takime informuese online.</p> <p>Evid. 38. Materiale Promovuese</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>FTI sipas rregulloreve të tij dhe rregulloreve institucionale disponon informacion të plotë në lidhje me përparimin akademik të studentëve.</i></p> <p><i>Drejtuesit e departamenteve dhe koordinatorët e programeve të studimit kryejnë takime informuese me studentët gjatë javës së orientimit dhe më pas mbajnë kontakte dhe kryejnë takime periodike me studentet përgjatë vitit akademik.</i></p> <p><i>FTI përdor metoda alternative dhe efikase të komunikimit me studentët, përfshirë edhe rrjetet sociale.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

### Standardi V.3

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	GVJ konstatoi se studentët janë të informuar në lidhje me strukturën e programit të studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen dhe të gjitha aspektet e aktiviteteve akademike të lidhura me avancimin e tyre akademik. Informacionin fillestar në lidhje me procesin mësimor (kohëzgjatjen dhe strukturën e tij) studentet e marrin përmes sekretarisë mësimore në momentin e regjistrimit në programin e studimit. Në vijim, ata marrin informacion në ditët informuese, nga stafi akademik dhe nga përgjegjësit e departamenteve me të cilët mbajnë kontakte përgjatë gjithë avancimit të tyre akademik.  Gjithashtu, informacione më të detajuara paraqiten në faqen ueb institucionale ku paraqitet struktura e vitit akademik përfshirë periudhat e leksioneve, provimeve, pushimeve dhe detyrimeve të tjera.  <a href="http://www.uamd.edu.al">www.uamd.edu.al</a>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Detajet në lidhje me përmbajtjen e lëndës, temat, shpërndarjen e tyre gjatë semestrit, mënyrë e vlerësimit, detyrimet akademike dhe administrative, jepen në orën e parë të mësimit nga pedagogu i lëndës në të cilën prezantohet edhe plani i lëndës. Studenti ka qasje të personalizuar në hapësirën e tij private të menaxhimit të ciklit akademik [Sistemi Pitagora] që nga regjistrimi në kurse, syllabusin e lëndëve, vlerësimet në secilin kurs deri në diplomim. Gjithashtu, studentin mundësi të informohet në lidhje me kurikulën e programit të studimit nëpërmjet faqes zyrtare të universitetit ose rrjeteve sociale të fakultetit.  <a href="https://uamd.edu.al/teknologji-informacioni/">https://uamd.edu.al/teknologji-informacioni/</a> Evid. 15. Syllabuset e Lendeve
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen	Zyra e Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës e cila funksionon në nivel institucional ofron në mënyrë të vazhdueshme për studentët: informacion dhe trajnim mbi situatën në tregun e punës, përgatitjen e CV-së profesionale, letrës së motivimit,

<p>institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>etj, mundësi për zhvillimin e kompetencave, dhe lidhjen me bizneset. Për të prezantuar studentet me mundësitë e ofruara për praktika profesionale dhe punësim, Universiteti “Aleksandër Moisiu” organizon çdo vit Panairin e Punës dhe Karrierës. Në panairin e fundit që organizoi UAMD, studentët patën mundësi të njihen me rreth 200 biznese nga Durrësi dhe Tirana që morën pjesë në panair.</p> <p>Të dhëna të përditësuara dhe njoftime punësimi për studentët gjenden në faqen zyrtare të UAMD, në sektorin e Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës dhe në llogarinë në facebook dhe instagram Karriera UAMD. Funksionimi i Sektorit të Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës është i rregulluar në nivel institucional nëpërmjet rregullores së kësaj njësie.</p> <p>Evid. 7. Rregullore e Sektorit të Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës</p> <p>Evid. 20. Raporti vjetor për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Përdomi i sistemit Pitagora u mundëson studentëve të UAMD-së informacion të përditësuar për të gjithë mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe ambienteve në të cilat zhvillohet mësimi. Shërbimet në funksion të realizimit të programit mësimor dhe kontaktet me administratën, sekretarinë, dhe stafin akademik përgjegjës për programin e studimit gjenden të përditësuara në faqen zyrtare të UAMD.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>UAMD përdor sistemin e brendshëm të menaxhimit Pitagora që ofrohet nga RASH. Në sistemin Pitagora mund të aksesohen të dhëna në lidhje me strukturën e vitit akademik, orarin mësimor, planin mësimor, syllabuset e lëndëve të cilat është lehtësisht i aksesueshëm online. UAMD ka përgatitur dhe publikuar në faqen zyrtare një manual për studentët për akses në sistemin Pitagora.</p> <p>GVJ konstaton se informacioni në lidhje me programin e studimit është i arritshëm lehtësisht nga studentët në distancë nëpërmjet lidhjes në internet.</p> <p><a href="https://uamd.edu.al/pitagora/">https://uamd.edu.al/pitagora/</a></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Faqja zyrtare e UAMD, sistemi i menaxhimit që përdor IAL dhe stafia akademik ofrojnë për studentët informacion të plotë e të hollësishëm në lidhje me objektivat formuese, strukturën,</i></p>



	<i>organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### Standardi V.4

**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	<p>UAMD mban të dhëna statistike vjetore për numrin e studentëve dhe të të diplomuarve. Të gjitha këto të dhëna disponohen nga sekretaria mësimore e FTI-së e cila i hedh në regjistrin e diplomimeve sipas kuadrit ligjor në fuqi dhe i përcjell ato tek drejtuesit e departamenteve dhe në zyrën e ALUMNI. Parelisht, këto të dhëna mund të aksesohen në bazë rolesh dhe të drejtash të përdoruesve edhe brenda sistemit Pitagora. Sektorit i Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës, si pjesë e Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike mbledh dhe përpunon të dhëna në lidhje me studentët e diplomuar në mënyrë periodike nga të gjitha njësitë kryesore të UAMD-së.</p> <p>Evid. 7. Rregullore e Sektorit të Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës, Evid. 8. Rregullore e Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike, Evid. 39. Të dhëna për studentët, Evid. 44. Struktura Organizative e UAMD</p>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në	<p>Mbështetur në ligjin Nr. 80/2015 për arsimin e lartë, të dhënat e studentëve mbahen, administrohen, monitorohen dhe kontrollohen në sekretarinë mësimore. GVJ ndërmoi një vizitë në sekretarinë mësimore e cila administron të dhënat e studentëve që nga faza e regjistrimit deri në përfundim të studimeve. Të dhënat mbahen në formë të shkruar dhe elektronike në tre regjistra: Regjistri themeltar i studentëve; Regjistri i arritjeve akademike; Regjistri i lëshimit të diplomave dhe certifikatave.</p> <p>Të dhënat për regjistrimin e studentëve në këtë program studimi për 3 vitet e fundit akademike paraqiten si vijon:</p>



<p>të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Viti akademik 2020-2021 20 studentë;  Viti akademik 2021-2022 75 studentë;  Viti akademik 2022-2023 72 studentë;</p> <p>Nga takimi me kryesekretaren e FTI-së, GVJ konstaton se regjistrimi i studentëve në procedurën e aplikimit dhe të pranimit është në përputhje me nenin 86 në Rregulloren e UAMD dhe në përputhje me aktet ligjore të përcaktuara nga MASR. Të dhënat e plotësuar për çdo student të regjistruar janë në renditje kohore me datën e regjistrimit të studentëve. Këto të dhëna mbahen edhe në regjistrin elektronik Pitagora. Regjistri themeltar i studentëve është i plotësuar në përputhje me shtojcën Nr.2 të udhëzimit Nr.31 datë 16.09.2014 të MASR “Për pajisjen e Institucioneve të Arsimit të Lartë Publik dhe Privat me Regjistrat Bazë të Studentëve”. GVJ verifikoi edhe regjistrin e arritjeve akademike. Verifikimi u bë me të dhënat e dy studenteve të përzgjedhur në mënyrë rastësore në një procesverbal provimi me notat përkatëse të studentëve të zgjedhur të hedhur në regjistrin e arritjeve akademike. Verifikimet gjejnë një përputhje të notave dhe plotësimi i tij është në përputhje me kuadrin ligjor. Sekretaria mësimore është përgjegjëse edhe për administrimin e të dhënave të studentëve që diplomohen. Të dhënat plotësohen në regjistrin e diplomave dhe terheqja e saj me suplementin e diplomës bëhet nga vetë studenti ose përmes një autorizimi të noterizuar.</p> <p>Evid. 3. Rregullore UAMD</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Të dhënat e studentëve mbahen në Regjistrat bazë që ruhen në mënyrë të përhershme në përputhje me ligjin “Për Arkivat” dhe janë objekt kontrolli dhe në sistemin e menaxhimit të universitetit Pitagora që ofrohet nga RASH dhe garanton ruajtjen e konfidencialitetit dhe vërtetësinë e të dhënave. Disa nga funksionalitetet për studentët që mundëson sistemi Pitagora janë: regjistrimi në silabuset e kurseve, vlerësimet, procesverbalet e provimeve, diplomimi, transferimet ndërmjet universiteteve dhe mbartja e krediteve të fituara, etj.</p> <p>Sistemi Pitagora ka thjeshtuar mjaft punën si për personelin akademik ashtu dhe për sekretarinë, pasi të dhënat plotësohen elektronikisht nga pedagogu dhe aksesohen në kohë reale nga studentet në hapësirën e tyre personale brenda sistemit. Procesverbalet e detyrimeve dhe të provimeve të plotësuara elektronikisht në sistem, të printuara dhe firmosura nga pedagogu përgjegjës ruhen edhe në hard copy duke ofruar siguri të lartë. Ky sistem, lejon përpunimin e thjeshtuar dhe në kohë më të shkurtër të të dhënave. Aksesi i të dhënave</p>

	<p>statistikore brenda sistemit Pitagora realizohet konform të drejtave dhe roleve të përdoruesve sipas rregullores së UAMD dhe FTI dhe sipas organigramës së IAL-së duke ruajtur konfidencialitetin e të dhënave në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.</p> <p>Evid. 3. Rregullore UAMD, Evid. 4. Rregullore FTI, Evid. 44. Struktura Organizative e UAMD</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritet mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>Kontrolli periodik i përvitshëm për dokumentimin e saktësisë së informacionit që lidhet me studentët dhe veprimtaritë e tyre përkatëse është një procedurë e sanksionuar në rregulloren e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit, Neni 54.</p> <p>Në fund të çdo viti akademik, një komision ad hoc i ngritur nga departamentet kontrollojnë provimet dhe procesverbale të përkatëse për atë vit akademik. Komisionet verifikojnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>a) ndjekjen e saktë të anës teknike të hartimit të tezave të provimeve;</li> <li>b) përputhjen e numrit të tezave me numrin e studentëve që kanë marrë pjesë në provim dhe që janë pasqyruar në procesverbal;</li> <li>c) përputhjen e pikëve në teza me ato të pasqyruara në procesverbal;</li> <li>ç) saktësinë e datave dhe zbatimin e afateve kohore të përcaktuara në këtë rregullore për dorëzimin e dokumentacioneve;</li> <li>d) korrigjimin dhe pasqyrimin e qartë të vlerësimit në teza etj.</li> </ul> <p>Në raste të identifikimit të parregullsive, përgjegjësi i departamentit i propozon dekanit masat e nevojshme për rregullimin e këtyre parregullsive sipas rastit. Evid. 4. Rregullore FTI</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim</p>	<p>Programi i Studimit Bachelor në Teknologji Informacioni është ndër programet bachelor me numrin më të lartë të kërkesave dhe regjistrimeve në rang fakulteti dhe ka cilësi të lartë të në hyrje të studentëve bazuar në notën mesatare të shkollës së mesme. Sipas Analizës së të dhënave mbi punësimin e studentëve nga zyra e Alumnit dhe Karrierës, përqindja e të punësuarve për studentët që kanë përfunduar studimet Bachelor në Teknologji Informacioni është 70.25% ndër të cilët 38.6% punojnë në profesionin për të cilin kanë përfunduar studimet.</p>

të përmirësimit të këtyre treguesve.	FTI, gjithashtu, për të përmirësuar objektivat e programit të studimit, ndjek rekomandimet e raportit të realizuar nga nga zyra e Alumnit dhe Karrierës për analizimin e të dhënave mbi punësimin e studentëve dhe studimin e kurrikulës dhe syllabuseve.  Evid. 10. Misioni dhe studimi i tregut të punës për programin e studimit			
<b>Konkluzione</b>	<i>Spektori i Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës, pjesë e Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike është struktura përgjegjëse në UAMD që mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimit deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### Standardi V.5

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Bazuar në nenin 115, të Rregullores së UAMD-se studentët kanë të drejtë të përfaqësohen dhe të marrin pjesë në vendimarrje në të gjitha organet drejtuese të UAMD-së. Studentët kanë përfaqësuesit e tyre në Senatit Akademik të UAMD, në komisionet zgjedhore në nivel institucional dhe njësi kryesore si dhe në komisione të përhershme si NJBSC, Këshillin e Etikës etj.  Evid. 3. Rregullore UAMD
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të	Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në menaxhim dhe në vendimarrje. Studentët kanë përfaqësimin e tyre në organet kolegjiale vendimmarrëse si: Senatit akademik të UAMD, Këshilli i etikës në UAMD, Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë në nivel institucioni, Komisioni Institucional Zgjedhor – UAMD, Komisioni i zgjedhjeve në FTI. Studentët gjithashtu janë pjesë e vlerësimit të personelit



<p>jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>akademik. Çdo vit studentëve iu shpërndahen pyetësorë nga Drejtoria e Kurrikulave dhe Standardeve të Cilësisë, lidhur me performancën e personelit akademik. Pyetësorët plotësohen në mungesë të personelit akademik dhe ruajnë anonimatën e studentit. Rezultatet e anketimit nga studentët pasqyrohen në Raportin e Performancës së Personelit Akademik.</p> <p>Evid. 3. Rregullore UAMD, Evid. 4. Rregullore FTI Evid. 20. Raporti vjetor për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Gjatë takimit me stafin akademik të FTI, GVJ konstatoi se ndryshimi i kurrikulës së programeve të studimit në FTI realizohet në mënyrë periodike çdo 5-6 vite. Opinioni i studentëve vlerësohet në mënyrë të vazhdueshme gjatë vitit akademik nga stafi akademik, titullarët e lëndëve, koordinatorët e programeve të studimit, përgjegjësit e departamenteve dhe reflektohet në përshtatjen e mësimdhënies, orareve mësimore, shpërndarjes së provimeve etj. Ndyshimet afatshkurtër në programin e studimit reflektohen nga titullari i lëndës në syllabuset e lëndëve.</p> <p>Drejtoria e Kurrikulave dhe Standardeve, në bazë të Rregullores për Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë, realizon periodikisht anketime të studentëve, stafit akademik dhe administrates.</p> <p>Në këto anketim studentët shprehin opinionin e tyre në lidhje me cilësinë e mësimdhënies për personelin akademik dhe lëndët e frekuentuara në cdo semestër mësimor. Bazuar në historikun e vlerësimeve të personelit akademik, përgjegjësit e njësive bazë analizojnë rezultatet e ankimimit dhe diskutojnë në departament problematikat e identifikuar për përmirësimin e tyre në të ardhmen.</p> <p>Evid. 6. Rregullore për Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë, Evid. 42. Pyetësor Student UAMD, Evid. 43. Analiza e pyetësorëve (Student, Staf Akademik, Staf administrativ)</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë</p>	<p>Rregullorja e UAMD dhe Rregullorja e FTI garantojnë të drejtën e studentit për të dhënë mendim në lidhje me procesin mësimor, stafin akademik dhe infrastrukturën. Pyetësorët semestralë mundësojnë studentin të shprehë mendimin e tij në lidhje me cilësinë e procesit mësimor. Gjetjet nga përpunimi statistikor i pyetësorëve shërbejnë si bazë për përmirësimin e programit dhe për ndërmarrjen e plan veprimit nga ana e DII.</p>

<p>mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Bazuar në takimin që GVJ pati me studentët, konstatohet që FTI garanton transparencë në procesin e vlerësimit dhe kontrollit të dijeve.</p> <p>Stafi akademik i jep studentëve rezultatin e provimit brenda 72 orësh nga realizimi i testimit dhe sqaron studentët në lidhje me vlerësimit. Pas ballafaqimit me komisionin e provimit të lëndës studenti ka të drejtë të ankohet për shkelje të rregullave të zhvillimit të provimit dhe vlerësimit. Ankesa i drejtohet me shkrim Dekanit të FTI brenda 3 ditëve nga dita e publikimit të rezultateve. Nëse ankesa gjykohet e arsyeshme, Dekani ngre një komision ad-hoc për rishikimin e tezës.</p> <p>Bazuar ne Rregulloren për Funkzionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë, pedagogët mund të përfshijnë në formatin e testit edhe pyetje me alternativa të cilat korrigjohen në formë të automatizuar, me skanera optikë dhe programe kompjuterike të posacme, por GVJ në dokumentacionin e shqyrtuar nuk gjen evidencë të përdorimit nga pedagogët të vlerësimit të njohurive dhe dijeve përmes teknologjisë dhe sugjeron IAL të nxisë pëdorimin e sistemeve te tilla per rritjen e transparencës.</p> <p>Evidencë 4. Rregullore FTI, neni 56 Evid. 6. Rregullore për Funkzionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë – Neni 7</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Studentët me përfaqësuesit e tyre angazhohen në organet vendimmarrëse e këshilluese si: Senatin Akademik të UAMD, në komisionet zgjedhore në nivel institucional dhe njësie kryesore si dhe në komisione të përhershme si NJBSC, Këshillin e Etikë.</i></p> <p><i>Opinionit i studentëve vlerësohet në mënyrë të vazhdueshme gjatë vitit akademik nga stafi akademik, titullarët e lëndëve, koordinatorët e programeve të studimit, përgjegjësit e departamenteve dhe reflektohet në përshtatjen e mësimdhënies, orareve mësimore, shpërndarjes së provimeve etj.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p><b>X</b></p>

**Standardi V.6**  
**Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat**



**ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>UAMD ka në përbërje të tij Sektorin e Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës, i cili është në shërbim të informimit të studentëve. Ky sektor është përgjegjës për shërbimin e informacionit dhe komunikimit të vazhdueshëm me studentët dhe me palë të treta.</p> <p>Sektori i Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës në UAMD i informon vazhdimisht studentët e FTI, me anë të postës elektronike, me informacione për avancimin e tyre akademik dhe karrierën pas universitare.</p> <p>Informimi i studentëve sigurohet përmes përdorimit të formave si më poshtë vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Takimet informuese me maturantët;</li><li>- Panairi i punës</li><li>- Faqja ueb e UAMD dhe FTI dhe rrejtet sociale Facebook dhe Instagram;</li><li>- Organet drejtuese dhe Staf i akademik i cili në fillim të çdo lënde paraqet përmbajtjen e tij, format e mësimdhënies, detyrimet e studentëve dhe leksionet;</li><li>- Sekretaria mësimore e cila informon studentët për tarifatat e regjistrimit, progresin e tyre, rezultatet e provimeve deri në procesin e diplomimit duke ofruar asistencë dhe informim të vazhdueshëm;</li><li>- Platforma Pitagora;</li><li>- Broshura, Guida e Studentit 22-23, fletëpalosje janë një formë që kanë rritur edhe informimin e publikut dhe studentëve në lidhje me programet mësimore;</li><li>- Komunikim në rrjetet sociale me profil zyrtar të UAMD dhe të FTI-së</li></ul> <p>Evid. 38. Materiale Promovuese, Dok. Shtesë - Evidenca të komunikimit online (facebook etj.) të studentëve me institucionin FTI, <a href="http://www.uamd.edu.al">www.uamd.edu.al</a></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për</p>	<p>UAMD ofron asistencë, këshillim dhe ndjek progresin e studentëve përmes strukturave të ngritura të saj. Të gjitha funksionojnë bazuar në organigramën e UAMD.</p> <p>Ndër strukturat kryesore bazë mbështetëse për studentët janë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Sektori i Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës në UAMD,</li></ul>

çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.

- Sekretaria mësimore,
- Zyra e finances,
- Faqet ueb [[www.uamd.edu.al](http://www.uamd.edu.al)] dhe rrjetet sociale
- Ambientet e dedikuara për njoftime në fakultet
- Koordinatorët e programeve të studimit

Përgjegjësi i departmentit dhe pedagogët Sektori i Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës drejton procesin e këshillimit të karrierës, ofron asistencë në orientimin dhe zhvillimin e karrierave profesionale të studentëve, mban kontakte me të diplomuarit dhe krijon Rrjetin Alumni, krijon mundësi bashkëpunimi me kompani për mundësi praktikash dhe punësimi për studentët/alumnit, organizon aktivitete për studentët, trajnime, seminare, workshop-e, harton dhe raporton periodikisht në MAS të dhëna statistikore, zhvillon komunikimin efektiv dhe etik me studentët, alumnit, stafin dhe të tjerë.

Vlen të përmendet që UAMD mbështet edhe klubet studentore që kanë si qëllim forcimin e kapaciteteve dhe promovimin e përfshirjes dhe angazhimit të studentëve në jetën universitare. UAMD organizon aktivitete që ndihmojnë studentët të menaxhojnë më mirë jetën studentore dhe të ndërveprojnë me njëri-tjetrin për të arritur qëllime të përbashkëta. Nga takimi me studentet GVJ konstaton në klube si:

- Klubi për Shoqëri të Ndjeshme (me tri ndëNDARJET e tij #EarthTeam, #SocialTeam dhe #CultureTeam),
- Klubi i Librit,
- Klubi i Multimedias dhe Fotografisë,
- Klubi i Debatit,
- Klubi i Juristëve të Rinj,
- Klubi artit
- Klubi Diplomantik
- Klubi i Shahut
- Klubi Volejbollit
- Klubi Basketbollit
- Klubi FUTBOLLIT
- Klubi Teknologji dhe Informacion
- StartUp UAMD

Evid. 20. Raporti vjetor për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë

Evid. 44. Struktura Organizative e UAMD,

Evid. 8. Rregullore e Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike,

	Evid. 7. Rregullore e Sektorit të Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës.
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Sektori i Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës realizon këshillim dhe udhëzime në lidhje me orientimin dhe zhvillimin e karrierës profesionale të studentëve në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës; Organizon dhe koordinon aktivitetet për studentët të tilla si: trajnime, seminare, konferenca studentore, orë leksioni të hapura nga lektorë të ftuar, promovim të aftësive të studentëve si në letërsi, pikturë etj.</p> <p>Drejtoria e Administrimit dhe Shërbimeve Akademike në Universitetin “Aleksandër Moisiu” dhe RISI Albania kanë hartuar “Udhëzuesin e Karrierës” i cili përmban këshilla dhe motivimin që kërkohet për të vlerësuar situatën dhe mundësitë profesionale, si dhe ofron një sërë sugjerimesh lidhur me procesin e aplikimit për punë. Informacioni dhe ushtrimet në të ju vlejnë studentëve edhe për t’u përgatitur për këshillimin e personalizuar nga punonjësit e Zyrës së Karrierës në universitet. UAMD mbështet zhvillimin e aftësive praktike të studentëve, me fokus në zhvillimin efikas të praktikave profesionale jashtë-kurrikulare. Bashkëpunimet me industrinë, biznesin, kompanitë dhe institucionet mbështeten në marrëveshje të institucionalizuara.</p> <p>Evid. 7. Rregullore e Sektorit të Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës,  Evid. 26. Liste MoU,  Evid. 27. Memorandum UAMD - Crystal System,  Evid. 28. Trajnime FTI - Crstal System,  Evid. 32. Workshops  <a href="https://www.uamd.edu.al/wp-content/uploads/2022/07/UAMD-Udhezues-nga-Qendra-e-Karrieres-dhe-Alumni-21-Maj-2020.pdf">https://www.uamd.edu.al/wp-content/uploads/2022/07/UAMD-Udhezues-nga-Qendra-e-Karrieres-dhe-Alumni-21-Maj-2020.pdf</a></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Specialistët për këshillimin e karrierës dhe ALUMNI mbajnë kontakte të vazhdueshme me studentë edhe mbas diplomimit si informacion i nevojshme për vlerësimin periodik të programeve të studimit të ofruara në UAMD. Drejtoria e Kurikulave dhe Standarteve, në bazë të Rregullores për Funksionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë, realizon periodikisht anketime të studentëve. Sipas Analizës së të dhënave mbi punësimin e studentëve nga zyra e Alumnit dhe Karrierës, përqindja e të punësuarve për studentët që kanë përfunduar studimet Bachelor në Teknologji Informacioni është 70.25% ndër të</p>





	<p>cilët 38.6% punojnë në profesionin për të cilin kanë përfunduar studimet.</p> <p>Vlen të theksohet që, GVJ vlerëson pozitivisht iniciativën e krijimit të Shoqatës Alumni, me objektiv mbështetjen e studentëve në drejtim të njoftimeve për punësim, shkëmbim përvojash, trajnime, seminare, workshope etj. UAMD realizon transmetim të përmuajshëm të rubrikës “Alumni talks” në rrjetet sociale të UAMD. Kjo e fundit konsiston në intervistimin e Alumni të suksesshëm të UAMD dhe synon që të sjellë përvojën dhe këshillat e Alumnive për karrierën.</p> <p>Evid. 10. Misioni dhe studimi i tregut të punës për programin e studimit,</p> <p>Evid. 20. Raporti vjetor për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë</p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>Spektori i Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës në UAMD, Sekretaria mësimore, Zyra e finances, Faqja ueb dhe rrjetet sociale, Ambientet e dedikuara për njoftime në fakultet, Koordinatorët e programeve të studimit, Përgjegjësi i departamentit dhe pedagogët janë disa nga mjete apo njësitë e posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve dhe problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

<b>Standardi VI.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>



**Kriteri 1.** Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, konstatohet se institucioni ka hartuar politika dhe struktura të posaçme për monitorimin dhe vlerësimin periodik të aftësive mësimdhënëse dhe inovatore të personelit akademik dhe ndihmës akademik. Në UAMD funksionon Qendra për Edukim në Vazhdim e cila në bazë të rregullores së saj ka si detyrë hartimin e udhëzuesve për personelin akademik në lidhje me metodat e ndryshme dhe inovative të mësimdhënies dhe organizon përgjatë gjithë vitit akademik trajnime për personelin akademik në lidhje me metodat inovative në mësimdhënie si dhe për rritjen e aftësive pedagogjike të personelit akademik. Konkretisht, vitin e kaluar, Qendra për Edukim në Vazhdim ka hartuar modulet e mëposhtme për trajnimin e stafit akademik të brendshëm dhe të jashtëm dhe rritjes së kapaciteteve akademike:

- Organizimi i Brendshëm Institucional;
- Platforma Teknologjike në Mësimdhënie;
- Vlerësimi i Vazhdueshëm;
- Barazia dhe Diversiteti;
- Etika në Mësimdhënie;
- Metodatat Novatore të Mësimdhënies;

Megjithatë, vërehet se stafi akademik i kësaj njësie kryesore, nuk është i angazhuar në këtë njësi, edhe pse kapacitetet njerëzore dhe profesionale, janë një burim i çmuar për këtë qendër.

*Sugjerohet institucionin të promovojë pjesëmarrjen aktive në organizimin dhe aktivitetet e qendrës për Edukim në Vazhdim në UAMD, të stafit të FTI-së.*

Evid. 20. Raporti vjetor për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë,

Evid. 41. Rregullore Qendra për Edukim në Vazhdim

Evid. 42. Pyetësor Student UAMD,

Evid. 43. Analiza e pyetësorëve (Student, Staf Akademik, Staf administrativ)

**Kriteri 2.** Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.

Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (KPGSC) është struktura mbikëqyrëse në UAMD, vlerësuese, miratuese dhe garantuese e standardeve të cilësisë së institucionit dhe e programeve të studimit. Ky komision ndjek përmirësimin e cilësisë në UAMD, duke shërbyer si një garanci e shtuar në kuadrin e Standardeve të Brendshme të Sigurimit të Cilësisë.

Vlerësimi i cilësisë në mësimdhënie sigurohet nëpërmjet:

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Pyetësorit të studentit i cili vlerëson performancën e stafit akademik të angazhuar në mësimdhënie;</li> <li>- Vlerësimin të përgjegjës të departamentit për çdo anëtar të stafit;</li> </ul> <p>Evidencë 3. Rregullore UAMD, neni 115, Evid. 6. Rregullore për Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë] Evid. 43. Analiza e pyetësorëve (Student, Staf Akademik, Staf administrativ)</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>Përfshirja e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve dhe të ankimimeve sanksionohet në rregulloren e institucionit dhe zbatohet nga strukturat përkatëse në nivel institucional, njësie kryesore dhe njësie bazë.</p> <p>Studentët janë të përfshirë në të gjithë strukturat vendimarrëse kolegjiale të UAMD-së. Në lidhje me vlerësimin e procesit mësimor ata marrin pjesë në anketime ku shprehin mendimin e tyre përmes plotësimit të pyetësorëve. Në fund të çdo semestri, zakonisht javën e 13 dhe të 14 studentëve u jepet një pyetësor për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies për të gjithë pedagogët me kohë të plotë dhe kohë të pjeshme. Mendimi i tyre degjohet edhe nga stafi akademik. Nga takimi me studentët u theksua marrja e mendimit në mënyrë të vazhdueshme gjatë semestrit në lidhje me temat e trajtuara dhe nëse ka nevojë për përmirësime.</p> <p>Evidencë 3. Rregullore UAMD, neni 115, Evid. 42. Pyetësor Student UAMD</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Rezultatet dhe analizat e pyetësorëve i vihen në dispozicion individualisht me email, të gjithë anëtarëve të stafit akademik të vlerësuar, përgjegjësve të departamenteve, si dhe dekanëve përkatës nga Drejtoria e Kurrikulës dhe Standarteve të Cilësisë në Rektorat. Bazuar në historikun e vlerësimeve të personelit akademik, përgjegjës të njëjësive bazë analizojnë rezultatet e anketimeve dhe diskutojnë në departament problematikat e identifikuara për përmirësimin e tyre në të ardhmen.</p> <p>Evid. 6. Rregullore për Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë, Evid. 43. Analiza e pyetësorëve (Student, Staf Akademik, Staf administrativ)</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve</p>	<p>Në përmbushje të misionit të tij UAMD-FTI promovon shembuj të praktikave më të mira, si dhe inkurajon dhe motivon stafin akademik për të përmirësuar më tej</p>

të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	mësimdhënien, duke organizuar aktivitete të ndryshme trajnimi, leksione të hapura dhe seminare me profesorë të ftuar nga universitete të huaja. UAMD ndjek një politikë integruese dhe ndërkombëtarizuese për stafin akademik. Personeli akademik dhe administrativ ka qenë pjesë e shkëmbimeve të komponentit të mobiliteteve duke sjellë në institucion përfitime profesionale dhe duke zgjeruar rrjetin e bashkëpunimeve si rrjedhojë e këtyre mobiliteteve, numri i stafit akademik që është angazhuar në projektet e financuara nga BE (ERASMUS+) është (124) dhe implementimi i mobiliteteve ka filluar në 2021.			
	Evid. 20. Raporti vjetor për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë			
<b>Konkluzione</b>	<i>Vlerësimi i cilësisë në mësimdhënie në UAMD sigurohet nëpërmjet: pyetësorit të studentit dhe vlerësimin të përgjegjës të departamentit për çdo anëtar të stafit. Rezultatet dhe analizat e pyetësoreve i vihen në dispozicion individualisht të gjithë anëtarëve të stafit akademik të vlerësuar, përgjegjësve të departamenteve, si dhe dekanëve dhe problematikat dhe plani i masave diskutohet deri në nivel departamenti.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi VI.2

**Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	<p>Bazuar ne dokumentacionin e vënë në dispozicion si dhe nga takimet me përfaqësues nga Drejtoria e Kurrikulave &amp; Standarteve të Cilësisë, GVJ konstaton se institucioni ka hartuar politika dhe struktura të posaçme për sigurimin e brendshëm të cilësisë në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p> <p>Njësia përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë në UAMD është Drejtoria e Kurrikulave &amp; Standarteve të Cilësisë e cila funksionon mbi bazen e Rregullores se Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.</p> <p>Në nivel Institucional strukturat përgjegjëse për Sigurimin e Standarteve të Cilësisë janë: Senati Akademik, Komisioni i</p>

	<p>Përhershëm për Garantimin e Standardeve dhe Cilësisë, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Koordinatori Institucional pranë ASCAL, Drejtoria e Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë. Në nivel Fakulteti përgjegjës për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë janë: Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë pranë Fakulteteve, Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për çdo program studimi, Koordinatorët e Programeve. Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë është struktura mbikëqyrëse, vlerësuese, miratuese dhe garantuese e standardeve të cilësisë së institucionit dhe e programeve të studimit.</p> <p>Evid. 2. Statuti UAMD, Evid. 9. Plani i zhvillimit strategjik të UAMD 2020-2025, Evid. 44. Struktura Organizative e UAMD, Evid. 6. Rregullore për Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë është struktura mbikëqyrëse, vlerësuese, miratuese dhe garantuese e standardeve të cilësisë së institucionit dhe e programeve të studimit. Ky komision përbëhet nga maksimumi 7 anëtarë me përfaqësues nga secila Njësi Kryesore e UAMD-së, përfshirë edhe një student me mesatare mbi 9. Anëtarët e Komisionit vetëkandidohen dhe zgjidhen nga Senati Akademik për një mandat dyvjeçar. Funkcionimi i këtij komisioni bazohet në rregulloren përkatëse.</p> <p>Në nivel institucional funksionon edhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë e ngritur me Urdhër të Rektorit me 7 anëtarë, nga të cilët, një përfaqësues nga stafi akademik i çdo fakulteti të UAMD-së, drejtuesi i Drejtorisë së Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë në Rektorat, dhe një përfaqësues nga studentët. Kjo njësi realizon raporte periodike të vetëvlerësimit në bashkëveprim me Njesitë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në nivel fakulteti.</p> <p>Në kuadër të vlerësimit të brendshëm, GVJ konstaton se, GVB është ngritur në përputhje me Statutin e UAMD në bashkëpunim me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë së FTI dhe të UAMD-së ka hartuar Raportin e Vetëvlerësimit në përputhje me standardet dhe kërkesat ligjore, dhe të bazuar në dokumentat që i janë vënë në dispozicion GVJ.</p> <p>Evid. 3. Rregullore UAMD Evid. 6. Rregullore për Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë</p>




<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>Sipas Vendimit të Bordit të Akreditimit Nr.18, datë 24.03.2022 “Për akreditimin periodik Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti Aleksander Moisiu” Durrës, është vendosur Akreditimi Institucional i UAMD, me vlerësim përfundimtar pozitiv, me kohëzgjatjen prej 4 (katër) vite akademike. Afati përfundimtar i vlefshmërisë së Akreditimit Institucional është 23/03/2026.</p> <p>Programi i studimit Bachelor në Teknologji Informacioni është hapur me Vendim Nr. 350, datë 12.5.2010 Për Hapjen e Programeve Të Studimit të Ciklit të Parë "Juridik", "Shkenca Kompjuterike", "Sistemet e Informacionit" dhe "Teknologji Informacioni", në Universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës dhe gjatë kësaj kohe është riorganizuar 2 herë me vendim senati dhe miratuar nga MASR. Vlerësimi i jashtëm i programit të studimit Bachelor në Teknologji Informacioni, me qëllim akreditimin e programit, po realizohet për herë të parë nga ASCAL.</p> <p>Evid. 13. Riorganizimi i programit të studimit Bachelor në TI (2018)</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë ka në kompetencat e tij kontrollin dhe miratimin e raporteve 3-mujore, 6-mujore dhe ato vjetore që përgatiten nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe nëse gjykohet e nevojshme i kthen ato me sugjerime apo rekomandime për reflektim të mëtejshëm. Bazuar në instrumentat e brendshëm të saj për sigurimin e cilësisë, UAMD përcakton direktivat e zhvillimit, objektivat dhe fushat e përmirësimit dhe proceset kryesore të sigurimit të cilësisë. Ky proces i brendshëm i cilësisë përbëhet nga një procedurë ku zhvillohen aktivitete të rregullta monitoruese dhe përmirësuese. Përveç monitorimit të rregullt (çdo vit dhe pjesërisht edhe çdo semestër) dhe përmirësimit, baza kryesore e këtyre aktiviteteve janë vetëvlerësimet që mund të zhvillohen së paku çdo gjashtë vjet në funksion të proceseve të akreditimit nga ASCAL. Rezultatet e vlerësimit, të cilat evidentojnë arritjet në procesin mësimor dhe kërkimor e shkencor dhe problematikat, diskutohen me palët përkatëse dhe në bazë të tyre nxirren rekomandimet që kanë si qëllim të adresojnë problematikat dhe mënyrat e zgjidhjes së tyre.</p> <p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe në takimet me stafin akademik, GVB dhe me perfaqësues nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, GVJ gjykon që UAMD-FTI ka identifikuar tregues të qartë dhe të matshëm në</p>




	<p>mësimdhënie dhe kërkim për monitorimin e standarteve të cilësisë.</p> <p>Evid. 6. Rregullore për Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë</p> <p>Evid. 10. Misioni dhe studimi i tregut të punës për programin e studimit,</p> <p>Evid. 19. Analize e Departamentit të Teknologjisë së Informacionit,</p> <p>Evid. 20. Raporti vjetor për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë,</p> <p>Evid. 43. Analiza e pyetësorëve (Student, Staf Akademik, Staf administrativ),</p> <p>Evid. 45. Permbledhese e formularit të vlerësimit kërkimor shkencor DTI 2020-2022</p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>Për sigurimin e brendshëm të cilësisë, UAMD ka ngritur struktura institucionale dhe struktura në nivel fakulteti. Prane FTI funksionon Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Grupi i Vlerësimit të Brendshëm dhe Koordinatorët e Programeve të Studimit, të cilat funksionojnë sipas rregulloreve të brendshme institucionale.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi VI.3

**Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve</p>	<p>UAMD përdor mekanizma të ndryshëm për mbikëqyrjen periodike të programeve të studimit Bachelor. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë kryen në mënyrë periodike vlerësimin e programit të studimit. Pyetësorët e ndërtuar kanë për qëllim vlerësimin e cilësisë në mësimdhënie dhe vlerësimin e cilësisë së shërbimeve të institucionit. Rezultatet e pyetësorëve përpunohen në mënyrë statistikore dhe shërbejnë si bazë të dhënash edhe nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm në hartimin e raportit në kuadër të akreditimit të programeve të studimit.</p> <p>Zyra e Alumnit dhe Karrierës harton pyetësorë që targetojnë kompanitë dhe alumni dhe ka për qëllim të paraqesë statistikatat</p>

<p>më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>në lidhje me ngarkesën mësimore të stafit akademik të brendshëm dhe të jashtëm, numrin e studentëve të rregjistruar, numrin e studentëve të çrregjistruar, numrin e studentëve të diplomuar me, personelin akademik dhe administrativ, numrin e studentëve që përfitojnë bursë.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse të cilët në varësi të problematikave marrin masa për përmirësimin e treguesve.</p> <p>Konkretisht, në vitin 2018, në bazë të udhëzimit të dekanatit të Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit u propozua të rishikohen, vlerësohen dhe përditësohen kurrikulat aktuale të programeve të studimeve që ofrohen nga njësia kryesore e Teknologjisë së Informacionit që përshtasin dhe afrojnë programet e studimit më tepër drejt tregut të punës. Konkretisht, programi i studimit “Teknologji Informacioni” shtoi tre kurse Konfigurim dhe Administrim Serverash, Sistemet Elektronike të Programueshme, TIK dhe Inovacion dhe përditësoi syllabuset me literaturë bashkëkohore. Grupi i punës që rishikoi kurrikulën analizoi tregun e punës, kurrikulat që ofrohen nga universitetet brenda dhe jashtë vëndit duke zëvendësuar kurset me karakter ndërdisiplinor apo që ofrohen nga departamente të tjera me këto tre kurse që thellojnë më tepër aftësimin profesional të studentëve duke ju përshtatur kërkesave të tregut të punës.</p> <p>Evid. 6. Rregullore për Funkzionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë</p> <p>Evid. 7. Rregullore e Sektorit të Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës,</p> <p>Evid. 10. Misioni dhe studimi i tregut të punës për programin e studimit</p> <p>Evid. 13. Riorganizimi i programit të studimit Bachelor në TI (2018)</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin</p>	<p>GVJ konstatoi dokumentacion mbi raportet e përgatitua nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në UAMD për veprimtarinë mësimore dhe kërkimore shkencore, dhe anketime semestrale studentore mbi cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi të ofruara nga IAL.</p> <p>Përmes rezultateve individuale të personelit akademik, hartohen analiza për të evidentuar pikat e forta dhe problematikat specifike në çdo program studimi. Këto analiza përmbledhen në trajtë raporti dhe i përcillen njërive kryesore dhe atyre bazë për të zhvilluar analiza të mëtejshme e për të</p>



<p>e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>vijuar punën mbi përmirësimin e cilësisë. Bazuar mbi raportet e anketimeve por edhe ato të vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm institucional apo për programe studimi, hartohet Raporti vjetor për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë ku jepen rekomandime për rritjen e cilësisë në UAMD.</p> <p>Në dokumentacionin e paraqitur nga IAL, GVJ nuk gjen një plan të qartë pune me objektiva të matshëm për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë në IAL.</p> <p><i>GVJ vlerëson punën e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në përgatitjen e Raporteve të vlerësimit dhe <u>sugjeron që kjo njësi të bashkëpunojë me strukturat akademike të institucionit për përgatitjen e planit të masave dhe ndjekjen e shkallës së përmbushjes së tyre.</u></i></p> <p><a href="https://uamd.edu.al/njsbc-uamd/">https://uamd.edu.al/njsbc-uamd/</a>.</p> <p>Evid. 42. Pyetësor Student UAMD</p> <p>Evid. 43. Analiza e pyetësorëve (Student, Staf Akademik, Staf administrativ),</p> <p>Evid. 19. Analize e Departamentit të Teknologjisë së Informacionit</p> <p>Evid. 20. Raporti vjetor për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>UAMD përdor metoda të drejtpërdrejta për vlerësimin e programit të studimit Bachelor në “Teknologji Informacioni”. Cilësia e mësimdhënies dhe kurrikulës kontrollohet dhe monitorohet nga Drejtuesi i Departamentit, i cili bazuar në nenin 18 të rregullores së FTI mbikqyr respektimin e programeve të mësimdhënies, paraqitjen dhe disiplinën në punë dhe realizon analizat periodike të Departamentit.</p> <p>Bazuar në nenin 16 të rregullores së FTI Zëvendësdekani për anën mësimore, për të ndihmuar dekanin në realizimin e veprimtarisë së Fakultetit, ndjek përgatitjen dhe zbatimin e planeve e programeve mësimore dhe të orarit mësimor të Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit dhe mbikqyr zhvillimin e aktiviteteve didaktike konform strukturës mësimore dhe orarit mësimor të miratuar. Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies nga njësia bazë dhe ajo kryesore realizohet duke përdorur raportet e hartuara nga stafi akademik në lidhje me mësimdhënien të dhënat e ofruara nga sekretaria mësimore, monitorimi i realizimit të aktiviteteve të programit të studimit, opinionimi i studentëve dhe personelit akademik të angazhuar në mësimdhënie opinionimi i përfaqësuesve të biznesit, anketimi i studentëve të diplomuar etj.</p> <p>Evid. 4. Rregullore FTI</p>

	<p>Evid. 10. Misioni dhe studimi i tregut të punës për programin e studimit,</p> <p>Evid. 19. Analize e Departamentit të Teknologjisë së Informacionit]</p> <p>Evid. 43. Analiza e pyetësorëve (Student, Staf Akademik, Staf administrativ),</p> <p>Evid. 46. Formular vevlerësimi,</p> <p><b>RVB TEKNOLOGJI INFORMACIONI</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p>	<p>Zyra e Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës mbështetur nga njësite kryesore në IAL, përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimi si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- organizon pyetësore drejtuar studenteve për të marrë mendim në lidhje me cilësinë e programit të studimit dhe vlefshmërinë e tij tek ALUMNI</li> <li>- organizon pyetësore në formë elektronike drejtuar kompanive IT për të analizuar performancën dhe përgatitjen e njohurive praktike që kanë studentët e diplomuar në Teknologji Informacioni punësohen në fushën e tyre të studimit</li> <li>- organizon workshop-ve/panaire pune ku mbledh sugjerimet dhe kërkesat e bizneseve në lidhje me programet e studimeve</li> </ul> <p>Gjithashtu, institucioni vlerëson edhe angazhimin administrativ dhe kërkimor shkencor të stafit akademik dhe të studentëve.</p> <p>Evid. 10. Misioni dhe studimi i tregut të punës për programin e studimit</p> <p>Evid. 32. Workshops</p> <p>Evid. 42. Pyetesor Student UAMD, [Evid. 43. Analiza e pyetësorëve (Student, Staf Akademik, Staf administrativ)</p> <p>Evid. 45. Permbledhese e formularit te vleresimit kerkimor shkencor DTI 2020-2022</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>IAL monitoron dhe vlerëson përmes njësisë të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</i></p> <p><i>GVJ vlerëson pozitivisht punën e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në përgatitjen e raporteve të vlerësimit dhe rekomandimeve të bëra dhe <u>sugjeron</u> që kjo njësi të bashkëpunojë me strukturat akademike të institucionit për përgatitjen e një plani masash veprimi për adresimin e problematikave dhe ndjekjen e shkallës së përmbushjes së tyre.</i></p>


Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

#### Standardi VI.4

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>GVJ bazuar në dokumentet bazë institucionale (Statuti dhe Rregullorja e UAMD, Kodi i Etikës dhe Rregullore për Funkzionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë) dhe vizitat në institucion konstaton që në institucion funksionon sistemi i vlerësimit të brendshëm ku përfshihen aktorë në nivel Institucional (Senati Akademik, Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve dhe Cilësisë, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë Koordinatori Institucional pranë ASCAL, Drejtoria e Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë), në nivel Fakulteti (Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë pranë Fakulteteve, Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për çdo program, Koordinatorët e Programeve) dhe studentët.</p> <p>GVJ konstaton që institucioni parashikon dhe garanton përfshirjen në vlerësimin e brendshëm të aktorëve të brendshëm stafit akademik, stafit joakademik, studentët dhe grupet e interesit të lidhura me programin e studimit apo institucionit.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Bazuar në RVB dhe nga takimet e kryera në institucion, GVJ konstaton se strukturat e brendshme përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në institucion kanë detyra të përcaktuara qartë në aktet rregullatore të brendshme.</p> <p>Në nivel Institucional strukturat përgjegjëse për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– Senati Akademik,</li> <li>– Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve dhe Cilësisë,</li> <li>– Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë,</li> <li>– Koordinatori Institucional pranë ASCAL,</li> <li>– Drejtoria e Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë.</li> </ul>

	<p>Në nivel Fakulteti përgjegjës për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë pranë Fakulteteve,</li> <li>- Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për çdo program studimi,</li> <li>- Koordinatorët e Programeve.</li> </ul> <p>Evid. 6. Rregullore për Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë - ANEKSI IV MODEL I ORGANIZIMIT TË SBSC, Evid. 3. Rregullore UAMD, Evid. 4. Rregullore FTI</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton në bazë të dokumentave të shqyrtuara se, në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit Bachelor në “Teknologji Informacioni” janë përfshirë staf akademik, ndihmës akademik, administrativ dhe studentë.</p> <p>Evid. 1. Urdher per ngritjen e grupeve te RVB Akreditim</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>GVJ konstaton në bazë të dokumentave të shqyrtuara se ngritja e grupeve të vlerësimit të brendshëm, stafi akademik është i përfaqësuar në mënyrë jo diskriminuese si në bazë gjinie, ashtu edhe grade apo kualifikimi akademik diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p> <p>Procesi i vlerësimit është gjithëpërfshirës duke respektuar elementin e barazisë dhe integritetin e stafit akademik dhe studentëve. Ky proces përfshin procesin e vetëvlerësimit nga ana e pedagogut, vlerësimit nga eprorët dhe dhe nga studentët.</p> <p>Gjithashtu, në hartimin e raporteve dhe në interpretimin e të dhënave institucioni bazohet në rregulloren institucionale të sigurimit të cilësisë.</p> <p>Evid. 1. Urdher per ngritjen e grupeve te RVB Akreditim Evid. 6. Rregullore për Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë Evid. 19. Analize e Departamentit të Teknologjisë së Informacionit</p>



	Evid. 43. Analiza e pyetësorëve (Student, Staf Akademik, Staf administrativ) Evid. 46. Formular vetevlerësimi,			
<b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	GVJ u informua gjatë takimeve në institucion se në vlerësimin dhe sigurimin e brendshëm të cilësisë, si pjesë integruese e vlerësimit, janë edhe ekspertë nga tregu i punës. Forma të tjera të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë nga bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm në FTI janë: <ul style="list-style-type: none"> <li>- Zhvillimi i workshopeve dhe praktikave mësimore pranë kompanive partnere;</li> <li>- Përvoja e ish studentëve të diplomuar;</li> <li>- Analiza e përputhshmërisë së planit mësimor dhe syllabuseve përkatëse me atë të ofruar në IAL të ngjashme jashtë vendit;</li> </ul> GVJ vlerëson se njësia bazë përgjegjëse për këtë program studimi realizon një vlerësim objektiv të programit të studimit dhe nevojave për rishikimin e tij.  Evid. 10. Misioni dhe studimi i tregut të punës për programin e studimit Evid. 37. Te Dhena mbi mobilitetin studenteve Evid. 26. Liste MoU, Evid. 32. Workshops, Evid. 28. Trajnime FTI - Crstal System			
<b>Konkluzione</b>	<i>UAMD përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>


### Standardi VI.5

**Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për	GVJ konstaton së dokumentat (Statuti i UAMD dhe Plani strategjik Rregullorja e UAMD dhe e FTI) në të cilat janë përshkruar politikat, strategjitë dhe veprimtaritë në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për këtë program studimi, janë vëne në dispozicion të GVJ, por konstatohet që ato nuk

<p>programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>janë të publike në faqen web institucionale. Procesi i vlerësimit të cilësisë së programit të studimit (shpërndarja e pyetësorëve, përpunimi i tyre, marrja e rezultateve) është transparent dhe u komunikohen individualisht studenteve dhe të gjithë aktorëve në tjerë. <a href="https://uamd.edu.al/">https://uamd.edu.al/</a></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>GVJ bazuar edhe në dokumentacionin e paraqitur nga institucioni, dhe në takimet e zhvilluara vëren që procesi i vlerësimit të cilësisë në programin e studimit karakterizohet nga transparenca dhe ruajtja e konfidencialitetit. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në nivel institucional, harton në mënyrë periodike raporte të vlerësimit të brendshëm të cilat ruhen në arkivën institucionale në përputhje me normat e ligjit nr. 9154, date 06.11.2003 “Për arkivat” me normat tekniko profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, në Rregulloren e Njehsuar të punës me dokumentet në autoritetet publike ne Republikën e Shqipërisë si dhe në përputhje me rregulloren e brendshme “Për arshivimin dhe qarkullimin e dokumentacionit të brendshëm në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës.</p> <p>Të gjitha të dhënat në UAMD përpunohen dhe bëhen publike duke zbatuar Kodin e Etikes për Konfidencialitetin e të dhënave personale. Rezultatet e vlerësimeve u vihen në dispozicion individualisht të gjithë anëtarëve të stafit akademik të vlerësuar, përgjegjësive të departamenteve dhe dekanëve përkatës.</p> <p>Evid. 40. Kodi i Etikës UAMD – Neni 7</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në nivel institucional, harton në mënyrë periodike raporte në funksion të vlerësimit dhe përmirësimit të cilësisë si për program studimi ashtu edhe në nivel institucional.</p> <p>Rezultatet e vlerësimit, të cilat evidentojnë arritjet në procesin mësimor dhe kërkimor e shkencor dhe problematikat, diskutohen me palët përkatëse dhe në bazë të tyre nxirren rekomandimet që kanë si qëllim të adresojnë problematikat dhe mënyrat e zgjidhjes së tyre. Masat e marra për stafin akademik të brendshem dhe të jashtëm në rastin e vlerësimeve nën nivelin mesatar janë të sanksionura në rregulloren e UAMD dhe rregulloren e FTI.</p> <p>Për përmirësimin e planit mesimor, departamenti propozon ndryshimet e nevojshme në programin e studimit apo në elementët përbërës të tij nisur nga nevojat e identifikuara për përmirësim, përpara fillimit të vitit akademik pasardhës. Në rast se nga njësia bazë, konstatohet nevoja për ndryshime në</p>

	<p>kredite në masën mbi 20% të përmbajtjes së programit të studimit të akredituar, ndryshimet e hartuara nga departamenti shqyrtohen në Dekanat, miratohen në Senatin Akademik dhe i dërgohen për miratim ministrit përgjegjës për arsimin. Ndërsa, ndryshimet deri në masën 20 për qind, IAL mund t'i reflektojë në diplomën e lëshuar me miratim nga Senati Akademik.</p> <p>Evid. 4. Rregullore FTI, Evid. 3. Rregullore UAMD</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Në UAMD, nëpërmjet Qendrës për Edukim në Vazhdim janë organizuar trajnime informuese për stafin akademik dhe studentët, ndër të cilat ato me temë: Organizimi i Brendshëm Institucional dhe Vlerësimi i Vazhdueshëm që synojnë informimin dhe ndërgjegjësimin e të gjithë aktorëve për rolin e tyre në sigurimin e cilësisë.</p> <p>Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në FTI është riorganizuar në vitin 2021 dhe ka në përbërjen e saj një staf akademik të konsoliduar dhe perfaqësues nga studentët. GVJ konstaton angazhim maksimal nga ana e UAMD në lidhje me procesin e vlerësimit të brendshëm të cilësisë në programin e studimit.</p> <p>Evid. 41. Rregullore Qendra për Edukim në Vazhdim Evid. 30. Urdhër Koordinatorët dhe NJSBC</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>UAMD përfshin të gjitha organet e brendshme në trajnime periodike me qëllim sigurimin e cilësisë dhe rritjen e kapaciteteve njerezore dhe shërbimeve të ofruara nga institucioni. Bazuar në rregulloren e brendshme dhe institucionale, FTI ka caktuar një Koordinator për çdo program studimi që ofron i cili është pjesë e grupit të punës për hartimin e kurrikulës. Ai ndjek ecurinë e studentëve dhe trajton problematikat e tyre gjatë gjithë kohëzgjatjes së studimeve dhe informon në mënyrë të vazhdueshme drejtuesin e njësive kryesore / bazë në lidhje me ecurinë e programit të studimit.</p> <p>[Evid. 4. Rregullore FTI, Evid. 3. Rregullore UAMD</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Institucioni paraqet Kulturë të Brendshme të Cilësisë mbi politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të cilat janë të sanksionuara në rregulloret e institucionit.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X



Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Teknologji Informatike”**

**a. Pikat e forta dhe afirmime:**

1. Departamenti i Teknologjisë së Informatikës, organizon këtë program studimi me angazhimin e një stafi akademik të ri në moshë dhe i përkushtuar në përcimin e dijeve;
2. IAL përdor një sistemi të menaxhimit i cili ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve;
3. Ka një komunikim student-pedagog, student-institucon shumë efektiv edhe nëpërmjet rrjeteve sociale;
4. Zhvillimi i plotë i disa prej lëndëve karakterizuese plotësisht në auditorë të pajisur me pajisje informatike, të nevojshme për përcimin e njohurive;
5. Lëndët dhe formimi në tërësi i programi të studimit, është në përputhje me objektivat formuese të studentëve për këtë cikël studimi dhe i ngjashëm me ato të ofruara nga IAL të tjera;
6. Ofrimi i orareve mësimore të ndryshme/paralele për të njëjtën lëndë në të njëjtin semestër duke u mundësuar studentëve zgjedhjen e orarit më të përshtatshëm, apo edhe frekuentimin në një orar të dytë për të plotësuar njohuritë apo zëvendësuar mungesa të mundshme;
7. Institucioni paraqet një qëndrueshmëri në vite të stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi;
8. Bashkëpunime të fryshme me aktorë të tregut të punës për realizimin e konferencave, praktikave apo edhe mbështetje në ngritjen e bazave laboratorike brenda institucionit;

**b. Pika të dobta:**

1. Dokumentacione zyrtare si syllabuset, rregullorja e programit të studimit, rregullorja e UAMD dhe suplementi i diplomës, kanë të dhëna që janë kontradiktore mes tyre për sa i përket mënyrës së vlerësimit apo edhe organigramën institucionale, në lidhje me Sigurimin e Cilësisë; *(Standardi II.1, kriteri 1; Standardi III.2, kriteri 1; Standardi VI.3, kriteri 2)*
2. Jo të gjitha lëndët e këtij programi studimi kanë të përcaktuar titullarin dhe lektorin me kualifikimet e kërkuara nga aktet ligjore në fuqi; *(Standardi II.1, kriteri 3; Standardi II.3, kriteri 4)*





3. Mungesa e një lënde “Praktikë Profesionale” që të zhvillohet pranë bizneseve apo institucioneve bashkëpunuese për të afruar studentët me tregun e punës; (*Standardi II.1, kriteri 4*)
4. Në tërësi, ky program studimi ka një numër të ulët të orëve në auditor (30% e 4500 orëve në total për tre vite akademike) krahasuar me programe të ngjashme të ofruara nga institucione të tjera të arsimit të lartë (mbi 40% të ngarkesës në auditor); (*Standardi II.1, kriteri 6; Standardi II.4, kriteri 3*)
5. Në planin mësimor dhe në syllabuset e lëndëve, nuk janë të ndara në kredite dhe orë në auditor mes aktiviteteve formuese si Leksione, Seminare/Ushtime, Laboratore, Detyra/Projekte kursi etj. duke mos qenë në përputhje me aktet e brendshme rregullatore edhe për orët e integruara; (*Standardi II.1, kriteri 1; Standardi II.3, kriteri 2; Standardi II.4, kriteri 4; Standardi III.4, kriteri 1*)

**Rekomandime:**

1. Rekomandojmë hartimin e syllabuseve dhe rregulloreve të brendshme në harmoni të plotë mes tyre, duke evituar përsëritje informacioni, sikurse është tabela e vlerësimit apo të dhëna në lidhje me organigramën dhe rregulloreve për Sigurimin e Cilësisë;
2. Të përcaktohen lektorët e lëndëve me kualifikimet sipas legjislacionit në fuqi dhe të afishohen në syllabuset përkatëse;
3. Të shtohet lënda e “Praktikës Profesionale” në planin mësimor duke hartuar edhe syllabusin përkatës;
4. Rritja e orëve mësimore në klasë për të qenë në harmoni me programet e ngjashme të studimit të ofruara nga IAL të tjera, veçanërisht për aktivitetet laboratorike;
5. Të saktësohen për çdo lëndë pesha në kredite ECTS dhe orë në auditor së paku për aktivitetet laboratorike dhe projektet/detyrat e kursit, ndërsa leksionet dhe seminarët, mund të jenë edhe si orë të integruara, bazuar në rregulloret institucionale;
6. Institucioni të përmirësojë dhe vendos në efikasitet të plotë përdorimin e postës elektronike zyrtare në domain të institucionit për të gjithë stafin, duke evituar përdorimin e postës elektronike si google, yahoo, Hotmail etj. në komunikime institucionale;

**Evaluation’s conclusions for the first cycle study program Bachelor "Information Technology"**

**a. Strengths and affirmations:**

1. The Department of Information Technology organizes this study program with the commitment of a young academic staff dedicated to imparting knowledge;



2. UAMD uses a management system which has integrated platforms and modules that enable forms of interactive communication and information exchange between academic staff and students;
3. There is a very effective student-teacher, student-institution communication even through social media;
4. Conducting some characteristic courses, entirely in computer laboratories, allowing for greater knowledge acquisition;
5. The subjects and overall formation of the study program is in accordance with the formation objectives of the students for this study cycle and similar to those offered by other HEIs;
6. Offer different/parallel teaching times for the same subject in the same semester, allowing students to choose the most suitable time, or even attend a second time to integrate knowledge or replace any absences;
7. The Institution has a stable number of academic staff engaged in this course of study over the years;
8. Effective collaborations with labor market actors for the implementation of conferences, practices or even support in the creation of labs or lab infrastructure;

**b. Weaknesses:**

1. Official documentation, such as study plans, study course regulations, UAMD regulations and diploma supplement, contain contradictory information in terms of evaluation method or even institutional organizational chart, in relation to Quality Assurance; (*Standard II.1, criterion 1; Standard III.2, criterion 1; Standard VI.3, criterion 2*)
2. Not all courses of this study program have lecturers in possession of the qualifications required by current regulations; (*Standard II.1, criterion 3; Standard II.3, criterion 4*)
3. Lack of a "Professional Practice" course to be carried out at cooperating companies or institutes to bring students closer to the job market; (*Standard II.1, criterion 4*)
4. Overall, this course of study involves a low number of classroom hours (30% of the total 4500 hours in three academic years) compared to similar programs offered by other universities (with over 40% of the classroom load); (*Standard II.1, criterion 6; Standard II.4, criterion 3*)
5. In the study program and course syllabi there are no clear subdivisions of credits and classroom hours between academic activities such as lectures, seminars/exercises, laboratories, course tasks/projects, etc., thus resulting in non-compliance with internal regulations also for what are called "integrated hours"; (*Standard II.1, criterion 1; Standard II.3, criterion 2; Standard II.4, criterion 4; Standard III.4, criterion 1*)

**Recommendation**



1. It is advisable to draw up internal programs and regulations in complete harmony with each other, avoiding repetition of information, such as the evaluation table or data relating to the organization chart and regulations for Quality Assurance;
2. Identify lecturers of each courses according to the current legislation regarding their current qualification;
3. Insert the course of "Professional Practice" into the curriculum by drawing up the relevant syllabus;
4. Increase of classroom teaching hours to be on harmony with similar study programs offered by other HEI, in particular for laboratory activities;
5. Specify for each course the weight in ECTS and the hours in the classroom at least for the laboratory activities and the projects/assignments of the course, while the lectures and seminars can also be integrated hours, based on institutional regulations;
6. UAMD should improve and make fully efficient the use of official email in the institution's domain for all staff, avoiding the use of emails such as Google, Yahoo, Hotmail, etc. in institutional communication;



**Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
<b>I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT</b>				X
<b>II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR</b>			X	
<b>III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT</b>				X
<b>IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT</b>				X
<b>V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE</b>				X
<b>VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR</b>				X
<b>VLERËSIMI TËRËSOR</b>				X

